

ALBAN N.

SHPËRTRAT
e një toke

Letërsi spartane 5

ALBAN N.

SHPIRTRAT
E NJË TOKE

Letërsi Spartane 5

Shpirtrat e një toke
Alban N.

Redaktor: Ernest Marku

Korrektore letrare: Elona Capo

Korrektorë për gegnishten: Palokë Rrotani, Ernest Marku

Faqosja & Kopertina: Hekuran Koka

© Të gjitha të drejtat e këtij libri i mban Redaktori

mob.: +355 684516996

e-mail: ernestmarku@yahoo.com

Tiranë, 2019

Je artist me këtë çmim: që të konsiderosh dhe ndiesh si brendi, si “gjënë vetë”, atë që të gjithë joartistët e quajnë “formë”. Sigurisht, kështu i përket një bote të përmbysur, sepse tashmë brendia bëhet, për një njeri, diçka thjesht formale, përfshirë dhe jetën tënde.

Nietzsche

Shkrimtari nis të krijojë letërsi, pse ka diçka për të thënë dhe kjo gjë, nuk është domosdoshmërisht historia që po tregon.

Ernest Marku

PJESA E PARË

*Unë shpërndaj “ambrozia” dhe “eliksir” të pastër, përzierjen bëjeni
ju dhe fantazia juaj.*

Epikurjani

I

Një gërvimë mishngjethëse, çliruar nga fërkimi i hekurit me hekur, po më tunelonte veshët e skuqur nga të ftohtit, pothuaj në të njëjtën gjatësi vale me uturimën e erës, që gjarpëronte mes xhamave të thyer e që përplasej mbi surratin tim, të strukur gjer në hundë, nën jakën e një xhiboksi të hollë prej fëshfësheje. Trikon e leshtë e kisha lënë në konvikt, edhe pse e dija që trenat ishin bërë për ditë të kiametit; ndoshta, besoja se më ngrohte mjaftueshëm lajmi për rënien e Murit të Berlinit.

Treni duhet të kishte mbërritur në stacionin tim, tashmë. Ndoshta, lokomotiva po vonohej, ngaqë e kishte të vështirë ta çante këtë erë ulëritëse, apo thjesht, truri im, i mbufatur nga të ftohtit, nuk po e maste dot kohën, që mezi po kalonte. Orë dore, jo gjithkush mbante asokohe, aq më pak unë, që as që më shkonte mendja për diçka të tillë. Vite më parë, kur isha akoma skënderbegas, pashë për herë të parë një orë elektronike; mrekulli e kohës, të tregojë kohën pa akrepa. Tani, më vjen të qesh me këto mendime, por atëherë jo. Ndoshta, një muaj më pas, kur xhami i orës u plasarit keqas në tri-katër drejtime poseduesi i orës ofroi të ma shiste për 50 lekë të vjetra. Kjo ishte një kartëmonedhë e shëmtuar, me figurën e një gruaje muskuloze, me kazmë në dorë, që e valëviste si trofe lufte, në mes të së cilës, apo pak më poshtë se mesi, shkruheshin fjalët: “Pesë lekë”. Ishte kartëmonedha që im atë më kishte dhënë në takimin e para dy ditëve; zakonisht ai më takonte një herë në dy-tre muaj. Kisha thurur shumë ëndrra mbi ato lekë, që nga kinemaja e së dielës e deri tek akulloret me luleshtrydhe, që sapo kishin dalë, por i tradhtova të gjitha këto, për një orë që nuk vlente asnjë dyshkë.

Shpërdorova një liralidje të tërë, por nuk gjeta dot një xham të ri për orën. Nuk lashë orëndreqës apo argjendar pa provuar, derisa vendosa të prodhoja vetë një ekran prej peçikllasi. U vetofrova për ndihmë te reparti mekanik i shkollës, mjeshtërit e të cilit, ndonëse nuk i besuan shumë, dëshirës sime për të punuar në torno, më lejuan, apo më mirë të themi, më ngarkuan, të bëja disa punë të thjeshta. Nuk vonoi dhe e gjeta mundësinë të merresha me orën; e preva peçikllasin e gjetur sipas matjeve që kisha bërë dhe shpenzova një gjysmë ore të mirë, për të rakorduar anët me limë. Mezi gjeta mënyrën për hapjen e vrimave, kur erdhën e më zbuani nga reparti, pasi që, as që e kisha prekur punën e ngarkuar. Arrita ta vidhosja, pak para orës 10⁰⁰, kur binte edhe sinjali i gjumit. Nga pështjellimi i ndjenjave, mezi arrita të flija një apo dy orë, përpara se të binte sinjali i zgjimit, që fërfëllonte gjithnjë në orën gjashtë të mëngjesit. Sinjali ishte një trumbetë, e cila lëshonte një tingull, që të ngjethte mishtë në çdo cep të shpirtit, sidomos kur nuk kishe fjetur mirë. I përfundova tri xhirot e detyrueshme të vrapit rreth shkollës, me sytë gjysmë të mbyllur, ndonëse i kisha shpëlarë me ujë të ftohtë. Një trishtim i madh më kaploi, kur kuptova se sërish, nuk mburresha dot me orën time; nën dritën e diellit, ai peçikllas ishte aq i shëmtuar, sa që unë do të vazhdoja të informohesha për orën nga një instrument që nuk e ekspozoja dot.

Kur u ktheva nga pushimet, pashë se orët elektronike ishin shtuar papritur. E hodha timen gjatë një marshimi në malin e Dajtit dhe që atëherë, nuk arrij ta bind veten për të blerë një orë... Me këto mendime në kokë zbrita nga treni. Përveç errësirës që mbizotëronte, bashkë me erën shurdhuese, kishte nisur edhe një shi i lehtë, por që nuk po dinte të pushonte. Ky ishte stacioni më i humbur i linjës nga Tirana për në Shkodër; asnjë bar kafe për be, asgjë që të të ngrohte syrin në atë platformë betoni, përveç një kontrollori me një fener vajguri në dorë, e vetmja xixëllonjë, që të ndihmonte të shpresoje se nuk kishe zbritur në ferr. Ishte ora pak më shumë se 11 e natës dhe një defekt i zakonshëm kishte

ndërprerë furnizimin me energji elektrike për të gjithë zonën, sa të shihte syri nga mali në mal.

Nga treni zbritëm rreth pesëdhjetë veta, por në rrugën time më ndoqën vetëm dhjetë-dymbëdhjetë udhëtarë, kurse, pas dyqind metrash, gjysma e tyre kishte devijuar në të majtë. Që në metrat e parë, jashtë betonit të platformës së stacionit, këmba e majtë u zhyt në baltë gjer te kërciri; tashmë, e tërë vëmendja ime ishte përqendruar në misionin e vështirë, të shpëtimit të çorapes së djathtë.

Në të dalë të fshatit me stacion, një siluetë njeriu na kishte zënë pritë te porta e oborrit të shtëpisë, ndërkohë që grupi ynë, tashmë përbëhej vetëm nga tre veta. Si mori vesh se po shkonim në Blinisht, na pyeti me radhë se të kujt ishim. Nën dritën e llambës së vajgurit që mbante në dorë, pashë vetëm mirësi e buzëqeshje, të buronte nga fytyra e paqtë e një gruaje të moshuar. Si na bekoi me dhjetëra urime, që i dilnin prej goje si breshëri automatiku, ma zgjati mua llambën.

- Merre... keni t'ânë at rrugë për t'ba.

- Un kthehem mbas tri ditësh, - i them me një zë të lehtë e pak mëdyshas.

- S'prish punë, - e moshuara lëshoi edhe një buzëqeshje tjetër, që ia mbuloi krejt fytyrën, - ma lén te im vllá. Ti e njeh, apo jo?!

Të ngrohur nga drita e kandilit, zumë t'i hedhim hapat më me guxim, ndonëse shpejt ndjeva ujin e baltosur të më hynte edhe tek këpuca tjetër; me sa duket, drita e llambës me vajguri ishte paksa mashtruese. Dikush qeshi pas meje, teksa më pa të zhytesha në një gropë që më baltosi gjer në gju. Tashmë nuk ruheshja më nga balta, drita e llambës nuk hynte më në punë; ndonëse këtë s'e them dot për dy të tjerët, që me zgjuarsin e zgjidhnin vendin ku hidhnin këmbët, të ndihmuar nga kandili që unë mbaja në dorë. Në hyrje të Blinishtit ngela vetëm, dy bashkudhëtarët e refuzuan përcjelljen time; tashmë fillonte ngjitja në kodër dhe balta bëhej lehtësisht e përbalueshme. Blinisht, Blinishtë, apo

Fusha e Blinit... Po përse nuk më kishte zënë syri asnjë bli për gjithë këto vite?! Ndoshta, mania për të hapur toka të reja, që i kishte shkatërruar gjithandej ekosistemet dhe pyjet, ia kishte nxjerrë fundin edhe kësaj peme. Ndoshta. Po përse nuk më bie ndërmend asnjë këngë me lulen e blinit?! Ndërsa po i afrohem shtëpisë, kujtesa më shpalos vargje me lule të tjera:

*“...morì lulja e frashnit t’bardhë,
a t’thá nana udha e mbarë”*

Bukuria e femrës krahasohet me lulen e frashërit dhe jo me atë të blinit. A thua pikërisht se këtu kishte kaq shumë bli, kurse frashëri ishte aq i rrallë, siç janë të rralla edhe bukuritë apo perlat?!

*“...udha e mbarë nana m’ka thënë,
lott n’per faqe ja kam lánë”*

Ajo që i thotë këto fjalë është një vajzë që po martohet, por megjithatë, shpirti im gjen plot përjasje, teksa kalojnë pesë minuta, duke i rënë portës së oborrit, pa marrë asnjë përgjigje. Po afron mesi i natës dhe nëse teksti i telegramit ishte i saktë, vështirë se i dëgjon kush trokitjet e mia sonte, sidomos në këtë erë që ulërin si e çmendur. Shtëpia është një kullë gati njëqindvjeçare, me një oborr dymbëdhjetë metra të gjatë, në anën e majtë të së cilit shtrihet kjori i djathit, rakisë, verërave, proshutës së derrat, specave dhe domateve të regjura, si dhe dy jerevitë e bagëtive, nga lopët deri te derrat e pulat. Nga e djathta, oborri ndahet me një sivëllaun e vet nëpërmjet një muri guri, që nuk ka qenë gjithnjë kaq i lartë; shpesh, më është dukur se ky mur rritej paralel me shtatin tim. Pres edhe pesë minuta të tjera, para se të vendos të dal pas shtëpisë e të godas me gurë xhamat e dhomës së gjumit të prindërve. Dy goditjet e para më dalin huq, e treta godet lehtë, kurse zhurma e së katërtës zgjatet dhe bashkohet me klithmën e athët të një gruaje. Pak çaste më vonë, ajo thërret emrin tim dhe koha e era heshtin papritur, në një qetësi të rreme pritjeje.

- Po nanë, un jam, - zëri im, mezi ia kalon zhurmës së erës, që nisi të fryjë në të njëjtin çast.

- T'pastë nana, t'pastë, - ndërkohë fillojnë të dëgjoen lëvizje mbi çardakun e drunjtë. - A ke shumë tue prité?

- Sa mrrina, - kjo m'u duk një gënjeshtër e bukur, ndryshe nga ajo e tim eti, që më kishte telegrafuar të vija urgjentisht në shtëpi, pasi nëna nuk ndihej mirë.

Ndërsa dëgjoja hapat e saj në oborr, nga porta e brendshme gjer te porta ku po prisja, zemra më përpëlitej mes padurimit, kënaqësisë për falsitetin e sëmundjes së nënës dhe inatit me tim atë, që më kishte bërë të hiqja dorë nga pjesëmarrja në grevën e urisë. Pas përqaimit të ngrohtë u hodha menjëherë te çezma e oborrit, por kazanët ishin të gjithë bosh.

- Kena tri ditë pa ujë, - tha nëna që po më shihte gjithë dhimbje, - Po ti kënce bá qëll, të duhen peshqira e jo ujë.

- I kam kâmbët tânë baltë.

- Mshij me peshqir, - hapat e saj mbi shkallët e drunjta mbanin të njëjtin ritëm me pikat e shiut mbi gurët e oborrit.

Po hiqja këpucët, i mbështetur mbi trungun e hardhisë së vjetër, degët e së cilës mbulonin më shumë se gjysmën e hapësirës së oborrit. Befas, m'u kujtua se ajo bimë ishte më e moçme se unë. Atëbotë, kur po mësoja të ecja për herë të parë, mbahesha te kjo hardhi; edhe kur kthehesha nga shkolla apo loja mbahesha po te kjo hardhi, teksa hiqja këpucët. Befas, vura re se dora ime nuk e mbërthente dot të gjithë trashësinë e trungut; kisha pesë-gjashtë vite pa u mbështetur aty. Ndonëse trupi im e kishte mbaruar me kohë ciklin e rritjes, kjo bimë vazhdonte të rritej. Ishte shkurt dhe babai i kishte krasitur të gjitha hardhitë, andaj tanda nuk më pengonte të shikoja yjet, që nisën të shfaqeshin në qiellin e hapur tashmë. Me këtë imazh të fundit të syve të mi, u shtriva të fle, me këmbët e fshira me peshqir dhe të mbështjella me batanije; nuk desha të zhvishesha, nuk pranova as çarçafët e nënës sime. Me mendje e shpirt të trazuar, e kisha të vështirë të flija. S'kisha as dy muaj që isha larguar nga shtëpia, pas pushimeve të fundvitit të

shkuar, por nuk di pse po më dukej se, ndërkohë, kishte kaluar një jetë e tërë.

Kujtimi i parë i fortë që më ka mbirë në mendje, që nga koha kur erdha në këtë botë, është figura e këtyre shkallëve të drunjt, të cilat përkuleshin nën peshën e burrave hijerëndë dhe grave të veshura me të zeza, teksa unë, i tkurrur dhe i trembur prej tyre, shihja vetëm këmbët dhe dëgjoja vetëm psherëtimat, mërmërimat dhe nganjëherë edhe të qeshurat nën hundë. Siç mora vesh më vonë, kishte vdekur halla e vogël, ndërsa mua më kishin rrasur, pa e kuptuar, në të vetmin cep të shtëpisë ku nuk kishte lëvizje. Atëherë nuk e kuptoja dot se, përse atë e quanin halla e vogël, derisa, vite më vonë, mora vesh se halla e madhe kishte vdekur pak përpara lindjes sime. Ato nuk ishin motrat e babait; vetëm halla e madhe kishte qenë motra e gjyshit, kurse plaka tjetër, ajo që kishte vdekur atë ditë, ishte gruaja e një kushëriri. Ky kishte pasur vetëm një vajzë, të cilën e kishte lënë jetime, pa mësuar akoma të ecte. Kjo vajzë ishte martuar me kohë dhe gjyshi im kishte qenë e vetmja mbështetje për hallën e vogël. Thonë se e kishte dashur shumë tim atë, edhe mua përpiquej të më jepte shenja dashurie, ndonëse më ngjallnin shumë frikë rrobat e saj gjithnjë të zeza dhe shpina e kërrusur. Megjithatë, unë nuk qaja kur ajo më merrte në krahë, ose të paktën kështu thonë, pasi unë besoj se do të kisha dashur të qaja.

*“...pashë dritë n'tokë;
ndaj u linda”*

Këto vargje të Soreskut nuk i dija atëbotë; nuk i dinte as ai fëmija i vogël, me atë vështrimin e ngulur tek ato shkallë të errëta që, ashtu si dhe unë sot, kërkonte dritën i uritur, me imazhin e yjeve në bebe të syrit. Tani që e mendoj më mirë, ky duhet të ketë qenë imazhi i parë i fortë për botën, por jo kujtimi. Kujtimet e para, në fakt, më vijnë nga të tjerët. Ditën që u linda, djali i mamisë së fshatit, në atë mesditë dhjetori plot diell, bëri plot dy kilometra

vrap, për t'i dhënë lajmin gjyshit tim. Thonë se gjyshit i ra qeleshja nga koka, ndërsa po kërkonte kartëmonedhën 100-lekëshe, për t'ia dhënë lajmësit. Në fakt, mbi atë copë letre jeshile shënonte vetëm: “10 lekë”, por atëherë, sapo ishte bërë kalimi i lekut nga i riu tek i vjetri, andaj ishte e vështirë të pretendoje që fshatarët e asaj kohe të flisnin me lekë të reja, aq më tepër që, sot e kësaj dite, akoma flitet me lekët e vjetra. Po le të kthehemi te gjyshi im; ai kishte vetëm një djalë dhe unë isha nipi i parë që vija në jetë. Kjo ishte një arsye e mjaftueshme, për të përligjur gëzimin e tij, ndonëse kishte dhe disa arsye të tjera, siç do t'i mësoja më vonë. Duhet të jenë lutur shumë për një djalë, ndoshta dhe kanë toleruar diçka në kërkesat ndaj Zotit, gjersa Ai më zgjodhi mua si nipin e tyre. Thonë se, gjyshja ime, falenderonte Zotin deri në pesëdhjetë herë në ditë, teksa, shpesh, më ngrinte sa më lart që mundte në drejtim të diellit, nën vështrimin jomiratues të nënës sime.

Kujtimi i dytë, i përcjellë nga të tjerët, ka lidhje me dajën tim, atë që i hanin duart për çdo lloj pune. Atë e thërrisnin kur donin të lyenin shtëpinë, kur donin të bënin ndryshime në banesë, të rregullonin një derë, të hapnin një dritare, apo qoftë edhe kur donin të ngulnin një gozhdë. Atëbotë, duhet të kisha qenë rreth gjashtë muajsh dhe nëna më lidhte shpesh në djep. Ajo merrej me punëdore; turrte leshin e deleve në furkën e drunjtë, apo mbështillte shkulat e penjve, teksa përkundte djepin me gishtin e madh të këmbës së djathtë, sa herë që unë nisja të qaja. Sipas dajës tim, të qarat e mia zgjasnin dy-tri sekonda dhe përsëriteshin periodikisht, çdo pesëmbëdhjetë minuta, teksa nëna ime më qetësonte me vetëm dy përkundje: brràm-brràm, brràm-brràm. Gjithnjë, vetëm dy përkundje. Daja punonte gjithnjë vetëm, ndaj kjo gjë i kujtohej mirë. Që atëherë e deri më sot, të gjithë mendonin se nuk kishte djalë më të urtë se unë, vetëm babai kishte nisur të thoshte: *“Ah, nuk e njihni ju jo! Ky është një thëngjill i mbuluem, që léne o Zot”*.

Sa herë që mundohem të gjej arsyet apo ndodhitë, që e

bënë tim atë të zhgënjehej prej meje, nuk e shmang dot kujtimin e asaj të diele paradite; duhet të ketë qenë prill ose maj, kurse unë nuk isha më shumë se tre vjeç e gjysmë. Në fshat ishin hapur disa dushe publike dhe kujdestarja e tyre e kishte shtëpinë në kodrën përballë. Im atë, i cili kishte vendosur t'i provonte dushet, ngaqë nuk ishte i sigurt nëse ishin të ndezura ditëve të diela, më dërgoi mua që të flisja me kujdestaren. U nisa drejt kodrës plot qejf, sidomos ngaqë po më jepej mudësia të ndihmoja babain, por, kur arrita te shtëpia e saj, një qen i kuq më trembi për vdekje. Dera e jashtme e shtëpisë ishte e hapur, kurse qeni i zgjidhur e ndaloi vrullin, vetëm pranë shtegut të gardhit që rrethonte një si punë oborri. Qeni ndaloi vrullin, por jo të lehurën, ndërsa unë, kisha ngrirë pranë gardhit, i pavendosur. Kur pashë se qeni nuk po e kalonte shtegun, mora zemër dhe thirra emrin e kujdestares së dusheve; një herë, dy herë, tri herë... Sa dëgjonte zërin tim, të lehurat e qenit bëheshin akoma më të llahtarshme, kurse nga shtëpia me derë të hapur nuk përgjigjej njeri. Si u binda se ishte e kotë të rrija aty, vendosa të kthehem, por nuk kisha hedhur më shumë se pesë hapa, kur qeni kapërceu shtegun e m'u turr. Duke marrë frymë me zor, më shumë nga frika sesa nga lodhja, u ngjita gjer në pikën më të lartë, për t'u lëshur pastaj si shigjetë, në tatëpjetën drejt shtëpisë sime. Sa më shumë largohesha, aq më të rralla bëheshin të lehurat e qenit, ndonëse filluan të dëgjoheshin edhe të lehurat e qenve të tjerë; i fundit zuri të lehte qeni ynë. Ky, me sa duket, qe ai që e nxori babain jashtë derës së oborrit. Ndihesha fitimtar, ia kisha dalë të shpëtoja pa u lagur, nga një situatë e vështirë, por ai, kur mori vesh dështimin e misionit tim, tha vetëm: *“Ti nuk duhesh për kurrgjâ”*.

Historia e dhimbshme e motrës sime dhe roli im në këtë histori, e përforcoi akoma më shumë imazhin e dështimit tim në sytë e tim eti. Sa herë që përpiquesha të bija në sy të shoqërisë, apo të kushërinjve të mi, ai do ta gjente gjithnjë mënyrën, për të më poshtëruar, apo, të paktën, t'i vinte fre entuziazmit tim, duke më përmendur dështimet apo veset e mia. Por, ajo që e bëri të ma

vinte vizën fare, ishte ngjarja e para tri viteve, kur isha akoma skënderbegas. Babai kishte marrë rrogën, si kryeagronom i kooperativës dhe ishte nisur, pa i thënë gjë askujt, drejt Tiranës; natyrisht, me të vetmin tren që kalonte katër herë në ditë pranë fshatit tonë, dy herë në një drejtim dhe dy herë në të kundërt. Erdhi të më takonte në minutat e fundit që ia lejonte orari i trenit të kthimit. Megjithatë, me aftësitë sugjestionuese që e karakterizonin, arriti të më nxirrte dy ditë leje. Ishte e premtë pasdite. Morëm autobusin e unazës, mes të shtyrave të zakonshme të asaj ore, që korrespondonte me fundin e orarit zyrrar. Kishim akoma edhe një stacion për të arritur në destinacion, kur im atë vuri se i mungonte portofoli. Menjëherë, identifikoi dy të dyshuarit kryesorë dhe i kërkoi shoferit të ndalonte autobusin. Njëri nga hajdutët e supozuar nisi të tregohej agresiv, teksa shoferi i autobusit, i cili po bëhej gati të dorëzonte turnin, turfullonte i pavendosur. Ndërsa babai po mendohej t'i mbushte mendjen shoferit që ta kthente autobusin drejt komisariatit të policisë, “agresivi”, përfitoi nga rasti dhe zbriti nga autobusi, menjëherë sapo shoferi vendosi të ndalonte dhe të hapte dyert e tij. Babai, më urdhëroi që të mbaja tjetrin dhe u nis me vrap drejt burrit që po largohej; e arriti me dhjetë hapa dhe po i kërkonte të zbraste xhepat. Tjetri, më pa në sy dhe, si vuri re pavendosmërinë time, u bë edhe ai trim. Zbriti nga autobusi dhe ia futi vrapit, para se unë të lëvizja dorën drejt tij. Nuk e kisha marrë ende veten nga intensiteti i lartë i ngjarjeve, kur im atë kishte mbaruar kontrollin e xhepave të të parit dhe u kthye nga unë:

- Ku është tjetri? - Mua më ishte lidhur gjuha; nuk fola, vetëm ula sytë te majat e këpucëve të mia.

- T'thâshë mor jahù, se s'tkom mòr gjò, - tha hajduti i supozuar, i cili kishte marrë pozën e të ndershmit të fyer.

Babai e kuptoi se kishte marrë fund gjithçka, ndonëse ishte i bindur se njeriu që kishte përballë kishte marrë pjesë në vjedhje. I zgjati dorën, duke i kërkuar ndjesë. Në çastet e para që ngelëm vetëm, më mbuluan një palë djersë të ftohta dhe nuk e ngrija dot

kokën që ta shihja në sy; nga çasti në çast prisja të më thoshte: “*Ti nuk je per kurrgjâ*”, “*ti nuk je per kurrgjâ*”.

- Po tash? Nuk kena as lekë për bileta, - zëri i tim eti ishte i thellë e i mbytur, sikur dilte nga fundi i pusit.

- Kam un lekë... besoj se na dalin, - Pa e kuptuar, kisha ngitur kokën dhe po e vështroja me një lloj krenarie të ndrojtur; më kishin shpëtuar lekët e kuotave të rinisë, që rastësisht i kisha me vete.

- Jà ku hyne edhe ti n’punë per dishkà, - Kjo ishte ajo çfarë tha, kurse sytë e tij tregonin tjetër gjë.

E kapëm trenin në çastin e fundit dhe zumë vend në vagonin e parë ku gjetëm vende bosh. Gjatë tri orëve e gjysmë udhëtim me tren dhe një gjysmë ore ecjeje në terr, ai nuk e hapi më gojën të më fliste.

TOKË E SHPIRTËNVE

*Ujët e lumit tëm, s'derdhet n'det!
Platoniku.*

Kumbona e kishës s'shenjtorvet, kish dò çaste që po lshonte tingllimen e saj t'ashper, tue vrá paburnnisht qetîné e asaj nate vere. Ish-sekretari i partisë, që tash sa mote po kryente detyren e kujdestarit t'kishës, ju afrue kampanjelit, tue u dridhë si thupra n'ujë. Gongu prej metali, po perplasej pa prá te paretet e bronxta, ndonse konopi ish i lidhun nye m'çengel. Bani kryq, per t'paren herë pa praninë e padres. I kryente me rend te tâna zyret e ritet fetare, por gjithnjë prej drojes s'priftit. Râmja e diktaturës e kish lânë pa zeje e pa mundsî tjetër jetese; puna n'famulli ish per të, si shiu n'shkretinë.

Ksaj here gishtat nuk i luejten prej drôjes, kish ba kryq, si me kenë tue thânë: "Rrnoftë partija". Shkandullimi¹ i truve nuk i îku, as kur muer teposhten per kah shpîja e vet; veç kur hyni mbrëndë e ja vûni shulin derës, ndjeu gjakun t'i levrinte nder deje sërish. Njajo kumbonë që binte pa e nxit kush, ja kish turbullue krejt besimin, ma fort se t'ardhunit e demokracisë. Tânë naten e lume, s'vûni gjumë n'sy, por anîmirë që nuk ndëjti perjashta e me pá.

Kumbona, n'ket mndyrë, bjen kà 'i her n'muej; veçse, shtojzovallet sugurojshin që askush, t'mos gjindej te kampanjeli

at ças. Kjo kish kenë një e ráme e papritun, q'i kish xanë Orë e Zana, ndò n'gjumë t'thellë, ndò m'ndoj gosti. S'parit rrânë² dò hije prej kodrinave t'buta, kah ana e t'lémit. Fill mbas tyne zbriten dy re prej permëndorevet, teksa një ferfllimë e lehtë duel prej një vorri t'ri.

- Shkà ka bá vaki? - T'rámmi³ e parë, ju mblollne n'frymë dy shpirtnave t'permëndoreve.

- A s'po e shifni njëkyt vorr? - Hija ish bá gisht. - Bash n'tokë tême...

- Kurse nâ nuk kena vorr kund, - ja pshteti hija-hijes.

- ...T'pakten ju e keni ka 'i permëndore... keni ku t'xeni.

- E nâ vïjmë rrotull n'per kodrina, - shperthyene hijet e tjera, gadi njëzâni.

- Ky italjani i vorruem ktu, diq vëdit e n't'shtrueme⁴ ... jo si shpirti jonë qì duel prej zidanit⁵.

- Italjan e ke edhe shoqin tând t'permëndores...

- Anì shkà... mos nuk e kam t'drejten e Zotit me kelthitë?

- Jo s'e ke... - Lahuta e Malcis kish ardhë e hijet e tjera u terhoqen per me i lshue vënd.

- Ju te tanë duhet me u knâqë, pse kanë ardhë ditë ma t'mira per vllâznit tanë.

- Ti e ke kollaj, o Lahutë, gjîndja⁶ s'kanë dijtë kurr me t'nxjerrë prej zëmre a prej goje.

- Kocat e mù po krypen n'dêtë e s'kam per t'gjetë kurr qetì... Aspo mëndon se janë, prap nen Urë t'Bunës?

- Un kam pesqind vjet qì s'gjej t'prehun,- një hije e nâltë u fshâu permbi krye.

- Po ty, kush t'bzâni?

- Ndígiova kumbonët.

- Ti s'ke tager⁷ me ardhë ktù, tokët e tueja kíen pteje Matjes.

- Veç, jo larg prej ktuhit, kjeçë shtie n'vorr.

- Ti s'ke shkruë dy t'rimueme, tânë jeten tânde.

- Ky kjë muza jonë, n'Te kem lidhë Kombin. - Zâni i Lahutës, i báni te tanë me heshtë, - Mirë se t'prú Zoti, o zot i Arbnit!

- Kam dò vjet qì due me ardhë, veç s'po m'lén idhnimi⁸.

- E shkà ta ka helmue zêmren, o Zoti ynë?

- Kocat m'janë trêtë, tash sa shekuj e mote, veç... gurin e vorrit ma kanë luejtë.

- Mos brè!

- M'kanë ngritë një memorial madheshtuer, bash njaty ku pata prè 'i tradhtuer...

- Kqyre, shkà po ndígiojmë?!

- Gjîndja vijnë per me m'ndêrue, po mue m'kapin xhindet e prej pezmit... due me i gjuajtë me gûr prej s'nâltit, aty n'kala ku m'paten shtie n'dhé, bashk me dhînë Amaltea. Poluksi e Kastori, t'bÿjtë Lejdas, m'bájnë shoqni, bashk me Mujin e Zanat e Tâmlit t'Fuqisë.

- ...Edhe Ju s'muejki me i luejtë gurët?

- Njì rasë, e shkula 'i shkâmb... po s'm'báni zêmra me jau lshue.

- Nuk kanë faj gjîndja... po lkura e djallit, - Lahuta u kthye kah vorri i ri. - Kush â ky mik, qì po dòn me buejtë n'kto troje?

- Âsht një misionuer i devotshem.

- Ti Vandâku i Ferrave e ke vorrin tând, andaj s'ke pse prish qejf me kând...

- Un flas t'drejten e Zotit...

- Drejt ke folë, - një hije e zbehtë rrshqiti prej mureve t'kishës.

- Po ku je o T'Krijuemt e Rruzullimit? Kena vite pa t'pá!

- Un ktù s'kam kurrnjì gûr ku t'kapem, s'ka mbetë as shêji i shpîsë ku kam pasë lé; ti Martir, ke plot nipa e mbesa ksajt, kurse t'mÿjtë janë perdá⁹ si zojtë e qyqes.

- ...

- Lahutë, njìky ta ka vndue at kryq, bash kè toka ku ke lé.

- E paska meritue m'e thirrë n'vallen tonë...

- Mirë se t'prue Zoti, o Ândrra e Jetës!
- Mirë se t'gjeta o Lahutë... me Trimninë e Osos!
- ...Si pat ndîgiue Vajin e Bylbylit
- Hajde vllâzën, ta nderojmë rishtarin! ...prîna, o Lahutë!

Atbotë ka nisë vallja e shpirtënve. T'janë çue Orë e t'janë çue Zana, âsht çue pluhni mjë n'kala, janë ûlë rêtë n'Drî me u lá. Kjo dò t'kish kënë e tepert per sytë e kujdestarit t'meruem¹⁰, qì po luftonte me xhindet, per me mùjtë me bá një sy gjumë.

II

Të nesërmen, u zgjova nga zhurma e ujit të çezmës që po vërshonte nëpër oborr; me sa duket, kishte marrë pushim kuçedra që bllokonte ujin. Sapo përfundova së lari, pata ndjesinë e të rënit dhjetë kile nga pesha. Babai kishte dalë me kohë, kurse nëna po milte lopët. U ngjita sipër, të përshëndesja motrën e sëmurë. Ndërsa po ngjisja shkallët e drunjta, e dëgjova të thërriste emrin tim. Vëllezërit dhe motra e vogël po flinin ende, andaj përfitova nga rasti të derdhja dy pika lot. Motra vazhdonte të thërriste emrin tim dhe qeshte papushim. Dukej, sikur nuk donte ta përziepte me ndjenja të tjera gëzimin që i buronte nga fakti që po më shihte sërish. Doktorin na pati thënë se, bashkë me palcën, i ishte dëmtuar edhe mundësia e zhvillimit të trurit; për nga mendimet, ajo do të ngelej gjithnjë një vajzë e vogël 6-vjeçare. Ia putha balluket, deri sa m'u tha loti në faqe. E ngrita në karrocë dhe e nxora në ballkon. Tri metra i gjatë dhe as dy metra i gjerë: kjo ishte gjithë hapësira, ku pashë për herë të parë diellin. Një rrjetë me tela, gjashtë centimetra të trashë, ndante cepin e ballkonit me tandën e hardhisë. Më në fund, im atë kishte ndërhyrë për të siguruar vendin, ku unë dhe dy motrat e mia ishim rrëzuar disa herë. Megjithëse, fatmirësisht, pa dëme serioze.

Nëna kishte mbaruar së mjeli lopët dhe, duke ma blerë mendjen, më nxiti të dal. Si mbylla portën e oborrit, u nisa drejt qafëzës, një shesh i vogël në formë trapezi, ku sa e sa herë kishim luajtur futboll, herë me një e herë me dy porta. Ndoshta ishte koha, ajo e bënte të dukej shumë më e vogël, apo mos ndoshta komshinjtë i lëviznin çdo vit gardhiqet, duke e zvogëluar,

gjithnjë e më tepër, sipërfaqen e së parës hapësire publike që kisha njohur. Pikërisht këtu, teksa po luaja skulptorin, me duart e zhytura në baltë, më përshëndeti ai që, një ditë, do të bëhej mësuesi im i letërsisë. Siç e mora vesh më vonë, im atë e kishte dërguar të më testonte në isha apo jo i aftë për të nisur shkollën. Isha vetëm pesë vjeç e gjysmë dhe, duke qenë krejtësisht i zhytur në lodrën time me baltën, as që iu ktheva përgjigje pyetjeve të tij, ose ndoshta thashë ca fjalë të vakëta, që më shpëtuan nga regjistrimi në shkollë për atë vit; fakt që tashmë, kisha filluar ta shihja si një vit të humbur kot, ndonëse, atëbotë, e shihja vetëm si një dimension lirie.

Ngjitja e malores për në qendrën e fshatit më mori disa minuta më shumë se zakonisht. Sapo dola në hyrje të sheshit, sytë më shkuan te trekëndëshi i parullave revolucionare në beze. Ajo që shkruante: *“Gruaja, forcë e madhe në ndërtimin e socializmit”* ishte grisur në formë trekëndëshi dhe bezja, mbi të cilën ishte pikturuar një grua muskuloze me kazmë në dorë, përplasej papushim mbi pjesën tjetër të parullës, në sinkron me intensitetin e erës. Dy të tjerat ishin të pagrisura, por lagështira kishte nisur t’iu gërryente bojën e shkronjave, aq sa, mezi lexoheshin. Ndërsa po përpiqesha të deshifroja tekstet, dy duar të ashpra më mbërthyen sytë.

- Gjeje se kush jam. - Nuk tentova të gjej emrin e të pafuarit, thjesht preka lehtë gishtërinjtë që më kishin bllokuar pamjen. - Po ku je, o demokriti i parë i fshatit?

- Nà e themeluem degën e Partisë Demokratike, - sytë i kisha të lirë dhe tashmë i shikoja qartë dy bashkëfshatarët e mi.

- Shumë mirë... - desha të shtoja dhe diçka tjetër, por nuk më dolën fjalët.

- ...Ti kishe pàsë t’drejtë, - po fliste sërish i pari, - po kah ta dijmë nà...

- Nejse... gzoheh qì po ju shoh dhe kjo qì m’thâtë, m’gzon edhe ma teper. - Në fakt, nuk kisha menduar për asnjërin nga ata, para tre muajsh, kur kisha sjellë me vete programin nismëtar

të partisë së parë opozitare në Shqipëri. - Po tjetër, shkà keni bá?

- Po já, kqyre qysh i kena bá zyret e koprativës, - Po fliste pikërisht ai që, para tre muajsh, më kishte thënë se duhej të më vinte turp që po dilja kundër Pushtetit Popullor; atij pushteti, që më kishte dhënë mundësinë të shkoja në shkollë të lartë.

- Pallatin e Kulturës? - Për herë të parë hodha sytë nga ndërtesa dykatëshe, krenaria e bashkëfshatarëve të mi. Për një çast, mendova se ndërtesa ishte bombarduar.

-Po ç'Pallat Kulture, more?! A nuk e pàten zyren njatý edhe kryetari i koprativës, edhe sekretari i partisë?

- Ktò ishin edhe orientimet e qendrës, - po fliste sërish, akuzuesi i para tre muajve.

Në mendje më erdhën debatet e kohëve të fundit në Qytetin Studenti; tani po e kuptoja, përse asnjë nga kryesia e partisë së re nuk erdhi të mbështeste grevën e urisë së studentëve. Nuk e pranova ftesën e tyre për kafe dhe ngjita shkallët e Pallatit të Kulturës, duke hapur rrugën mes librave të “dullës”, derdhur andej-këndej. Atelieja e piktorëve ishte bërë për faqe të zezë. I hodha një sy sallës së madhe që prej portës së pasme të llozhës dhe u drejtova me të shpejtë për në bibliotekë; me sa dukej, isha dora e fundit ose e parafundit që do të merrja libra aty. Ndërsa i shikojta ata libra të pagojë, që dergjeshin mbi dyshtemenë e ashpër, m'u kujtua dita ime e parë në këtë sallë. Të mos ishte buzëqeshja dashamirëse e bibliotekarit, do të isha larguar pa marrë asgjë. Më kujtohet edhe libri i parë, i cili, në fakt, nuk ishte libri i parë jashtëshkollor që pata lexuar. Leximin e parë e kisha derdhur mbi një libërth, ku mbizotëronin ca figura plot ngjyra. Sytë më shkuan te *“Goja e kalit”*. E hapa dhe lexova disa rreshta; shpejt kuptova se ishte libër i mirë. Dola, nuk mund të rrija më në atë ambient. Ndërsa zbrisja shkallët me librin e “zgjedhur” nën sqetull, kujtesa u ndal te libri i fundit që pata “dorëzuar” aty, diku para gjashtë vitesh. E kisha futur poshtë derës së mbyllur, andaj m'u desh shumë kohë që ta bindja bibliotekarin pasionant, për të ma fshirë detyrimin nga kartela. Po ku të ishte vallë ai? ...A e

imagjinonte dot i varfëri, se si ishte katandisur shtëpia e librit?! Para tre muajsh, besoja se mund të ndryshonim botën, kurse, tanimë, po kuptoja se mezi ia kisha dalë të ndryshoja veten time dhe kjo nuk ishte më e keqja, më e keqja ishte se nga ky ndryshim do të vuaja gjithë jetën.

Im atë e kishtë zët të më shikonte gjithë ditën me libra në dorë: *“Hiqi ato drej librash”*, - më thoshte, *“se do të budallallepsesh fare.”* Një ditë, erdhi deri te shkolla ime, me të vetmin qëllim: t’i porosiste mësuesit, për të mos ma ushqyer një pasion të tillë. Kjo ishte hera e dytë që ai vinte në shkollë për mua. Herën parë, erdhi në një mbledhje prindërisht, por, në vend që të vinte te klasa ime, shkoi një vit më poshtë; foli e foli për njëzet minuta, derisa dikush, me sa duket i lodhur nga fjalimi i tij i gjatë, i kujtoi se kjo nuk ishte klasa e djalit të tij. Nëse hera e parë shkaktoi vetëm një të qeshur, vizita e tij e dytë i shtyu disa mësues të m’i merrnin romanet e fshehura poshtë bankës, të cilat, shpesh, i lexoja me bisht të syrit, gjatë orëve të gjata të mësimit. Nuk është se isha i pavëmendshëm ndaj mësimdhënies, përkundrazi, por dyzetë e pesë minutëshi kishte plot hapësira boshe, të cilat mendja ime kërkonte t’i mbushte me diçka tjetër.

Libri i parë që më ka lënë mbresa të forta ka qenë një roman historik, i cili fliste për jetën e fiseve në epokën e gurit. Tashmë, nuk më kujtohet as titulli, as autori. Kur më ra në dorë një libër tjetër, i po këtij shkrimtari, më kujtohet shumë mirë, jo vetëm titulli, por edhe aventurat e personazhit kryesor. Librin *“Uni, i biri i mamuthit”* e mbajta deri vonë. Ishte pikërisht ky libri që kisha futur poshtë derës së bibliotekës. Si e mbarova së lexuari, bëra një orë e gjysmë rrugë në këmbë, për t’ia dhënë një shokut tim, i cili kishte lexuar edhe librin e parë; kisha një nevojë të papërballueshme, për ta ndarë me dikë tjetër kënaqësinë që më kishte dhënë leximi i tij. Ai shoku, i cili më zhgënjeu atëbotë, kishte ndarë me mua gëzimin e atij librit të parë, të cilit nuk ia mbaja mend titullin. Edhe dorëzimi i atij libri poshtë derës, sot më duket një budallallëk me brirë, sidomos pasi e pashë se si

u katandis biblioteka e fshatit dhe që, me sa po shoh, i humba përfundimisht lidhjet me njeriun prehistorik të atij romani. Këta dy libra ma patën zgjeruar, asokohe, konceptin tim për kohën, ashtu si librat e Tor Hejerdall-it, m'i kishin ridimensionuar njohuritë e mia për hapësirat e pafundme tokësore. Ato udhëtimet e tij, me atë *"kon-tikin"* prej kallami a prej bambuje, ndonëse sot mund të duken kujtime të mërzitshme, atëbotë më mbushën me një aromë lirie dhe i dhanë krahë fantazisë sime, aty mes indigjenëve të ishujve polinezianë, të Paqësorit të pafundmë.

Është edhe një bibliotekë tjetër që ka lënë gjurmë të thella në fëmijërinë time. Në verën mes klasës së tretë dhe të katërt kisha përfituar një shpërblim prej dy javësh pushime, në kampin e pionierëve, në plazhin e Shëngjinit. Një të shtunë me shi, na çuan për vizitë në këtë bibliotekë. Ndryshe nga shumica e bashkëmoshatarëve, që u mërzitën shpejt nga librat dhe po kërkonin mënyra të tjera argëtimi, unë përzgjodha tre libra dhe u ula të lexoja. Nga zhurma që ata po bënin, desh na nxorën jashtë menjëherë, por na dhanë edhe një shans të dytë, pas disa paralajmërimeve të forta. Ndërsa kuptova se nuk kisha shumë kohë në dispozicion, lashë librin e parë dhe u zhyta në të dytin; doja ta përthithja, medoemos, gjithë mesazhin dhe magjinë e atij libri, në ato pak minuta kohë që kisha. Isha akoma me këtë libër në dorë, kur na nxorën jashtë. Këtë radhë, disa nga tanët e kishin tepruar vërtet me rrëmujën dhe zhurmën e shkaktuar. Nga biblioteka nuk lejohej të dilnin libra dhe ne nuk na sollën më aty, andaj, për librin e tretë, abstragova mbi subjektin e tij, gjithë periudhën e mbetur të pushimeve, duke u nisur vetëm nga titulli i tij, i cili tashmë nuk më kujtohet fare. Atë natë nuk më zinte gjumi, kurse në mëngjes, u ngrita vonë dhe shpejt nisa të qaja, pasi zbulova se më kishin vjedhur të gjithë lekët që më kishte dhënë babai me vete. Rreth meje u grumbulluan shumë bashkëmoshatarë, të cilët po ktheheshin nga menca, ku sapo kishin ngrënë mëngjes. Papritur, njëri prej tyre nxori ca lekë nga xhepi dhe nisi t'i numëronte. Dikush e pyeti, nëse do ta

dëmspërblente ai humbjen e parave, kurse mua, nuk më hiqet edhe sot dyshimi se, ai po kontrollonte nëse ortakët ia kishin dhënë tamam pjesën e tij. Nuk e harrova për shumë kohë fytyrën e tij, por për t'i thënë nuk i thashë gjë; ashtu sikur nuk i thashë askujt gjë, as për atë vajzën, dy vjet më të madhe se unë, së cilës, im atë i la 100 lekë, për të më dhënë nga 10 lekë në ditë, por që në fakt, më hëngri më shumë se gjysmën e tyre. Mua, atëherë më vinte jashtëzakonisht turp, të akuzoja dikë për veprime të pamoralshme. Nuk ia lejoja dot vetes të turpëroja dikë, aq shumë e vuaja peshën e moralit atëbotë, kurse tani e shoh ndryshe. Këtë ndodhi, sot e shoh si taksën që duhej të paguaja, për privilegjin që posedoja para xhepi, në një vend e një kohë, kur kishte fëmijë që nuk e njihnin fare aromën e lekut.

Ndërkohë, ndodhesha sërish pranë parullës gjysmë të grisur. Që aty, munda të dalloj oborrin e shtëpisë së vëllait të pronares së kandilit me vajguri. Nuk mund t'ia çoja porosinë në vend, pasi aty vura re një shoqen time të dikurshme të klasës, me një fëmijë të vogël në krah, me sa duket i biri, pasi kisha dëgjuar për martesën e saj. Kjo femër, dashur pa dashur, kishte lënë ca gjurmë të pashlyeshme në formimin tim seksual, andaj e kisha të vështirë të përballesha me të, në këto kushte. Përceptimi i parë për seksin, i atij fëmijës së vogël që më vonë do të bëhëj “unë”, ishte diçka që i bëhej motrës apo nënës së “tjetrit”, për ta poshtëruar apo për ta sfiduar. Ishte një tronditje e madhe për këtë fëmijë, kur kuptoi se seksi ishte edhe kënaqësi. Ishte pikërisht kjo, shoqja e dikurshme e klasës, nëpërmjet imazhit të së cilës, imagjinata dhe fantazia, arriti t'i jepte të parën drithërimë zemrës, drithërimë që buronte nga kënaqësia që të jepte kontakti apo afërsia e mishit të seksit të kundërt, aq shumë të dëshiruar.

Tek i vetmi lokal i fshatit, pashë kurrizin e tim eti; nuk ndihesha në formë për t'u përballur me të, andaj mora rrugën e shtëpisë. Tashmë, malorja kthehet në një të tatëpjetë dhe trupi sikur relaksohet në një lëvizje të lirë. Papritur, pashë një tjetër shoqe klase, që për shumë kohë e kisha patur edhe shoqe banke.

Shpejtova hapin dhe, për efekt të pjerrësisë së madhe të rrugës, pa dashjen time të plotë, përfundova në një vrap të lehtë. Duhet të kem bërë figurë të keqe, megjithatë, më mirë që ndodhi kështu, nuk dua t'i ngjall shpresa të kota. Sa herë që e takoja, vëreja emocion në lëvizjet e saj. Vite më parë, ka mundësi të kem qenë në klasë të shtatë ose të tetë, ndërsa po luante me disa shoqe të veta, njëra prej tyre, në inat e sipër, iu drejtua asaj me emrin tim. E përsëriti disa herë dhe me inat të pashuar, aq sa, skuqja e saj po më kalonte edhe mua, mbrapa depos së ujit ku isha fshehur, në funksion të lojës kukafshehthi, që po luanim ne djemtë. Edhe atëbotë ika me të katra, sapo filloi kapja për flokësh e dy femrave të xhindosura, njëra nga xhelozia e tjetra nga turpi. Sesi është kjo botë?! Njeriu është gati të japë gjithçka, vetëm për një buzëqeshje të njeriut të zemrës, ndërsa ikën me vrap, përballë ndjenjave të ngjashme të tjetrit. Më mirë të mos i kisha marrë vesh kurrë ato ndjenjat e saj për mua, pasi, kjo gjë, më bëri të mendoj se, edhe ajo tjetra, do të ikte me vrap sapo të merrte vesh për ndjenjat e mia. Ka mundësi të kem qenë në klasë të gjashtë, kur na ra në dorë një revistë, e cila proklamonte një lojë me letra; jo bixhoz, por një lojë me letra poste, ku të rinjtë i shkruanin njëri- tjetrit. Mësuesja e edukatës morale, na nxiti të futeshim në këtë lojë, por me sa duket, vetëm unë e kisha marrë seriozisht. Letrën që i shkrova shoqes sime të zemrës, e mendova gjatë, i kamuflova aq bukur ndjenjat e mia, mes stereotipeve moralizuese të gazetës, veçse kisha harruar kryesoren: askush nuk u mor me atë që kisha shkruar, por vetëm me faktin që i kisha shkruar asaj. Mes talljes së shokëve dhe vështrimeve me bisht të syrit të vajzava, unë nuk e përballova dot situatën dhe i lashë pa bërë dy orët e fundit të mësimit; mirë që ishte ditë e shtunë. Të hënën, shkova në shkollë, sikur të mos kishte ndodhur asgjë dhe pata fat, një ngjarje tjetër kishte rrëmbyer vëmendjen e klasës; nuk thonë kot, se çudia më e madhe tri ditë zgjat. Pavarësisht të gjithave, kjo histori hyri në “analet” e shkollës, si e vetmja deklaratë dashurie publike, ndonëse, unë nuk guxova më t'i afrohesha asaj vajze. Nuk e di

se çfarë prisja të ndodhte, por një gjë është e sigurt; sa herë që i nxirrja ndjenjat në dritë, ato më shkriheshin si kripa në ujë. Disa muaj më vonë, një kushëriri i saj, më tha me zë të ulët se, nëse kisha qëllime serioze, ai mund të më ndihmonte. Nuk e kuptoj as vetë se çfarë më ndodhi, por, fill pas këtij takimi, ndjenjat e mia për të filluan të zbeheshin. Ndoshta, ishte vulgariteti apo meskiniteti i mendimeve të njerëzve që na rrethonin; ndoshta po zhgënjehesha dalëndadalë nga qëndrimi i saj; apo ndoshta, ëndrrat e mia ishin aq të bukura dhe shpirti im, aq i pastër, saqë vyshkeshin e thaheshin me të dalë në dritë... nuk e di.

Pa e kuptuar, kisha arritur në shtëpi. Mes gjetheve të hardhive të tandës së rrushit, pashë tri hije që po rrinin në ballkonin tonë, atij që dikur i thoshim qoshk. Tashmë, nuk ishte ajo hapësira e vogël e fëmijërisë sime; ballkoni ishte zgjatur deri në shtatë metra, shto këtu edhe pesë metra nga ana e fqinjëve-kushërinj, hapësirë që ndahej vetëm nga disa vazo lulesh, të cilat, në raste festash, i hiqnim fare. Pikërisht, në dy anët e këtyre vazove, nëna dhe motra ime e vogël, po bisedonin me gruan e fqinjit. Ndërsa ngjisja shkallët e brendshme, fjalët e tyre vinin gjysmake, deri te veshët e pipëzuar të kokës sime të përhumbur. Diçka më tërhoqi në bisedën e tyre, ndaj e pyeta time më, natyrisht, pasi u largua gruaja e kushëririt, ndonëse ajo ishte si një nënë e dytë për mua. Nuk më kujtohet fare, se ç'ishte ajo gjë për të cilën pyeta, vetëm pëgjigjja e saj m'u ngul në tru: "*Ata qi kanë jetue para nesh n'kyt shpi...*". Desha ta pyes se ç'donte të thoshte me këto fjalë, por gjuha m'u lidh nyje, kurse nëna humbi mes punëve të përditshme.

Sytë më ngelën te muri i oborrit, i cili, tashmë, ishte ngritur në nivelin e ballkonit; tela të tendosur nga të dyja anët, i mbanin fort degët e hardhive të të dy oborreve fqinjë. Dikur, ky mur, kishte qenë vetëm një muranë e gjerë gurësh të thatë, as një metër i lartë; këtë e mbaj mend mirë, sepse, si një djalë i vogël gjashtëvjeçar që isha, ngrihesha në majë të gishtave, për të parë në oborrin tjetër. Kur im atë më qëlloi me shputë për herë të

parë, ndërsa lotët më rridhnin rrëkajë në të dyja faqet, mblodha gjithë zemërimin tim e u thashë se do të shkoja në këshillin e fshatit, ku do të kërkoja pjesën time të shtëpisë. Kjo deklaratë shkaktoi ilaritet, gjë që e fyeu akoma më tepër sedrën time, aq sa, në të errur shkova te mullarët dhe përgatita aty një vend për të kaluar natën. Qëndrova aty rreth dy orë, derisa pushuan thirrjet në emrin tim. Pastaj, duke menduar se fqinjët nuk duhet të kishin fjetur akoma, hyra tek ata, që të kaloja disa minuta, meqë nuk po më merrte gjumi. Doli që ata ishin në dijeni të “humbjes” sime, ndaj u gëzuan shumë kur më panë, ndërkohë, njoftuan dhe nënën time. Hyra kokulur në shtëpi, i bindur se do të haja ca shpulla të tjera, por, për çudinë time, im atë, thjesht më tha të shkoja e të flija se kishte shkuar vonë. U shtriva në krevat si një humbës, por ngrohtësia e tij më dorëzoi shpejt në krahët e gjumit.

Ky kushëri, më mësoi të pija raki dhe të tymosja duhan. Sa herë që më mërznin në shtëpi, këtu e mbaja vrapin, sidomos kur binte shi. Që i vogël e ndihmoja të priste drutë e zjarrit; ai nuk e shuante kurrë sobën, ashtu siç nuk e ndante as gotën e rakisë. Një herë, më thirri ta ndihmoja, pasi nuk po arrinte të nxirrte dot raki nga një fuçi plastike, rreth pesëdhjetë kilogramëshe. Fuçia ishte vendosur, rreth një metër mbi tokë, mbi një tavolinë të vjetër; teksa plaku mendonte se duhet të kishte marrë ajër zorra, me të cilën ai nxirrte raki. Ndërsa hipja mbi tavolinë, u mbështeta lehtë te fuçia. Oh, çfarë habie! Ajo ishte e lehtë si gjethi. Hoqa tapën dhe pushë brenda, në fund të fuçisë, kishte a s'kishte një teke raki. Kjo histori u bë objekt humori për vite të tëra, por ai ishte një plak gazmor e nuk mërznitej. Më kujtohet si tani, teksa më kërkonte të përsërisja dhjetë herë rresht: *“Piva ujë per bires s'pipit”*, me shpresën se do të ngatërrohesha e do ta thosha ndryshe fjalën e fundit, ndonëse këtë gjë e kuptova shumë vonë.

Shtëpia po më dukej bosh. Ndoshta, sepse gjyshi e gjyshja, së bashku me tezen e babait, kishin vite që nuk ishin më në këtë jetë. Gjyshi u dobësua shumë vitet e fundit, ndoshta ngaqë nuk

lëvizte më nga krevati. Nuk fliste shumë dhe nuk bëhej kurrë me nerva. Kur e shqetësonte diçka, maksimumi që mund të mallkonte ishte: *“E marrtë Buna, e marrtë”*. Shpesh, më dërgonte që të blija makarona të gjata, të cilat ia ziente nëna ime në një tenxhere që nuk hiqej kurrë nga zjarri. Një herë, mbaj mend që shkova deri në një fshat të largët, po prapëseprapë nuk i gjeta ato të uruara makarona, kurse pesëlekëshin e kisha harxhuar. Makaronat kushtonin 55 lekë, kurse ai më jepte gjithnjë 60. Kur i ktheva lekët mbrapsht, pa pesëlekëshin e karameleve, që unë besoja se më takonin, për mundimin që kisha bërë, ai vuri buzën në gaz dhe uroi të më ecte në jetë, duke më vënë në dukje se ajo, nuk ishte pothuajse kurrë, kaq e lehtë sa po e merrja. Ai kishte qenë një burrë i nderuar në fshat; kishte trashëguar mjaft toka, të cilat i punonte i vetëm dhe kishte shpëtuar, për një qime, pa u bërë kulak. Në fshat e tregonin deri vonë atë historinë me Kryetarin e Komitetit, që e kishin pyetur se, ç’duhet të bënin me gjyshin tim që kishte një dele më shumë sesa lejohej. Proverbiale kishte qenë përgjigjja e këtij të fundit: *“Po shkojmë ta hãmë at dele dhe jemi të tanë në rregull, pastaj”*. Ishte po ky kryetar komiteti që i kishte thënë gjyshit tim se, kjo parti, e ngre ujin deri në majë të kodrës.

- Dhe partia e báni, - thoshte gjyshi im, - E njiti ujin n’maje t’kodrës edhe po i vadit tânë ato vneshta.”

Herën e fundit që e pashë gjallë, ndërsa na përsëriste për të njëqindtën herë këtë histori, i pata thënë se, në fund të fundit, për këtë gjë, duhej thjesht një pompë. Ai pati heshtur disa sekonda, teksa mbushej me vështirësi me frymë, me ata bulçitë e fikura dhe ata dhëmbët e rënë, pastaj më kishte hedhur një vështrim të trishtë, duke më thënë: *“T’pastë baba, t’pastë”*. Tani që e mendoj më mirë, më duket sikur ai dinte gjithçka, thjesht ishte dorëzuar dhe po përpiqej të na mbante larg rreziqeve. Më kujtohet im atë, teksa më porosiste para një viti, që vetëm me bllokmenë mos të shoqërohesh: *“Sa ma afer pushtetit, aq ma i madh rreziku”*, -thoshte ai.

Gjyshen, më dhemb në shpirt kur e kujtoj. Ajo ka ngelur në

mendjen time, ashtu siç ishte në vitet e fundit të jetës, kur kishte humbur kujtesën. Sillej e sillej nëpër shtëpi, duke na kujtuar për punët që duhej të bënim, ndonëse, shumë prej tyre, nuk ishin as në stinën apo vaktin e tyre, andaj, u mësuam t'i neglizhionim ato që ajo thoshte, madje, kam frikë se e harruam fare si njeri. Më ka ngelur peng në shpirt, dita kur do të nisesha për në vitin e dytë të Shkollës Ushtarake “Skënderbej”. Ndërsa po falesha me njerëzit e shtëpisë, i dhashë dorën bile edhe një bashkëfshatari që ndodhej aty rastësisht, kurse atë e neglizhova. Hipa në motorin e tim eti, i cili nuk foli asnjë fjalë, ndërsa unë, pas disa minutave rrugë, do të doja që më mirë të më kishte rrahur.

Gjyshja merrte një pension simbolik, prej katërqind lekësh në muaj, të cilin e mbante në arkën e drunjtë, diku mes rrobave të saj. Sa e pashë për herë të parë se ku i vendoste, nuk i rezistova dot tundimit, për të marrë një kartëmonedhë 100-lekëshe. Motra po ruante te dera e dhomës, kurse unë ngrita kapakun e arkës; frymëmarrja nuk më ishte rregulluar, as kur, bashkë me motrën, kishim dalë në bahçe dhe po e vështronim gjithë kureshtje atë kartëmonedhë që, deri atëherë, e kishim parë vetëm nga larg. Për një javë të tërë u kënaqëm me biskota të ëmbla që kishin dalë kohët e fundit, apo me karamelë “Zana”, deri edhe te kompostot e pjeshkave që i hanim me dorë. Ngaqë herën e parë nuk patëm pasoja, menduam që ta përsërisnim aktin, por kësaj radhe gjyshja i ra në erë mungesës së lekëve dhe u ankua te babai. Ky i fundit, i drejtoi menjëherë shigjetat e dyshimit tek unë; më thirri e më tha të tregoja të vërtetën sa më shpejt, që të kisha lehtësira. Mua m'u tha pështyma, ngaqë nuk po vendosja se çfarë duhet të thoja; ndërkohë, më shpëtoi gjyshja, e cila, e penduar, i kërkoi tim eti që të mos më prekte me dorë. Përfitova nga rasti e kërkova leje për të pirë ujë. Ato sekonda të vlefshme i shfrytëzova për të fshehur kartëmonedhat nën një rrasë guri, në vrimën-dritare që komunikonte me shtëpinë e fqinjtit-kushëri, e hapur në një mur guri, gati një metër të gjerë. Megjithëse nuk piva fare ujë, fyti më ishte lehtësuar dhe iu përgjigja serbes tim eti, i cili nuk gënjehej

vetëm me fjalë, prandaj nuk la cep të trupit pa më kontrolluar. Nën vështrimin e habitur të motrës sime, babai u dorëzua. Ishte sërish gjyshja, e cila, me ndërhyrjen e saj, i vuri kapak muhabetit. Të nesërmen bleva një komposto kumbulle dhe thirra motrën e madhe që ta ndaja me të; motra e vogël, në atë kohë, ushqej akoma me qumësht gjiri. Motra refuzoi të hante; nuk e di në ishte më shumë e trembur apo e prekur nga gjithë kjo histori; ajo që di është që edhe mua më ngecën në fyt ato kumbulla, aq sa e derdha gjysmën e kavanozit në ferra. Në darkë, katëmonedhën 50-lekëshe që më kishte mbetur, e futa mes rrobave në arkën e gjyshes, nën vështrimin miratues të motrës sime. Nuk i hodhëm më sytë nga arka e saj, kurrë më.

Ata vdiqën, të dy për një ditë. Gjyshja kishte vdekur e para, kurse gjyshi, sapo kishte dëgjuar zhurmën e njerëzve që po vinin për ngushëllim, ishte ngritur mbi bërryla, sa të thoshte *“iku”*; kishte parë një herë përreth dhe kishte lëshuar frymën e fundit. Unë erdha urgjentisht nga Tirana; për të tilla raste shkolla ushtarake, nuk nguronte për të dhënë leje. Kjo ishte vdekja e dytë që po përjetoja në shtëpinë time, apo më mirë, ishte e para që po e kaloja mes burrave që pinin kafe dhe tymosnin duhan. Pas fjalëve të para ngushëlluese, ata që rrinin pak më gjatë, shpejt kalonin në muhabetë më të lirshme. Diku andej nga mesnata, më kapi veshi këto fjalë: *“Nuk e mbajti dot vetëm, peshën e asaj pune”*. Hodha sytë andej nga erdhën fjalët, por e kisha të vështirë të kuptoja se kush kishte folur; fytyrat e ashpra të atyre burrave, nuk transmetonin asgjë, as sytë e tyre. Në varrim erdhën plot njerëz, por, megjithë veshëngrehjen time, askujt nuk i shpëtoi ndonjë fjalë tjetër.

Tezja e babës apo motra e gjyshes kishte qenë shërbëtoare e priftit. Vëllezër nuk kishin patur, andaj, si kishte ngelur e vetme, pak para vdekjes së gjyshërve, ne e morëm edhe atë në shtëpinë tonë. Më kujtohet si tani shtëpia e saj në anën e malit, që kishte të njëjtin emër me fshatin. Përveç një kryqi, disa fugureve të zymta me shenjtorë, një kandili me vajguri mbi qoshen e oxhakut, si dhe

një shkambi prej druri, nuk të zinte syri gjë tjetër në atë shtëpi, të ftohtë prej guri, me oborr të gurtë dhe me qemer guri te porta e lartë, që të nxirrte në rrugë të madhe; një xhade e ndërtuar nga italianët, që në Luftën e Dytë Botërore. Pikërisht, një nga këto ikona e futa një ditë në çantë, me qëllim që t'ia çoja mësuesit të matematikës, i cili nuk e di pse po i mblidhte; ndoshta, kishte nisur trafiku i tyre. Do t'ia kisha çuar vërtet, sikur nëna të mos më diktonte dhe të më kontrollonte çantën. Më bëri gjithë atë moral mbi rrezikun që mund t'i sillja tim eti, nëse merrej vesh se mbanim gjëra të tilla në shtëpi, por unë, kam filluar të dyshoj, se asaj i dhimbsej kjo ikonë, e cila tashmë rri e varur në dhomën tonë të madhe; e vetmja në këtë shtëpi dhe ndërkohë, gjëja e vetme që reflektonte ndryshimet e mëdha shqiptare të fundvitit 1990.

Kur kjo teze erdhi të jetonte te ne, babai bleu të parin televizor që hyri në fshatin tonë; një prodhim shqiptar me emrin sinjifikativ *"Iliria"*, i cili, më vonë, do ta kthente shtëpinë tonë në një kinema fshati, sidomos kur kishte ndeshje futbollit. Kur pashë për herë të parë një ndeshje futbollit, televizorin e kisha lart mbi kokë, aq sa, kur topi dilte në anësore, mua më dukej sikur binte në humnerë. Një darkë, ndërsa po shikonim rubrikën sportive, e cila jepte golat e kampionatit shqiptar, unë i thashë tim eti atë fjalinë e famshme: *"Kta portierët, s'ditkan me pritë hiç"*, të cilën ai ma përmendte shpesh, kur donte të më thoshte se, shenjat e budallallëkut, më ishin shfaqur qysh në moshë të vogël. Në botërorin e shtatëdhjetë e tetës, në pushim të ndeshjes finale, ai nxorri jashtë gjysmën e bashkëfshatarëve që kishin ardhur të shihnin ndeshjen, të cilët kacavireshin në dritaren e vogël të ballkonit, duke premtuar se nuk do të bënin më tifozllëk për Argentinën, nëse i lejonte të hynin brenda edhe një herë. Kur barazoi Holanda, babai u tregua zemërgjerë dhe i la të hynin brenda, këta tifozë të Gjermanisë, që qeshnin nën buzë, pa guxuar më të brohorisnin për golat e radhës të argjentinave.

Këtë televizor, im atë e kishte blerë, duke shfrytëzuar një

truk të vjetër. Atë ditë, kishte marrë me vete të gjithë lekët, që kishte marrë nga shitja e shtëpisë së gurtë të tezes së vet, teksa kishte pasë veshur një palë pantallona të arnuara. Ndërsa pinte kafe me pushtetarin që lëshonte autorizimet për blerjen e pajisjeve elektroshtëpiake, e kishte sjellë punën në mënyrë të tillë, që ky i fundit t'i thoshte: *“Dakort, do ta nâp autorizimin, por me një kusht: duhet të shkosh tani direkt e ta marrish televizorin”*. Në këtë pikë, babai kishte nxjerrë lekët, duke e lënë tjetrin të habitur dhe të mërzitur, pasi që kishte lëshuar kaq lehtë një autorizim, për të cilin njerëzit e lusnin dhe e qerasnin me javë të tëra.

Dy vjet pas gjyshërve, vdiq edhe kjo teze; kësaj radhe, ndihesha më i përgatitur të përjetoja vdekjen. Kur u ktheva në shtëpi për pushimet e verës, gjashtë muaj më vonë, vura re se daja im murator, ishte thirrur sërish për të ndryshuar arkitekturën e dhomave e të korridoreve; më në fund, nëna ime ishte bërë padrone e shtëpisë.

Nuk po ndihesha gati të përballesha me tim atë, i cili, nga ana e tij, ndoshta për të njëjtën arsye, po e vononte më shumë se zakonisht qëndrimin në klubin e fshatit, andaj shkova të fle herët, me shpresën se, kësaj nate, do të bëja një gjumë më të qetë, por nuk qe e thënë; shpirtrat e gjyshërve ma turbulluan mendjen gjer në agim. Ndoshta ata, mezi e kishin pritur një shpirt të dobët, që ta sulmonin me pengjet e tyre, apo ndoshta, ishte faji i asaj që dëgjova kalimthi nga goja e nënës sime, teksa ngjisja shkallët e drunjta.

TOKË E SHPIRTËNVE

Kumbona gjimoi per një kumt t'ri, nen një tingull t'moçem. Ksaj here u mblodhen te çinari me zgur¹¹, si e ki'n¹² pàsë zakon; kish ardhë edhe i vorruemi i ri. T'parët që mbrërînen, mù n'zгур t'djegun, shquen një hije t'panjoftun e t'pambrûme ende mirë.

- Kjëftë kumti i hajrit!
- A jeni, bëjtë e shqipes?!
- A je, burrë?!
- Atdheu n'rrezik!
- Prej kahit t'kêna or mik?
- Prej Karpe ko'¹³ rá.
- Karpe? A e ka ndê kush, njëkyt êmen vëndi?
-
- Mirseardhsh, o Dhânderr Karpet!
- Ma ngrohe shpirtin, o Lahutë.
- Jo, kyt ças, jam Mriz Zanash.
- Edhe un do t'dojsha me kënë Drande.
- Shkà t'pruni ktù, n'viset e Breshkës?
- Shqipnîja nuk âsht mirë...
- ...E kurr nuk ka kënë!
- Vij nga pertej detit, aty ku léjnë bëjtë e shqipes, po shqip nuk flasin...
- Oh!
- Ktù jam.
- Paske ardhë, o Kullë?!

- Jo, sod jam Oh.
- Breuk a Dasaret?
- Ene Dardan.
- Mos m'thoni se me ju, âsht edhe Tregtari i Flâmujoye!
- Sod jam Hija e Maleve.
- Ta paska ânda me u bâ mik me Ukun e Murrinë?
- Tradhtija do gjuejtë me rrfë... vet e ke thânë.
- Nuk âsht tradhti.
- E shkà âsht at'here?
- Prîte faren, se mbînë n'prândoverë.
- Per farë kena ardhë.
- Farë keni mjaft, sa un e ma teper.
- Duem me i gjuejtë me rrfë...
- E un s'jam Zeusi.
- Prà mallkue njaj bîr shqiptari...
- Léne, Palimpsest!
- Qì ket gjuhë t'Perendisë...
- Mjaft, o bîr i Hasit.
- Trashigim, qì na lá i Pari...
- Mos, Pasqyrë e Narcizit
- Trashigim, s'ja lén ai fmisë...
- Edhe ti, Juvenilje?!
- E thotë edhe Kanuni, qì âsht krah têtje.
- Mos m'shtini n'mëkat.
- Breshkat ta paskan hânger zêmren.
- Besa jo, ulkojë e kam.
- E at'here?
- Nuk âsht njìsoj.
- E pse jo?
- At'botë i lutesha Qiellit per rrfë... e tash Rrfeja jam vetë.
- Shkrepe pra!
- ...Un pres prândoveren... Avyту, Njêri!
- Prândovera e Shqiptarîsë nuk vjen vêtit, duhet me luftue

per têt.

- *Shqipja nuk des.*
- *Po pakohen bëjtë e saj.*
- *Un pres prândveren.*
- *Un shof borë.*
- *Un pres prândveren.*
- *...E thae tri herë.*
- *...*
- *Ikim, Uku i Murrinë!*
- *Ikim, Hija e Maleve!*
- *Oh, ikim!*
- *A po vjen, Vaji i Bylbylit?*
- *Po rri si Ândrra e Jetës.*
- *Eh t'ritë!*
- *Po ti, o Çetë e Profetëve?*
- *M'pruni ujët e Lumit.*
- *A po rrin me në? Po ma kânda, t'kuvesim.*
- *Po shkoj me nipat... tash m'bjen dashnija prap.*

III

U bënë tri ditë që po vërdallosesha kot nëpër fshat, pa vendosur dot që të nisesha për në Tiranë. Këtu situata është e trishtë, kurse atje ishte më keq; fëmija po lindte i vdekur. “*O botë o dreq, unë paskam lindur të të ndreq!*” Nuk po më bëhej të ngrihesha nga krevati. Sa e sa herë kisha qëndruar kështu, i përgjumur, duke dëgjuar bisedat e nënës sime, që më dukeshin se vinin nga një tjetër botë, ndonëse sot, vetëm ca cicërima zogjsh, më mbanin lidhur me realitetin. Ky ishte krevati ku më kishte zënë dhe tërmeti i shtatëdhjetë e nëntës; këtu kishin rënë ato lëvoret e suvasë mbi jorgan; nga ky krevat, dëgjova nënën time që i bërtiste motrës së vogël, pse kishte ngrënë djathin e pazënë akoma, ose më mirë të themi, atë masë të ngrirë qumështi, të mbështjellë me degermi, që po bëhej gati që të tharmohej për t’u bërë djathë. Një ditë, u ngrita i uritur nga ky krevat dhe hëngra më shumë se gjysmën e sahanit plot me përshesh me qumësht, në të cilin do të hanin edhe dy motrat e mia. Ndërsa nëna më kërkonte mua llogari për këtë gjë, unë i kërkova motrës së vogël, që të mos e boshatiste sahanin. Një ditë më parë, kishim qenë në një ekskursion, ku kishim ecur mbi katër orë në këmbë, andaj motra ngriti sytë e më pa përvuajtshëm e plot zhgënjim. Më shpëtoi nëna, e cila i tha të mos bëhej merak se do të përgatiste diçka tjetër për motrën e sëmurë.

Përpiqem t’iu dredhoh kujtimeve që më lidhin me motrën e madhe, por mendja e ka të pamundur të mos kujtohet, nën tryshninë e realitetit të hidhur, që po ma helmon shpirtin tash sa vjet. Më se një herë i mbyll sytë fort, me shpresën se, kur t’i hap, do të shoh motrën duke ecur, por jo, ajo është gjithnjë aty, mbi

divan, duke më vështruar me ca sy, që duket sikur më pyesin se si është koha jashtë, por që mua, më fusin në dhe të gjallë. Doktorin pat thënë se, ndjeshmëria e saj për jetën, do të ngelej ajo e një fëmije shtatëvjeçar, por nuk e di pse më dukej se ajo rritej bashkë me mua dhe sillej sikur doktorin kishte patur të drejtë, vetëm e vetëm që të ma lehtësonte mua peshën e dhimbjes.

Si në një film me metrazh të shkurtër, më shfaqet gëzimi i saj i patëdytë, ditën e parë të shkollës; ajo po hynte në klasë të parë, kurse unë në të dytën. Gjithë rrugës më kapte për trikoje e më bënte lloj-lloj pyetjesh, sa të pafajshme dhe kureshtarë, aq edhe idiote në të njëjtën kohë, apo të paktën kështu më dukeshin mua, që nuk isha më një rishtar në shkollë. Kur e çoja te rreshti i klasës së saj, në mes të oborrit të shkollës, ajo, nëse nuk niste të qante, do të më ndiqte me sy, derisa të humbisja mes nxënësve të klasës sime, kurse në pushimin e madh, do të më gjente kudo që të isha; ngulej aty pa bërë zë, si një tifoze e imja, në çdo lojë që merrja pjesë. Nëse këto lojëra nisnin edhe pas mësimin, ajo ishte roja e çantave tona; shërbim që dukej sikur i jepte një kënaqësi të veçantë. Një ditë, pas një dyshimi që më kishte lindur, hapja çantën e saj dhe... nuk u habita edhe aq, kur nuk gjeta asnjë libër aty, por vetëm letra shumëngjyrëshe, që dikur kishin mbështjellë të gjitha llojet e mundshme të karamelëve të asaj kohe. Kur mësuesi i saj u ankua te im atë, ata të dy vendosën që unë të shkoja disa ditë në klasën e saj. Motra u gëzua pa masë për këtë situatë të re, ndonëse, asnjëri prej nesh, nuk priste ndonjë përmirësim të saj në mësim. Ndërsa unë përpiqesha t'i shpjegoja disi ato që thoshte mësuesi i saj, apo ato që mbaja mend nga një vit më parë, ajo m'i ngulte sytë dhe qeshte e shkujdesur; thjesht ishte e lumtur që ishte pranë meje dhe asgjë tjetër nuk i hynte në sy.

Im atë po mendonte seriozisht që ajo të përsëriste klasën, kur ndodhi ajo që ndryshoi çdo gjë. Ishte fillim pranvere dhe ne po shijonim mungesën e një mësuesi; dikush, duke lozur me një top llastiku të shpuar e të zbutur, dikush tjetër, thjesht duke shijuar natyrën, ndërsa mua, nuk e di pse më kishte hipur

dëshira të provoja disa ushtrime te paralelet, ushtrime që kisha parë t'i bënin djemtë e klasës së tretë. Motra më kishte parë nga dritarja dhe kishte arritur, në një farë mënyre, të merrte leje për të dalë nga klasa e për t'u mbërthyer për hekur, me sytë e ngulur tek unë. Kur e pashë, e pyeta për çantat tona, ngaqë për një çast, kujtova se kishte mbaruar mësimi. Ajo më pa e habitur dhe nuk nxori zë. Unë e pyeta edhe një herë, para se ta qëlloja me pëllëmbë, fiks në momentin që m'u kujtua se kishim edhe një orë mësimi për të bërë, andaj çantat i kishim në bankat tona. Ishte hera e parë që e qëlloja dhe zhgënjimi që pashë në sytë e saj, më bëri të pendohesha gjer në palcë, ndonëse krenaria nuk më linte që t'i kërkoja falje. I bërtita sërish, duke i kërkuar që të hiqte duart nga paralelet, pasi ato nuk ishin për vajza, aq më pak për një nxënëse të dobët si ajo. Këto të fundit ia thashë me sytë përdhe e duke m'u dridhur buza; e kuptoja se po gaboja, por diçka më e fortë se unë, më shtynte të reagoja në atë mënyrë. Për të dalë nga situata, iu bashkova një grupi djemsh që po bënin një garë vrap; u sollëm dy herë rreth e rrotull shkollës, pa e mbajtur frymën e duke shijuar në maksimum freskinë e stinës dhe të rinisë sonë. Nuk e di nëse, fillimisht dëgjova klithmat, apo pashë mësuesin e saj të dilte me vrap nga shkolla, por kur sytë i hodha nga paralelet, e gjithë bota m'u nxi. Në ato momente, nuk e dija sa i rëndë do të ishte ky aksident për motrën time, në të kundërt, vështirë se do të më bënin këmbët të shkoja pranë saj. Motra kishte rënë me shpinë, mbi një cung hekuri të prerë dhe shihte e habitur gjithë ata njerëz, të mbledhur te koka e saj. Siç mësova më vonë, ajo nuk ndiente dhimbje, pasi goditja ua kishte prerë lidhjen me trurin gjithë nervave të poshtme të trupit të saj, një herë e përgjithmonë. Ndërsa mësuesi po e pyeste se si ndihej, asaj papritur i shpërthyen lotët, teksa nisi të më thoshte:

- Do t'i thém babës, se nuk ish faji yt. - Doja të thoja diçka, por fytë më ishte tharë si katakombet e Egjiptit.

- Eh! Si të lëshë të dilje, - tha mësuesi i saj, i zverdhur në fytyrë.

Ktheva sytë nga paralelet, pastaj sërish nga motra e shtrirë përtokë dhe... ndjesia që provova atë çast, m'u ngul si thikë deri në pankreas e më shpërtheu si predhë në kokë, duke m'i ngritur flokët si gjemba iriqi. Nuk kishte pikë dyshimi: ajo ishte përpjekur të kryente ushtrimin, që më kishte parë mua të bëja; e fyer nga fjalët e mia, ajo kishte dashur të më tregonte se sa vlente. Nuk fola me askënd për këtë gjë, prandaj ndjesia e fajit u rrit e u rrit si krimbi brenda meje, sa më shumë ditë që kalonin... Edhe sot e kësaj dite, nuk guxoj ta shoh gjatë në sy, ndonëse në sytë e saj ka vetëm dashuri dhe mall... O Zot, sa orë e sa ditë kam humbur kot në këtë jetë dhe nuk kam ardhur të rri këtu, me motrën time të dashur; t'i jepja asaj, sytë e mi për të parë botën, që aq shumë e dëshironte; t'i dhuroja pakëz jetë këtij fëmije të rritur, dhimbjes më të madhe të rinisë sime... Pas dy orësh, e qeshura e motrës kishte tërhequr vëmendjen e nënës, e cila, me sytë e mbushur me lot, kishte ngrirë mbi kashaturën e derës së hapur.

- Ju pastë nana, ju pastë, - Ngriva dhe unë si ajo; ula kokën, si i zënë në faj.

- Oj nanë, u knâqa! - Motra i luante duart lart e poshtë, si të donte të ngrihej. - A e dín moj nanë se...?

Nuk munda të dëgjoja asnjë fjalë më tepër. I zbrita shkallët si i harlisur dhe e mbajta frymën te porta e madhe, tek e cila u mbështeta në pritje, derisa më shterën gjithë gjendrat e lotëve. Sa u shkëputa prej portës, u ndala sërish; nuk kisha pse të nxitoja, qendra e fshatit duhet të ishte tytë, si zakonisht në këtë orë. Dy vëllezërit e mi të vegjël u lëshuan drejt meje me nga një kallam në duar, që po e mbanin si atutomatik. Ai, më i vogli, sa kishte nisur të ecte.

- Bërr-bërr-bërr... je i vramë. - Më zunë ca drithërima, sikur të më kishin qëlluar vërtet me plumba. E mblodha shpejt veten e zura të luaja me ta; më të voglin e kapa hopthi dhe e ngjita mbi një degë mani.

- Shife fushën vllaçko. - Ai në fillim zuri të qeshte, por, kur po e mbaja me një dorë, u tremb dhe kërkonte vazhdimisht që ta

zbrisja poshtë. E ula ngadalë dhe u mora me tjetrin; e shtriva në bar dhe zura ta giciloja; nga e qeshura u afrua dhe i vogli, gjersa u kapërthyem të tre në një lojë, plot gaz të paparë. Thirrja e nënës sonë, i shkëputi pa qejf prej meje; u nisën ngadalë drejt shtëpisë, pastaj, më i madhi ia dha vrapit, sapo zëri i thirrëses u bë më i fortë.

Teksa u zhduk edhe silueta e vocërrakut pas kapakut të portës, unë u shtriva në bar dhe hodha vështrimin lart, mbi degët e shumta të manit 50-vjeçar. Sa e sa herë e kisha mbushur barkun me ato mana. Zbrisja ngadalë prej degëve të tij dhe vrapoja të lahesha te kanali, ku tresja barkun e fryrë dhe kthehesha sërish mbi pemë. Kanali ishte një ujëmbledhës i fushave, i cili, nëse nuk binte shi, të krijonte mundësi të laheshe në disa barqe të zgjeruara të tij, të cilat ne i njihnim mjaft mirë. Prindërit nuk donin që të lahesha në të. Në fillim kishin frikë se mos mbytesha, pastaj zunë të ankohen për pastërtinë e ujit, por, gjithsesi, nuk ia dolën të më shkëpusnin prej tij. Shpesh, ne talleshim me njëri-tjetrin; iknim me vrap, duke thirrur: *“Erdhi polici, erdhi polici”*, ndërkohë që, disa prej nesh, ishin akoma në ujë, për t’u kthyer pastaj dhe për të shijuar fytyrat e trembura të shokëve, teksa rrëshqisnin nëpër baltën e skarpatës, në tentativat e dështuara për të dalë nga kanali. Edhe unë kisha rënë viktimë e këtyre shakave, derisa një ditë e pashë nga afër policin; ai na qenkësh një kushëri i largët i nënës sime. Më nduku lehtë në faqe, duke më vështruar me dashamirësi dhe, kur nëna i tha se nuk isha edhe aq djalë i mirë, pasi lahesha gjithë ditën te kanali, ai mori një pozë serioze, duke më paralajmëruar si polic i vërtetë. Mirëpo, ndërkohë unë e kapa duke i shkelur syrin nënës sime dhe, që nga ajo ditë, fitova imunitet nga hija e policit.

Ndërsa po kaloja pranë tij, në këtë ditë të bukur shkurti, por që s’ë ka larguar dot turbullirën e ujit të kanalit, habitem sesi dikur zhgërryhesha në të. Një ditë, kishim ngelur vetëm dy vetë në “pishinën” tonë. Ndërsa mua më kishte rrëmbyer noti i qetë, mbi atë ujë mrekullisht të kulluar, shokun tim e thirrën. Ai doli

në breg dhe, duke më kërkuar falje, zuri të tundej e shkundej, për të larguar ujin nga trupi. Unë nuk i ktheva përgjigje, por nisa të provoja veten në not zhyt; nuk kisha të ngopur me atë ujë të dliurë. Por, kur dola, shokun nuk ma zunë sytë, kurse në breg u befasova nga mungesa e trikos. Nëna më pyeti disa herë se me kë isha larë, por unë i thashë gjithnjë se kisha qenë vetëm; shoku im ishte jetim nga i ati, i cili kishte lënë gjashtë fëmijë, njërin më të uritur se tjetrin.

Disa ditë më vonë e pashë të veshur me trikon time. Ndonëse kishte stampuar disa simbole të pakuptimta në të, unë sërish e njoha atë. Ishim në oborrin e shtëpisë së tij, teksa e ëma nisi të më tregonte se si e kishte gjetur atë triko. Ula kokën dhe heshta. Ndonëse, shpesh, edhe ne binim të flinim me barkun bosh, në fakt, ne na kishin zili, për shkak të rrogës disi më të madhe të tim eti. Jo njëherë, më kishte qëlluar ta ndaja bukën më të tjerët. Asi ditësh, nuk më vrisnin me shqelma, teksa luanim futboll, madje, shpesh më linin që të fitoja, pa e kuptuar. Ushqimi që më shijonte më shumë ishte buka e ngrohtë e misrit me djathë, çdo kafshatë të së cilës e shoqëroja me nga një gjysmë fiku, të fërkuar mirë e mirë me gjysmën tjetër. Zakonisht, këtë drekë të vonë e haja në majë të fikut, ku kisha mundësi të arrija edhe ndonjë vile rrushi, nga hardhia që kacavirrej në degët e tij, të cilën e shijoja si pjatë të dytë, ose e përdorja për të njomur kafshatën e ngecur në fyt.

Fatkeqësisht, ishte dimër dhe nuk ndieva dëshirë të shkoja drejt kopshtit. Këmbët më çuan drejt qendrës së fshatit dhe, si nuk më joshi asgjë aty, përsëri këmbët e morën trupin tim me vete, drejt rrugës që çonte pranë rrethimit të shkollës. Ishte e diel dhe aty mbizotëronte heshtja. Si gjeta një të çarë mes hekurave të ndryshkur, rrëshqita nëpër atë vrimë të ngushtë, për t'u shtrirë pastaj në barin e ngjeshur pranë fushës së basketbollit, ku ne gjithnjë luanim futboll.

E kujtoj, si nëpër tym, ditën e parë të shkollës, kurse natën para ditës së parë të klasës së dytë nuk do ta harroj kurrë. Gjithë ditën luajta futboll; s'kisha të ngopur me lojën, atë pasdite të

ngrohtë fundgushti; kurse natën, gjumin e pata të trazuar, me ëndrra e plot ankthe, saqë, kur u ngrita në mëngjes, më kishin mbuluar djersët, ndërsa nëna po më tërhiqte nga këmba që të ngrihesha, pasi ora po shkonte tetë pa një çerek. Më ka qëlluar shpesh, që të më gjenin duke larë faqet në mëngjes, mua që e kisha vetëm dhjetë minuta larg shkollën; nxënës e bashkëmoshatarë, që vinin nga një orë rrugë larg, apo dhe më shumë. Ndërsa atë ditë u ngrita me vështirësi, ngaqë po më mbysnin makthet. Ëndërroja sikur kisha shkuar në shkollë pa detyra, e kur pa, që në ditën e parë të saj. Ndoshta ishte pasoja e një dite plot lojëra, nuk e di, por e sigurt është se këtë lidhje kisha me shkollën, për plot 12 vite: nuk neglizhova kurrë asnjë detyrë, nuk lashë faqe të librave pa përthithur; kapesha pas dijes, si i mbyturi pas copës së dërrasës.

Një nga vetmet kaçuba me mrina, të mbetura në kodrën përbri, më solli në kujtesë detyrën time të parë zyrtare, atë të mbledhësit të thuprave. Ishte një mësues, ai i gjuhës shqipe, që ma kishte ngarkuar këtë detyrë. Çdo të hënë, në orën e parë dhe çdo të enjte, orën e katërt, unë duhet të kisha sjellë mbi tavolinën e mësuesit katër-pesë fliza mrine. Ata që vinin pa detyra, ose që nuk dinin të përgjigjeshin saktë, gjithnjë më ankoheshin: *“Pse dreqin i zgjedh, kaq të trasha”*. Një ditë erdha edhe unë pa detyra. Më duket se nuk e kisha patur mendjen aty, kur mësuesi na i kishte dhënë ato. Detyrat e shtëpisë nuk i kisha bërë, por thuprat i kisha sjellë; mora nja dy goditje të forta dhe shkova kokulur drejt bankës, nën vështrimin domethënës të të ndëshkuarve të përhershëm. Ditën tjetër, solla thuprat më të trasha që gjeta, pastaj nuk solla më. Po vinte fundi i vititit shkollor dhe as mësuesi nuk ma kërkoi më një gjë të tillë.

Mësuesi i biologjisë kishte një metodë tjetër; ai na i shkulte barsetat, derisa na kërcenin lotët përpjetë. Ndonëse isha nxënës i mirë, i urtë dhe që nuk shkaktoja pothuajse kurrë probleme, prapëseprapë, nuk isha imun ndaj ndëshkimeve. Tani që e mendoj më mirë them se, duhet të ketë qenë shpirti im rebel, ai

që më shtynte të kërkoja ndëshkimin, nga frika se mos gjendesha në anën e gabuar, por atëbotë, nuk mendoja kështu. Mbase duhet t'i marr, edhe si shenja të një mazokizmi të pavetëdijshëm. Vetëm mësuesi i matematikës nuk më godiste kurrë. Ai vetëm më nxiste që të përsosësja vazhdimisht; kërkonte nga unë që të zgjidhja të gjitha ushtrimet e librit dhe shpesh, më sillte të tjera; më ndihmonte që të ecja me vizatimin, ose vinte e më kërkonte në orën e muzikës, për të zgjidhur ushtrimet e matematikës në klasën tjetër. Por, edhe ai më çoi në ngasje, ndonëse, në një mënyrë tjetër.

Kishin thyer dhomën ku flinin mësuesit, duke vjedhur lekët dhe disa rroba apo orendi dhe ai kërkonte prej meje që ta ndihmoja të gjente hajdutin. Nuk e kundërshtoja dot, ndonëse u vura në siklet të madh. Umundova të zbatoja porosinë e tij, por shpejt e kuptova se, nuk isha njeriu i duhur për këto punë. Ai u zhgënjye, por nuk e dha veten. Në festat e para të vitit të ri, si skënderbegas, i dërgova një kartolinë me një formulë matematike, e cila, kur zbërthehej, thoshte: *“Gëzuar vitin e ri mësues”*. Ua kishte treguar të gjithëve, nxënësve dhe mësuesve të shkollës.

Aty nga klasa e shtatë, u bë një konkurs rajonal për gjuhën dhe mësuesi i lëndës më tha të zgjidhja ekipin. Punuam dy javë me radhë dhe ditën e konkursit ndihesha si në tym, ngaqë kisha lexuar librat e tri viteve. Sapo u ngrita t'i përgjigjesha pyetjes së parë, hutimi më kaloi dhe fjalët më rridhnin si përrua; po unë u përgjigja edhe për pyetjen e dytë, kurse për të tretën pashë nga ekipi. Ajo që u ngrit, nuk po përgjigjej si duhej, ndaj m'u desh të ngrihesha për ta plotësuar, por drejtuesi nuk e pranoi ndërhyrjen time, duke na hequr një pikë. Për pyetjet e tjera nuk pashë më rrotull, i griva përgjigjet dhe po shkonim drejt fitores, pa patur nevojë për pyetjen e fundit, nëse, nuk do të ishte favorizuar paksa ekipi kundërshtar. E fundit ishte pyetja enigmë; për ekipin tonë, prap unë. Ky rezultoi të ishte një gabim fatal. Konsumova tri pyetje, për të zbuluar se bëhej fjalë për ndajfoljen. Ishin tetë

lloje gjithsej, kurse mua më kishin mbetur vetëm shtatë opsione; fatalisht, i hodha të gjithë plumbat jashtë tabelës. Në fjalën e fundit, dikush kishte tentuar të më tregonte përgjigjen e saktë, por unë nuk shihja askënd. Më vonë, nisa të dyshoj se, çfarëdolloj ndajfoljeje që të kisha zgjedhur unë, përgjigjja e saktë do të kishte qenë lloji tjetër. Megjithatë, në ato çaste nuk i shihja dot shokët në sy, e ndjeja se isha treguar egoist. Vite më pas, kisha dëgjuar një tiranas të vjetër që deklaronte në një pijetore: *“O Zot, m’çò mend sa me lidhë ushkurin e brekëve... pjesen tjetër ma bôj fat!”* Ky do të kishte qenë mësimi i parë i rëndësishëm që do të më jepte jeta, por që, fatkeqësisht, nuk dita kurrë ta lexoja saktë.

Kalova fushën e basketbollit dhe u ndala te paralelet. Nuk i duroja dot kujtimet e atij vendi, andaj po iu qëndroja përballë, duke shpresuar se, kështu, nuk do të mund të më bënin dot keq. Hipa në hekur, por nuk bëra dot më shumë se 5-6 pompa; ndihesha si i ndryshkur. Në fakt, unë nuk jam shquar kurrë në përgatitjen fizike; edhe një herë që dola më i shpejti i klasës në vrap, dy më të shkathtit mungonin, kurse tre të tjerë, siç më thanë më pas, kishin rënë të flinin pa ngrënë darkë. Nga gërmadhat e shkollës së vjetër fillore, dolën dy qenër të kuq, duke kuisur përvuajtshëm; dikush duhet t’i kishte qëlluar me gurë. Vazhdova rrugën, ndërsa një kujtim i vjetër më mbiu papritur në mendje. Një natë, teksa po luanim deri vonë, pamë një djalë që nuk e njihnim. Ai kishte ngelur jashtë dhe shokët më kërkuan që ta merrja në shtëpi, meqë ne kishim më shumë dhoma banimi. Ata e kishin të vështirë të besonin që unë nuk e merrja dot guximin për një hap të tillë; as që e kisha imagjinuar veten, me një ofertë të tillë te porta e shtëpisë sime. Im atë...

- A brødhe mjaft, - Babai, po ma bënte me dorë nga dera e lokalit të fshatit. - Hajdë e pije një kafe, hajdë. - E shtriva hapin e u nisa drejt tij. Kur u futa brenda, pashë se po rrinte në një tavolinë me një rreth të gjerë bashkëfshatarësh. Dikush u ngrit të më bënte vend, kurse të tjerët më përshëndetën përzemërsisht.

- Na thuaj ndoj gjâ. Shkà báhet kah Tirana? - Vetëm njërit

iu dëgjua zëri, por edhe sytë e të tjerëve bënin të njëjtën pyetje. Për me shumë se dy orë, fola për ëndrrën e lirisë, që lindi e u rrit në Qytetin Studenti; tregova ngjarje, riprodhova pothuajse saktësisht, fjalime të figurave kryesore të Partisë Demokratike. Për habinë time, jo vetëm ata, por edhe im atë po më dëgjonte në heshtje. Më bënin plot pyetje, por gjithnjë me nga një gjysmë fjalie dhe sapo nisja të përgjigjesha bëheshin gjithë sy e veshë. Mu kujtua një bashkëfshatari ynë, i cili ishte martuar si kollovat në Sarandë dhe, në një nga vizitat e tij të rralla, pati deklaruar se fshatarët kanë rol dytësor në shoqëri. Atëherë, ata e patën kundërshtuar energjikisht këtë tezë, kurse sot, më dukej se, po më provonin të kundërtën. Ndonjërit, edhe nuk i pëlqenin fjalët e mia, andaj niste të më kundërshtonte, mirëpo, shpejt i duhej të heshte, nën trysninë e të tjerëve. Ndërsa iu flisja, ndieva të më ngjallehin edhe mua emocionet e topitura, të dy muajve më parë.

Kur, bashkë me tim atë, morëm rrugën për në shtëpi, e ndieja se ai donte të më thoshte diçka, por nuk po i gjente dot fjalët; kurse unë, nuk po e ndihmoja aspak, aq më tepër, që ndihesha i shkarkuar dhe pa dëshirë për të folur. Si pa e kuptuar, kishim arritur te çezma publike, para shtëpisë, nëse mund të quhet publike, për shkak të aksesit nga katër-pesë familje. Padashur, m'u kujtua qumështi i derdhur, pothuaj dhjetë vite më parë. Kisha pritur tri orë në radhë, për atë qumësht. Ndoshta, më ishin ngrirë duart nga të ftohtit, ndoshta ishte një revoltë e brendshme, e pavullnetshme, ajo që ndikoi në uljen e vigjilencës për ruajtjen e atij qumështi, tepër të rëndësishëm, për rritjen e motrave e vëllezërve të mi. Dy vite më parë, kisha bërë festë në mendjen time, kur na kishin tufëzuar lopët; por, shumë shpejt, do ta vuaja në kurriz mungesën e qumështit. Isha vetëm pesë vjeç, kur më çuan për herë të parë me dele; roja kolektive kishte kërkuar një ditë leje. Ishin vetëm shtatë dele, të cilat i numërova të paktën njëqind herë, për tri orë e gjysmë, aq sa zgjati kullotja e tyre në stom të kanalit. Me shumë vështirësi e mbajta peshën

e përgjegjësisë, për detyrën që më ishte ngarkur; askush nuk më kishte thënë se delet rrinë të gjitha bashkë.

Na e kishin ulur disa herë normën e qumështit për familje. Çdo ulje e bënte nënën time të ofshante, si dhe të riprogramonte përdorimin e tij. Atë ditë, kisha marrë një litër qumësht, por në enë kishin mbetur a nuk kishin mbetur dyqind gramë. Shtova po aq ujë nga kjo çezme dhe ia dhashë tezes së babit. Ajo më pa e habitur, teksa më pyeti se ç'mund të bënte ajo me të. Ika me vrap dhe u ngjita në dhomën e fëmijëve. Atje gjeta nënën dhe shumë shpejt erdhi dhe tezja plakë, me ankesat e saj për qumështin e hollë dhe të pakët. Nëna, duke kujtuar se kooperativa e kishte ulur sërish normën e qumështit, i tha asaj që ta ziente të gjithin për djathë, mirëpo tjetra, nuk shqitej lehtë; qumësht kishte aq pak dhe aq i hollë ishte, sa mezi dilte një gotë, veç me ngjyrën e qumështit. Meqë tjetra këmbënguli aq shumë, nëna u ul vetë të shihte qumështin. Po prisja të më kthehej me mallkime drejt meje, por ishte sërish kooperativa, ajo që u bë objekt i anatemit të saj. E kam të vështirë ta besoj se nëna nuk e kuptoi hilen time, por, me sa duket, iu dhimbsa dhe ndërkohë edhe asaj i ishte sosur durimi.

Një herë tjetër, po laja një ngjalë, bash nën këtë çezme të zhurmshme, kur qe, plaka e një shtëpie aty poshtë, vuri enën me "t'lana", pikërisht poshtë duarve të mia. Papritur, ngjala më rrëshqiti dhe ra në atë tenxhere të pistë. Në fillim, nuk desha ta merrja, por nepsi qe aq i fortë, sa më detyroi të mbyllja hundët dhe ta nxirrja nga aty. Atë ngjalë ma kishte dhënë një ekskavatorist që po pastronte kanalën tonë. Ishim mbledhur shumë fëmijë rreth tij, nga kureshtja apo nga nepsi; më të guximshmit, kishin shpërvjelur pantallonat e ishin zhytur në llucë, në kërkim të ngjalave. Unë, vetëm rrija e vështroja; dikur, ekskavatoristi, që ishte një djalë dajë i nënës sime, zbriti nga kabina, futi duart në llucë e nxori që andej një ngjalë goxha të madhe. Kur ma zgjati mua, nuk iu besova syve. Nën vështrimin ziliqar të shokëve këmbëshpërvjelur u nisa me vrap drejt çezmës publike. Nga ajo

ngjalë, nuk hëngri vetëm im atë; ai thoshte se nuk i pëlqente peshku.

- Nuk jë aq budallë sa dukesh, - im atë, më në fund i kishte gjetur fjalët. Unë e pashë në sy, por vetëm për një çast, shpejt ula kokën dhe u nisa drejt shtëpisë. Ndërkohë, një buzëqeshje e lehtë më kaloi rrëshqanthi nën mustak.

Energjia elektrike vinte as s'vinte dy orë në ditë, andaj edhe unë kisha mbetur i painformuar për ngjarjet e ditëve të fundit. Gjithsesi, nëse do t'i quajmë informacion ato lajme që jepte televizioni shqiptar. Atë natë, për herë të parë pas shumë kohësh, energjia elektrike, na dha mundësi të shikonim lajmet e orës tetë të darkës. Imazhet e rrëzimit të bustit të diktatorit, më ngjallën dëshirën të nisesha për Tiranë; edhe e nesërmja po më dukej larg. Si i përpëlita sytë, për orë të tëra në krevat, dikur më mposhti gjumi, nën motivet muzikore:

*“... a e din moj nana jëme,
se un nesor shkoj...”*

TOKË E SHPIRTËNVE

N'kyt rasë, kumbona rá pervâjshem.

- *O Kanûn, kush â n'derë?*
- *Kanë ardhë do t'paëmen.*
- *E shkà duen?*
- *Ty, o Lahutë, t'duen per flâmur.*
- *Tash po vij si Ânzat e Parnasit.*
- *Prîna, o Ndëri i Kombit!*
- *Per ku kshtù, o cuba?*
- *Per n'Lahutë, me pushkë n'krah.*
- *Ku âsht ai djali si Hyll Drite?*
- *Kish vaden e ujit.*
- *Pra, Shqipnîja s'kênka n'rrezik.*
- *Shqipnîn e ka marrë dreqi, veç nà mundena me e pshtue⁻¹⁴.*
- *E ku âsht ky dreq?*
- *N'mes t'Tiranës.*
- *Dreq i kuq a i zi?*
- *Dreq i kënëllun⁻¹⁵ e tânë vjâmë.*
- *Po ktò lugë, shkà i keni?*
- *Lugë t'láme n'teh t'briskut.*
- *Po ju kênki t'paêrz.*
- *Me ty jena t'pathyeshem.*
- *Po ju kênki t'paftÿrë.*
- *Ta shporrim turkun Shqipnîjet!*
- *Po ju kênki t'padín.*

- Prîna, o Bajrak!
- Fryni, o Visare t'Kombit!
- Nâ per ty dêsim.
- Fryni, o Visare t'Kombit!
- Mos na e bân ket, Pater!
- Fryni, o Visare t'Kombit!
- Aj, aj...
- Rriqna t'ndÿjet e sallahana.
- au, au...
- A ndÿeve, o Ditar?
- E shkrova.
- Po ku je, o Abat?
- I knâqun prej tÿje, Bîri im.
- Mshêlê¹⁶ deren, o Kanûn i Lekve t'Malcis e Dukagjinit!
- Ka mbetë një hije, o Valle e Parrÿzit.
- Kush je ti? ...A ke êmen?
- Askushi jam.
- E shka dôn?
- Me i îkë shullanit.
- E pse kerkon mriz n'ket çinar?
- S'lakmoj hijes s'çinarit, po hijes Sâte.
- Prej kahit vjen?
- Kah tokat e Ukit t'Mûrrmë.
- Pse u bâne hije?
- M'vrau pushka e mikut.
- Qysh, o nafakpak?!
- Lakmova n'toka t'Breshkës s'Butë.
- E shkà bâne?
- Mora 'i grue t'vejë.
- Hem...
- M'fali Zoti 'i djalë... kisha hjedhë edhe dò teme le per kullë...
- Ehe...
- Masandej m'u kthye ndëra dhûnë.

- *Prej kuej?*
- *Paj, Kanuni thonë... po un s'e za besë.*
- *Pse deshte me ndëshë n'mue?*
- *Se vetem ti mundesh me m'shlirue prej mëkatit.*
- *E pse vetem un?*
- *Se veç ti kjë Mriz, Parrîz e Lahutë, në t'njajtin ças.*
- *Kjeçë¹⁷ edhe Ânzë.*
- *Po, veç një t'imtë¹⁸ ma vonë.*
- *Shkò i bekuem, shkò n'paqe.*
- *T'kjòsha falë!*
- *Un t'fala paqen, ti shkà po m'falë?*
- *Kam një nip që flen mbì libra... ta kam falë.*

IV

Rruga për në stacionin e trenit, ditën, nuk është e rrezikshme edhe nëse bie shi, veçse është tmerrësisht e trishtë. Me vete kisha marrë edhe kandilin e vajgurit, megjithëse shpresoja që të mos e takoja atë, bijën e fshatit tonë. Nuk e di pse, por kisha ndjesinë se ajo nuk priste që t'ia ktheja; ndoshta, ai kandil ishte i të vëllait dhe thjesht, kishte dashur të më përdorte mua, për t'ia kthyer. Si moskurrë, pata fat.

Treni nuk u vonua më shumë se një gjysmë ore; xhamat e thyer ishin shtuar, por, fatmirësisht, nuk frynte erë. Ishte mesditë dhe po më pëlqente të rrija te dera. Pas pak do të kalonim pranë shtëpisë së dajava dhe shpresoja të shihja ndonjërin prej tyre. Nuk pashë asnjë, vetëm dy gomerë që po shullaheshin në diell. Më ngelën sytë te pjesa me bar e kodrës. Ja, aty luanim futboll, kur mblidheshim të gjithë nipat e shtëpisë. Tani duhet të jetë rritur ai, djali i vogël i dajës së madh, i cili e kapte topin me të dyja duart e ikte drejt shtëpisë. Asnjëherë nuk ia morëm dot pa e bërë të qante dhe shpesh, nusja e dajës mbante anën e tij, duke na e prishur lojën.

Ky, daja i madh, ishte një burrë i urtë e fjalëmbël. Shpesh, ne fëmijët, mblidheshim rreth tij, për të dëgjuar përrallën e radhës. Ai tregonte shtruar dhe herë pas here ndalonte, si për t'i dhënë krahë fantazisë sonë feminare. Personazhi më simpatik i përrallave të tij, si ngulte gjilpërën mbi farën e fundit të kungullit që kishte marrë me vete, ulej të flinte mbi kashtën e grurit buzë lumit. Kur zgjohej, kungulli kishte çelur dhe lozet e tij kishin shpërthyer deri në bregun tjetër, të cilat do t'i shërbenin si urë për të kaluar lumin. Në anën e përtejme, ai gjen mizën e bletës që po

kërkonte; dikush e kishte mbrehur në parmendë, së bashku me një ka. Si bën pazar me bujkun, ngarkon gjysmën e drithit mbi mizë dhe niset për shtëpi, duke kaluar sërish mbi lozet e kungullit. Aty nga mesi, vëren se barra anonte nga njëri krah. Ndalon, ul thasët dhe i numëron kokrrat një nga një; e ndan përgjysmë kokrrën që bënte diferencën, ngarkon sërish mizën dhe niset për në shtëpi duke kënduar. Ishte nisur djalë i ri e po kthehej burrë me mjekër të thinjur. Këtu ndodh më e pabesueshmja, te porta e pret një vajzë që i thotë: *“Hajde se t’ka lé baba”*. Ne i hapnim edhe më shumë sytë se veshët, por ai na linte të ngrirë si statuja, duke na thënë se kaq ishte, përralla kishte mbaruar. Nuk e besonim dot se ky ishte fundi, i luteshim që të vazhdonte, por ai na urdhëronte të shkonim e të flinim, pasi kishte vajtur vonë.

Ngado që ta vështroje këtë përrallë të vjetër, gjeje shumë varfëri, por edhe imagjinatë e humor të zi. Këtë e kisha kuptuar me kohë; por, pikërisht tani kuptova dhe thelbin e fundit të saj: fatalitetin. Sa e sa breza mbi këtë tokë kishin patur të njëjtin fat dhe njëkohësisht, ia kishin dalë ta mbanin gjallë shpresën e besimin, si një mundësi për të përballuar varfërinë e tyre, duke i dhënë krahë fantazisë e duke kërkuar lumturinë, edhe në kufijtë e së pamundurës. Zbërthimi i enigmës, më kënaqi dhe më trishtoi në të njëjtën kohë, ma zbuti edhe atë inatin e vjetër me dajën tim. Ai, ose nuk i gjente dot fjalët të na e shpjegonte këtë enigmë, ose nuk kishte dashur të na plakte para kohe. Po ajo kokrra e misrit e ndarë përgjysmë, mos ishte një yshtje e tepruar pas së drejtës, në dëm të jetës?

Akoma më interesant ishte babëdaja; një plak babaxhan, gjithnjë me uratët e tij të drunjta në dorë dhe që pëshpëriste shpesh: *“T’lumtë në per fenë që kena e t’mjertë në, pse s’dijmë me e mbajtë”*. Kur e pyesja dajën e tretë se, çfarë donte të thoshte ai me këto fjalë, në fillim heshtte i menduar, pastaj ma kthente me të shpejtë se nuk duhej t’i merrja seriozisht fjalët e plakut. Daja i katërt dhe i pestë, në heshtje miratonin fjalët e plakut.

Mësuesi im i fillores, na pat pyetur një herë, si pa të keq,

nëse dinim ndonjë familje që ruante gurë të mëdhenj, me kryqe të gdhendur në ta. Klasa kishte heshtur dhe unë, si i mësuar për t'iu përgjigjur gjithnjë pyetjeve të vështira, mora guximin të thosha se, një gur të tillë, e kisha parë te babëdaja im. Klasa heshti sërish, kurse mësuesi tha se duhet të isha gabuar; ndoshta ka qenë gdhendur diçka tjetër, por jo kryq. Desha ta kundërshtoja, por vështrimi i tij më la të grirë në vend. Nga ta dija unë i shkreti se sa e sa familje ishin shkatërruar edhe për shumë më pak; unë, isha aq naiv, saqë besoja se duhej thënë gjithnjë e vërteta, pasi e drejta triumfonte në mënyrë absolute. Shyqyr Zotit që bindjet e mia, nuk u vunë në provë, atëbotë. Teksa e sjell në kujtesë këtë rast, ndiej mall për të mirin, mësuesin tim të parë.

Po nënëdaja, me ato duart e saj të pastra e gjithë rrudha; kur nxirrte atë çelësin e gjatë nga brezi, nën atë bohçen me shirita të bardhë e të kuq, për të hapur pastaj kJORIN, ku ruante qumështin, djathin dhe mazën e trashë! Shtatë fëmijë po hanim përsesh atëbotë, në dy sahanë alumini të mëdhenj, por, vetëm njëri u ngrit, kur po lehnin qentë: *“Ti do t’báhesh shtylla e shpîsë”*, - i tha nënëdaja. U desh të vinte im atë që të më merrte; nuk më ikej nga ajo. *“Duhet t’i kem rá n’lash”*, - iu thoshte djemve të saj për mua, duke aluduar për një traditë të vjetër, që rekomandonte t’i qëlloje pulat me një lëmsh peri, me qëllim që të ktheheshin në darkë në kotec.

Kujtimet më të bukura që ruaj nga fëmijëria, më vijnë nga dasmat te dajat; një gjysmë ore, na duhej vetëm për t’u përshëndetur e për të pyetur njëri me tjetrin, pastaj fillonte liria jonë. Dy-tri cigare duhan, ndonjë gotë raki me djathë, si dhe “orquestra” me sahanët e kthyer përmbys, derisa vinte orkestra e vërtetë, ose ndizej megnetofoni. Sa herë që iu mbinim nëpër këmbë të rriturve, na turisnin si pulat dhe qeshnin me vrapin tonë të harlisur; kurse, daja i tretë, përpiquej të na fuste në punë, po rrallë ia arrinte. Një nga vajzat e tezes, ajo më e shkathta, e pyeti një ditë, se kur do t’i merrte pushimet: *“Jo per gjâ, - i tha, - por ta dijmë, qì t’mos vijmë at javë te dajat”*. Kjo shkaktoi

të qeshura të papara, ndaj e përmendnim shpesh këtë batutë. Pikërisht kjo kushërirë, mu në kulmin e dasmës, shkonte e vishej si plak; i bënte mustaqet me thëngjill dhe pastaj i ftonte të gjithë më radhë në vallëzim. Zakonin e saj filluan ta merrnin dhe kushërinjtë e tjerë, saqë, në një nga këto dasma, shijua pothuajse një “teatër me maska”. E mbaj mend këtë kushërirë, së bashku me motrën e saj më të vogël, teksa kishin ngecur me gjithë gomar në mes të baltës. Si i ndihmova të dilnin nga lluca, nuk më tha as faleminderit; madje, ngaqë vuri se e prisja një fjalë të tillë, ma përplasi fytyrës gjithë inat faktin se, për shtëpinë time po e sillnin atë ngarkesë. Qesha. Qeshi edhe ajo, duke kapërdirë lotët.

Treni e kishte bërë gjysmën e rrugës për Tiranë, kur e pashë veten në mes të një turme të madhe, që i mbushi vagonat cit më cit. Sa hap e mbyll sytë, ngeca në korridorin e rrëmujshëm e plot me njerëz të shtuar, që kërkonin të hynin në vagon. Kur ai, më në fund u nis, plot njerëz ishin akoma në platformën e jashtme dhe mbaheshin për tubash apo dorezash, që të mos binin. Ata na dhanë nja dy të shtyra të forta, derisa, më në fund, dera arriti të mbyllej. Një grup të rinjsh më kishin rrethuar dhe unë mezi arriti të kapem te tubi i derës së brendshme, për të rregulluar paksa drejtpeshimin. Në këtë moment, pati edhe një të shtyrë të fundit dhe, ndërsa këmba ime e djathtë u kap si në darë nga një palë shalë, një gji i njomë e i butë m'u përplas mu në fytyrë; vajza rënkoj lehtë, teksa kuptova se këmbët i kishte pesë-gjashtë centimetra mbi dysheme. Duke parë turbullimin e saj dhe të kuqtë që po i mbulonte fytyrën, mblodha forcat e fundit, për t'i dhënë një të shtyrë turmës, por pa rezultat. I kërkova ndihmë një oficeri dhe tentativa e dytë pati efekt; vajza arriti të shkelte mbi dysheme, si dhe, me një lëvizje të shpejtë, arriti të vendoste para fundbarkut të saj një valixhe druri, ku me siguri kishte vendosur plaçkat e saj. Në këtë moment filloi të vuante gjuri im, i ngjeshur për dërrasë. Ndërkohë, gjoksi i saj, që po më miklonte mjekrën dhe gushën, kishte nisur të mbushej me gjak të nxehtë

dhe të forcohej pak e nga pak. Pulsimi i gjoksit, ndërsa po fryhej dalëngadalë, më elektrizoi paksa lëkurën dhe ndërkohë, fillova të kem vapë. Tërhoqa sërish tubin, për t'i dhënë mundësi vajzës të vendoste parakrahun mes gjoksit të saj dhe gushës sime. Tashmë, po ndieja dhimbje kockash gjithandej. Vetëm atëbotë munda të hedh sytë e t'i shoh fytyrën; të kuqtë e lehtë, që i kishte mbetur akoma mbi mollëza, ia shtonte elegancën një bardhosheje me flokë të verdhë dhe paksa të dredhur; faqet i kishte të mbushuara, por edhe me pak kockë të dalë. I kryqëzuam vështrimet për një çast dhe, kur pashë skuqjen t'i shtohet, i hoqa sytë menjëherë; ndoshta, në të njëjtën kohë me të. E pashë edhe një herë në fytyrë; kishte nisur të errej dhe tiparet e saj po zbeheshin.

Kaluan rreth dhjetë minuta, para se turma të bëhej sërish agresive dhe valixhja e saj e drunjte nisi të zhvendosej dalëngadalë. Kur gjuri im fitoi lirinë dhe rrezikonte të parkohej përsëri, në mes të atyre shalëve të njoma, vajza, me një lëvizje të dëshpëruar, kapi cepin e valixhes; por, ndërkohë, ndieva një nga gjinjte e saj të më puthte gushën. Ai gj, që ishte i qullët në fillim, sapo kishte nisur të forcohej, kur një pikë lëng i njelmët më çiku cepin e barkut, që kishte dalë zbuluar nga ngritja e pavullnetshme e këmishës sime. Ai lot duhet të ishte i saji. Pikërisht në atë moment, kujtesa më kurdisi një lodër; pashë edhe një herë lotët e shoqes së bankës, atëbotë kur isha në klasë të pestë. Mësuesi i letërsisë, që kishte ardhur t'i kontrollonte detyrat, filloi të luante me të. Në fillim me kujdes dhe duke e shoqëruar me ndonjë shaka apo vërejtje për shkrimin, derisa e shfrenoi fare fantazinë, kur nisi t'ia fërkonte, pa teklif, ata gjinj të vegjël e të sapoformuar. Ajo kishte futur kokën mes duarve dhe ishte mbështetur mbi tavolinë, ndoshta për të fshehur veprimet e dorës së mësuesit. Ndërsa, kur ai u largua dhe vajza ngriti kokën, fytyrën e kishte të kuqe all, kurse lotët i rridhnin si rrëke faqeve. Ishin pikërisht këto kujtime, që më shtynë t'i afrohem te veshi dhe t'i them lehtë: *“E mbâj un valixhen.”* U kapa sërish te tubi dhe ia dhashë një të shtyrë me të pasme, për t'i dhënë mundësi asaj të ngrinte parakrahun, si

tampon mes gjoksit të saj dhe gushës sime; pikërisht në këtë kohë, lëshova tubin dhe me vështirësi kapa cepin e valixhes. Tashmë ishte errësuar plotësisht dhe nuk i ndieja më vështrimet e askujt, kurse gishti i vogël i dorës sime mbi valixhen e dërrasës u drithërua si në një kontakt elektrik, sapo ndjeu butësinë e brendësisë së kofshëve vajzërore. Vajza po më dukej më e qetë, por ndërkohë, vura re se parakrahu i saj ishte bërë dru. Me gjithë lëvizjet e shumta, ai nuk e reflektonte më pulsimin e gjoksit, gjë që më bëri të mendoj se edhe ai ishte bërë gur. Një mendim i tillë më trazoi më keq, sa që gishti i vogël filloi të lëvizte në mënyrë të pavullnetshme, gjithnjë e më thellë, në luginën e afshët. Vajza nuk jepte më shenja shqetësimi, as frymëmarrjen e saj nuk e ndieja më, andaj, ai tik nervor i gishtit të vogël, ngeli i izoluar dhe unë u ftoha avash-avash. Sapo treni hyri në stacion, një fashë drite na i ndriçoi fytyrat dhe ne, nuk e lamë rastin të na ikte, për të këmbyer vështrimet; ky ishte ndoshta, i vetmi intimitet që më la gjurmë të thella. Pas pak, dhjetëra njerëz zbritën nga treni dhe ne tashmë mund të rrinim pak më lirisht, ndonëse nuk isha i sigurt, nëse ishte ajo gjëja që doja. Vajzës filluan t'i flisnin shokët e shoqet e saj dhe dalëngadalë, duke u larguar dhe njerëz të tjerë nga korridori, ne e humbëm përfundimisht kontaktin.

Në stacionin e fundit, zbrita menjëherë pas grupit të tyre. Ajo ktheu edhe një herë kokën të më shihte dhe kjo qe hera e fundit që ia pashë fytyrën. I ndoqa pas, deri pranë konviktit të Liceut Artistik, ku erdha sërish të nesërmen a të pasnesërmen, por atë vajzë nuk e pashë më askund; apo mos ndoshta, nuk e njoha dot, në mos, ishte ajo që nuk donte, apo nuk guxonte të më dilte përpara. Më mirë që ndodhi kështu. Si mund të kishte të ardhme një marrëdhënie e nisur në këtë mënyrë? Kështu i thosha vetes sime të dytë, e cila, nuk më dukej fort e bindur.

TOKË E SHPIRTËNVE

HYLLI I DRITES: Rrokull Shqypnîs

Kumbona e kishës s'Tânë Shenjtënve, ka dò mote qì nuk bjé mâ. Nuk âsht prîshë kumbona, as âsht lâgë konopi, thjesht dò rê t'bardha e kanë pâkë¹⁹ errsinen.

V

Universitetet i mbyllën dyert sërish. Ndoshta, askush nuk donte ndryshime më të thella dhe studentët kishin dhënë prova se nuk kënaqeshin me aq pak. Padashur, më kujtohet ai, profesori i gjuhëve të huaja, i cili na bënte thirrje, duke u përgjëruar, që të mos tërqihehim, por përkundrazi, të intensifikonim protestat dhe na i thoshte këtë, pikërisht në momentin kur morëm lajmin për vendimin e Byrosë Politike, mbi lejimin e pluralizmit politik. Fatkeqësisht, ne nuk e dëgjuam; ia dorëzuam ëndrrën tonë Partisë Demokratike, e cila, tanimë, kishte rënë dakort që ne të shpërndaheshim nëpër shtëpitë tona.

Kalova nga selia e re e PD-së, aty pashë mjaft të njohur. “Duhet të shpërndahemi nëpër rrethe, - na thanë, - kjo është porosia e kryesisë.” Po jepeshin nga 800 lekë të reja për çdo aktivist. Kishte tentuar Partia e Punës t’i blinte studentët, por nuk ia kishte dalë; po ia arrinte Partia Demokratike, pa u ndier; ndoshta studentët, nuk e kuptonin; ndoshta, ndiheshin të plotësuar, ndoshta besonin se... nuk e di. Shkova dhe unë të merrja lekët, por më thanë se emri im nuk ishte në listë. Ç’janë këto lista?! Kush i ka bërë?!

Më kërkuan falje disa të njohur. Dikush më tha të kaloja në darkë, se atëherë vinte shefi. Ika nga sytë këmbët e vendosa të marr trenin e parë.

Sa dola në sheshin “Skënderbej” pashë një shoqen time, e përshëndeta i gëzuar; edhe ajo më pa, por uli kokën në një ecje prej manekini. Meqë ajo mori rrugën e stacionit të trenit, unë u ktheva në rrugën e Durrësit. Ajo, më ishte afruar shumë gjatë protestave; dikush i pat thënë se unë isha një ndër kryesorët. Pa

e kuptuar, kisha arritur te “Zogu i Zi”. Dikush më kishte thënë se, atë emër, e kishte marrë nga një lokal i famshëm në atë zonë. Aty, pranë shkallëve që çonin në katin e dytë, ishte një tavolinë. Thuhej se, për atë pozicion ziheshin me grushta e thika. Kush arrinte të ulej në atë tavolinë, qeraste me pije ata të katit të dytë, vetëm e vetëm për të parë “zogun e zi” të kamarieres, kur ajo të ngjiste shkallët; shalët e saj, thuhej se ishin si stekë bilardoje; leshin e mbante të rritur dhe të kuruar, kurse mbathjet, harronte gjithnjë t’i vishte. M’u kujtuan aksionistët, që patën ardhur në fshatin tonë; m’u kujtua mbrëmja e vallëzimit dhe shokët e mi, të cilët kishin hapur vrima në çati, për të qëlluar me llastiqe shalë femrash; m’u kujtua edhe ajo brigadierja, e cila kishte hapur shalët, teksa po na regjistronte rreshtat e prashitur të misrit; m’u kujtuan dhe ata djemtë, që shtyheshin me njëri-tjetrin, për të parë vetëm pak lesh që kishte dalë nga një vrimë e hapur në mbathjet e brigadieses. Vitet ikin, moda ndryshon, por kjo botë në të njëjtën gropë mbytet.

Një bori makine më solli në kohën reale; ishte një i njohuri i tim eti që më ftoi të udhëtoja me të.

- Ore, po ç’keni ndërmend të bëni ju studentët? - Shoferi na shihte me bisht të syrit në pasqyrë, herë njërin e herë tjetrin.
- Kundër Pushtetit Popullor luftoni ju? Këtij pushteti që ju dha mundësi të shkolloheni? - Nuk fola, nuk dija ç’të thosha. Mos ishte më mirë të zbrisja nga makina? Ndoshta, por treni i parë duhet të kishte ikur tashmë, kurse një tjetër udhëtim nate nuk po më pëlqente, prandaj heshta.

- Nuk e kam fjalën për ty, se natyrisht ti je i yni.

- Kaq i sigurt je?

- Pse të mos jem?

- Kam pá një sekretar partije të Tropojës, qi kish ardhë me vrá djalin e tí, vetem e vetem pse kish dalë kundër “Pushtetit Popullor”, po për fat, nuk e báni. A e di pse?

- Jo, ma thuaj.

- Sepse kish pá gjysen e shokëve t’vet, qi kishin dalë kundër

“Pushtetit Popullor”. - Pashë shoferin që vuri buzën në gaz.

Pjesën tjetër të rrugës për Lezhë e kaluam pa shkëmbyer asnjë fjalë; te ura u ula, duke mos e pranuar ftesën e tyre për kafe. Në atë kafene, të ndarë nga pesë a gjashtë veta nëpër tavolina, lezhjanët po diskutonin, gjithë patos, mbi ngjarjet e ditëve të fundit; tamam si dikur, pas një ndeshjeje futbollit të “Besëlidhjes”. Isha tetë ose nëntë vjeç atëbotë, teksa ndiqja tim atë nëpër këtë urë të Drinit, drejt së vetmes makinë që të çonte në Blinisht; veçse, me kokën pas, duke parë plot lakmi e dëshirë nga ajo tryezë, ku po debatohej plot afsh, për ndeshjen që sapo kishim parë. Te cepi i urës, pashë një turmë njerëzish kokë më kokë. U afrova, një djalë i ri po shkartiste tri letra bixhozi, ndërsa të tjerët po e prisnin me lekë në dorë. Pashë dy-tri duar, sa për të kuptuar lojën, si dhe tri-katër të tjera për të studiuar fitoren. Si krijova një farë bindjeje, hodha njërën nga dy pesëdhjetëshet që më kishin mbetur te një nga letrat. Shkartisësi i letrave priti dhe pak, për ndonjë bast tjetër, pastaj ma zbardhi letrën humbëse në surrat, duke e rrëshqitur kartëmonedhën mes gishtave të hollë. Të njëjtin fat pati edhe pesëdhjetëshja tjetër. Pashë përreth për ndonjë të njohur; si vura re një shok, u nguta t’i kërkoja ndonjë lek borxh. Ai, kur e mori vesh arsyen, qeshi me sigurinë time për fitore. Sipas tij, nuk isha i pari që po bija në atë grackë. M’u desh pak kohë që të më vinin mendtë në kokë dhe të pranoja ofertën e tij për të hipur në një makinë. Zbrita te rruga e fiqve, pa asnjë kokërr leku në xhep; që këtu fshati, mbante gati një orë në këmbë.

Këtu pranë, në breg të Drinit, shtrihet dikur Blinishti i vjetër; këtu janë dhe tokat më të mira, tokat që nuk përmyten kurrë. Njëzet minuta bënte varka, që nga kodra ku është vendosur sot fshati e deri këtu, sa herë që Drinit i tekej të dilte nga shtrati e të formonte një liqen të madh, plot me pulëbardha e kujrilla dyngjyreshe. Këto 4-5 kilometra në vijë ajrore, përshkoheshin përditë nga fishkëllima e blinishtasve, që komunikonin me familjarët apo me bashkëfshatarët e tyre. Nga tregimet e gjyshit,

më kujtohet një rast, kur një mik i tij i kishte shkuar për vizitë te toka, teksa ky po plugonte me parmendën e qeve. Kur gjyshja kishte sjellë drekën me varkë, miku ishte ngritur të ikte, me argumentin se nuk kishte ushqim për dy vetë, por, për habinë e madhe të tij, e kishte parë gjyshen të shpërndante serviset e lugëve dhe pirunjve për dy persona. Miku e kishte të vështirë të besonte se gjyshi, e kishte ndryshuar porosinë, vetëm me një fishkëllimë.

Po ecja nën hijen e fiqve, pikërisht të atyre fiqve që dikur ruheshin me roje, me roje me pushkë me kripë. Pothuajse, të gjithë djemtë e fshatit tonë kemi fjetur nga tri netë përmbys, nga gjurma famëkeqe e kripës në të ndenjura. Tamam këtu u zumë atëherë. Nuk më kujtohet mirë se përse, por mbaj mend, vetëm se dikush më quajti kopil, kopil e bir kopili. Nuk e dhashë veten, por sa arrita në shtëpi ia plasa të qarit. Nuk ishte problemi tek e shara; nuk ishte hera e parë që shaheshim, shpesh edhe më keq; problemi ishte te mënyra se si më mbrojtën shokët; nga ajo kuptova se aty duhet të kishte diçka të vërtetë. Nuk mund ta shihja nënën time në sy, ndaj shkova të flija pa ngrënë. Një Zot e di se sa do kishte zgjatur kjo punë, sikur të mos ndodhte diçka tjetër, që i sqaroi të gjitha.

Po i afrohesha shtëpisë, që aty dukeshin dritaret e hapura; gjendesha tamam aty ku bashkohen dy rrugët, njëra që të lidh me stacionin e trenit, kurse tjetra me xhaden e makinave. Pikërisht këtu, i takuam ata dy burrat, të cilët, edhe pse i shihja për herë të parë, më puthën e më morën në krahë plot mall. Siç e mora vesh më vonë, ata ishin djemtë e xhaxhait të babait tim, por pjesa më tronditëse ishte të merrja vesh se ata, të cilët, i kisha thirrur “gjysh” e “gjyshe”, në të vërtetë, nuk ishin gjyshërit e mi. Këto dhe të tjera gjëra i mësova teksa “gjyshi” im bisedonte me “axhat”e mi, ndërsa unë rrija poshtë tavolinës kryesore të dhomës së pritjes, i maskuar nga mbulesa e saj.

Gjyshi im, ai i vërteti, kishte zbritur nga malet e Pukës, për të gjetur vdekjen në malet e Lezhës, së bashku me gruan e

tij, por jo pa sjellë në jetë tim atë, të cilin, gjyshi që njihja unë, e kishte adoptuar. Ky ishte një zbulim i pabesueshëm për mua. Asgjë deri atëherë, nuk më kishte dhënë shkas të dyshoja për diçka të tillë, përveç incidentit me “kopilin”, që nuk pati kohë në dispozicion të më bënte shumë dëm. Dëgjoja e dëgjoja papushim, i strukur aty nën tavolinën e mbuluar dhe habitesha me veten time, se ku i kishin ruajtur në mendjet e tyre, këta njerëz, gjithë këto histori e ngjarje që nuk m’i thanë kurrë, deri atë ditë. Ato ditë, kuptova diçka nga etika e komunikimit, por edhe më tepër; ato ditë, kuptova arsyen pse fshati na mbante si të huaj. Më shumë nga të gjithë u gëzua babëdaja: “*Tani po e martoj time bijë*”,- tha ai, në darkën që shtroi për këtë rast.

Që nga ky moment, unë do të shkoja çdo vit në malet e Pukës. Mes këtyre axhave, pata, për herë të parë në jetën time, vëmendjen e të rriturve ndaj mendimeve të mia. Mushkëritë m’u zgjeruan, kurse këmbët u stërviten për të ecur në të përpjeta; qershitë dhe arrat e larta, u bënë sfidat e mia të reja. Një qershi, më e larta e fshatit, u bë shpesh shkak për të sharat dhe gjuajtjet me gurë të një plaku. Nuk ishin kokrrat e saj që më nxisnin ta vazhdoja atë lojë, ishte sfida ndaj lartësive, së bashku me kënaqësinë që na jepte shfryrja e inatit prej të moshuarit simpatik. Dikur, ai e kuptoi lojën tonë dhe, si i mbaronte të sharat e kërcënimet, qeshte lehtë nën mustak, duke vazhduar prashitjen në arën me misër. Një herë, më ngritën nga gjumi në mesnatë, vetëm e vetëm, që t’iu tregoja të rriturve këto histori me Çunçamlukun. Për herë të parë në jetë u ndieva si në qiellin e shtatë, teksa të gjithë ata burra e gra po më dëgjonin vetëm mua.

Preva për shkurt që të kaloja kanalin, mbi dy tubat e ujit të vaditjes, ngjitur me parcelat e arrnjetit; nuk di pse quhej kështu kjo tokë, ndoshta ngaqë ishte shumë e ashpër. Një ditë prej ditësh, mblodha nja njëzet peshq, të ngelur në anët e këtij kanali të shterur; por, kur i çova në shtëpi, më detyruan t’i hidhja dhe të laja fort duart me sapun. Me gjithë erën e fortë

të dekompozimit, unë e kisha të vështirë të kuptoja pse ishin të pangrënshëm. Po laja duart te puseta; pikërisht aty, luaja me shkop në ujë, gjashtë vite më parë, kur mora vesh se do të shkoja në shkollën “*Skënderbej*”. Dikush tha se unë nuk isha për atë lloj shkolle. Babai e kundërshtoi, por unë do t’i jepja të drejtë, sa herë më duhej të kapja normat, për një notë kaluese në fiskulturë. Një nga profesorët tanë atje, thoshte se e bëja për snobizëm, sa herë shihte atë pesë në dëftesën time plot me dhjeta. Do të kishte qenë fatale kjo lëndë për mua, sikur të mos ndryshonin kriteret, në ditët e mia të fundit, në këtë shkollë. Nga treqind e ca “begsa”, vetëm dhjetë prej tyre mund të shkonin në degë civile, ata me mesataren më të lartë. Teksa në vitin e fundit u shtuan shumë dhjetat fiktive, kurse unë, në semestrin e parë, ngela fare në fiskulturë. Pothuaj kalova në depresion dhe gjatë stërvitjes dimërore në Voskopojë isha pranë vendimit për ta lënë fare shkollën.

Atë natë jepej një film, të cilin, televizioni shtetëror, kishte një javë që e reklamonte. Tani, as që më kujtohet fare titulli, por joshja e një filmi aksion ishte e fortë në ato kohë. Tri herë me radhë, na ktheu pas komandanti i togës së dytë, vetëm se nuk po hynim me rregull e qetësi; tri herë arrita të zë vend, kurse herën e katërt, ngela në këmbë, pikërisht atëherë, kur ai u dorëzua dhe nuk na nxori më jashtë. E pashë atë film në këmbë, deri në orën njëmbëdhjetë, ndërsa në dymbëdhjetë do të merrja shërbimin e rojës; andaj, nuk e pashë të arsyeshme të flija, edhe pse paradite kishim bërë njëzet kilometra marshim. Si mora shërbimin, na erdhën dy fshatarë me një ofertë interesante: do të na jepnin nga 20 lekë të reja, nëse pranonim të ndërronim çizmet me ta. Unë e pranova ofertën, aty nga fundi i shërbimit; vura çizmet e fshatarit te këmbët e krevatit dhe rashë të flija si i vdekur. Nuk e di sa kohë kishte kaluar, kur m’u duk se po shihja një ëndërr, në të cilën dikush po i binte sinjalit të alarmit. E kuptova se ishte zhgëndër, vetëm kur e pashë veten me gjithë dyshek mbi dysheme. Toga ime kishte njëzet minuta që priste në rresht

ardhjen e ushtarit të fundit, derisa dikush e kishte humbur durimin. Sa dola jashtë, komandanti e shpërndau togën dhe nisi të merrej vetëm me mua; e dëgjoja si në tym monologun e tij moralizues, teksa trupi mezi më bindej të qëndronte në këmbë. Pas disa justifikimeve të mia, ai shpërtheu:

- Nëse do të bëhesh oficer, duhet të durosh edhe më tepër.
- Nuk dua të bëhem oficer.
- Besoj e di, se kjo është një shkollë ushtarake?
- Po unë do të shkoj në degë civile.
- Vetëm nëse nuk ngel në lëndën e edukatës ushtarake.
- Duhet ta marr si kërcënim?
- Merre si të duash... ti nuk ke respekt për eprorin tënd.
- Unë nuk kam më fuqi, jo respekt.
- Epo, këto janë kushtet: o duro, o ik.

Mendova vetëm një çast, para se të nisesha tatëpjetë luginës, fiks në momentin kur u dëgjua një ulërimë ujqish.

- Ku shkon? Kthehu. - Komandanti po më ndiqte nga pas.
- Nuk jam për këtë punë, po iki.
- Kthehu të them.

- Mos ma merr për mungesë respekti komandant, por nuk mundem më.

- Ktheu... shko në atë drejç shkollë civile, se...

- Thua, të duroj edhe gjashtë muaj? - Ndërkohë kisha ndaluar dhe këmbët, në mënyrë të pavullnetshme, po më çonin drejt fjetinës, shoqëruar nga zëri i ngjirur i ujqërve, që duket sikur vajtonin për humbjen e ushqimit.

Të nesërmem, çizmet tona binin tmerrësisht shumë në sy; komisari na mori emrat shënim dhe ne paguam, ekzatësisht nga 20 lekë, kur u kthyem në Tiranë. Të ishte rastësi vallë?! Si mora vesh për kriterin e ri në përzgjedhjen e studentëve të degëve civile, i cili mbështetej në mesataren e katër viteve, për mua, u bë e qartë se kisha fituar, ndonëse duhet të kaloja edhe një provë të fundit.

Me skuadërkomandantin tim nuk flisja. Tani nuk më

kujtohet fare arsyeja e zënkës. Me siguri, duhet të jetë bërë shkak pedantizmi i tij në raport me rregulloren ushtarake. Këtë ushtarak të devotshëm, një nga mësuesit tanë, e kapi duke përdorur fjalën “kurvë”, në adresë të mësueses së re të anglishtes, vetëm e vetëm se ajo kishte veshur një fund me pala, i cili nuk vinte më i gjatë se deri pak poshtë gjurit. Në fillim ky, nuk pranoi ta kishte thënë atë fjalë, por shpejt ra viktimë e strategjisë së drejtorit të shkollës, i cili, duke u hequr si dashamirës, e nxiti të pranonte. U thirr urgjent mbledhja e organizatës bazë të rinisë, e cila, në fakt, do të thoshte të mblidhej e gjithë toga. Drejtori i shkollës, komisari i batalionit dhe komandanti i togës thirrën tre prej nesh; njëri ishte sekretari i rinisë, kurse dy të tjerët ishim pretendentë për degët civile. Na u kërkua të merrnim flamurin e sulmit; shoku ynë, duhej përjashtuar patjetër nga shkolla, morali i saj duhej mbajtur i pastër. Heshtjen tonë, ata e morën për pranim. Sapo mbaroi prezantimi i ngjarjes, iu kërkua të jepte mendimin e tij sekretarit të rinisë. Dy vitet e para, kisha qenë vetë sekretar rinie, pastaj komandanti, nisur nga liberalizmi im i tepruar, e kishte propozuar këtë ndryshim. Në fillim, ai nuk kishte pranuar, derisa m'u desh të deklaroja se shkresurat burokratike do t'i kryeja sërish unë. U ngrit të fliste. Si e dënoi gjestin me fjalë të përgjithshme, ai propozoi që shokut tonë t'i jepej një “vërejtje” e thjeshtë.

- Kush të ka zgjedhur sekretar rinie ty? - shpërtheu drejtori. - Ky është liberalizëm.

- Shokët më kanë zgjedhur, - ishte përgjigjja e tij, me zë të mekur.

- Ulu në vend, more... Kush e do fjalën tjetër?

U ngrit shoku tjetër dhe propozoi “përjashtim nga shkolla” për skuadërkomandantin. E dija mirë se e kisha radhën unë, por nuk mora guximin të ngrihesha, pa ma përmendur emrin mësuesja e letërsisë, e cila ishte edhe mësuese kujdestare. Kjo ishte një femër e pispillosur, që i kishte ndërruar nja dy dashnorë. Një here, klasa jonë mori afro njëzet katra në testin

e fizikës. Kur e mori vesh mësuesja kujdestare na shau, pa u lodhur, për gati dyzet e pesë minuta, me gjithë vokobolarin e shqipes, bashkë me gjithë dialektet, duke filluar nga “katundarë” e “bythëpalarë” dhe deri te “surratqenër” apo “dhi e zgjebosur e bishtin përpyjet”. Orën tjetër, ajo vuri trembëdhjetë katra te klasa ku ishte kujdestare mësuesja e fizikës; vetëm se ra zilja, se do t’i kishte vënë dhe shtatë të tjera. Të nesërmen, në pushimin e madh, dy mësueset u takuan te shkallët. Pyetjes: “A ke marrë vesht se klasa jote, një ditë më parë, kishte ardhur krejt e papregaditur?”, mësuesja fizikës iu përgjigj me një “po” të vakët; kurse pyetjes tjetër: “A i ke sharë dhe çfarë ju ke thënë?”, kjo shkodrane e mrekullueshme, iu përgjigj me fjalët: “Ju kam thënë: mirë jau ka bá”.

Nisa të flas, duke e dënuar gjestin, por edhe duke kërkuar ndonjë shteg lehtësues, të cilin e braktisja, sa herë që shikoja fytyrën e vrenjtur të drejtorit, për ta rimarrë sërish, sapo shihja majën e skuqur të veshit të shokut tonë, që nuk i flisja prej kohësh.

- Kujdes, se po bie edhe ti në liberalizëm, - Drejtori e dinte mirë, se fjala ime do të ishte vendimtare; nëse edhe unë do të kërkoja përjashtimin, ajo punë kishte marrë fund.

- Nuk kam folur akoma për masën që propozoj.

- Hë pra, thuaje mendimin tënd, - Këtë radhë foli komisari, i cili dukej sikur donte të më nxiste ta hidhja hapin e pakthyesëm, meqë e dinte sherrin tim me skuadërkomandantin. Nisa t’i vij rrotull problemit sërish, por një zë i fortë më ndërpreu:

- Dhe çfarë propozon?

- Nuk jam dakort me propozimin për “një vërejtje”... - panelit i qeshën “mustakët”, - unë propozoj masën: “paralajmërim për përjashtim nga shkolla”, - thashë këto dhe u shemba në karrige, pa guxuar t’i hedh sytë drejt panelit. Kishte rënë një heshtje e thellë. Pas pak, drejtori ua dha fjalën të tjerëve; të gjithë ishin dakort me propozimin tim dhe fundi dukej i qartë, por mësuesja kujdestare m’u drejtua sërish:

- Si thua ti, i thuhet një mësueseje ajo fjalë? Do t'ia kishe thënë ti?

- Nuk e di... - ato fjalë, më dolën në mënyrë të pavullnetshme.

- Unë jam e sigurt se ti nuk e thua dot kurrë atë fjalë, ti je si kristal... ndaj, të ftoj ta rishikosh propozimin tënd.

- Në mos e kam thënë, e kam menduar... - kësaj radhe, pata kurajon t'i shihja drejt e në sy të gjithë, - ...dhe, ndonëse nuk jam dakort me mendimin e shokut, nuk mund të kërkoj përjashtimin e tij nga shkolla për një fjalë të shqipes, për më tepër, thënë kjo, jo drejtpërdrejt mësueses.

Vështrimi i drejtorit fliste qartë. Me siguri që duhet ta qaja degën civile, por nuk ndodhi kështu; ndoshta u ra inati, ndoshta e kuptuan budallallëkun që donin të bënin, apo ndoshta ndërhyri ndonjë forcë madhore dhe ata nuk u hakmorën ndaj meje. Dështoi, edhe përpjekja e tyre e fundit me mësuesin e ri të fiskulturës, i cili më vuri shtatë, si notë përfundimtare për lëndën e tij. Ata kundërshtonin faktin që, nota “katër” e semestrit të parë, së bashku me notën “shtatë” të semestrit të dytë, na dhënkuan “shtatën” si notë përfundimtare; por, mësuesi, një ish-futbollist i famshëm, ua preu shkurt, duke u thënë se, fiskultura nuk është matematikë: po kape normat për notën “shtatë”, “shtatë” meriton. Mirë që nuk kërkuan të më merrnin në provim me komision, ndoshta nuk i la respekti për mësuesin, i cili ishte edhe trajneri i ekipit të futbollit të shkollës.

Na linin shpesh, deri dy orë të gjata në rresht, në erë, në shi e në diell, vetëm se i tekej dikujt apo ndoshta ngaqë ishte vonuar zierja e supës, andaj, ngadonjëherë, shkoja i ngarkuar me ndonjë libër në gj. Njërit prej komandatëve i kishte rënë në sy kjo gjë, andaj, një ditë, m'u turr gjith nerv dhe do të ma kishte grisur librin, nëse... Duart iu dridhën dhe libri ra përtokë, sapo pa portretin e “dullës” në kapakun e tij. U ul, mori librin dhe para se të ma jepte, e pastroi lehtë me dorë. “Udhëheqësin, ta mbash në zemër, por jo në rresht”, ishte batuta e tij, të cilën sapo

e tha, m'u duk se u pendua. Kjo ndodhi, më solli në mendje ditën e vdekjes së diktatorit; muzika funebre, nuk paralajmëronte asgjë të mirë, teksa lajmi solli histeri dhe lot te njerëzit që më rrethonin. Nuk reshtën lotët, as në ceremoninë mortore, që gjysma e fshatit kishte ardhur ta shikonte në shtëpinë time. Në një moment, vëllaçkoja i vogël, i cili ishte vetëm katër vjeç dhe nuk kishte parë kurrë aq shumë njerëz në shtëpi, tha diçka, që na bëri të qeshnim; mbi dymbëdhjetë gra të lagjes, ulën kokat për të mbuluar të qeshurat, por kur i ngritën, sytë i kishin plot lot; edhe organizmi, na e dinte hallin. Atë ditë, shëtita me orë tëra; seç po shijoja një aromë lirie, që s'e kuptoja se nga më vinte. Një i internuar, fëmijë i një ish-blokmeni, duke më folur për librin "*Bethoveni dhe revolucioni francez*", do të më thoshte se, pasi ta lexoja atë vepër, do ta kuptoja se kombi shqiptar, nuk kishte nxjerrë njeri më të shquar se "peshkopi i kuq". U trondita shumë. Kishin kaluar vetëm dy ditë nga varrimi i diktatorit, kurse për Fratin e Madh dija shumë pak gjëra.

Do të kthehesha në shkollën "*Skënderbej*" në dhjetorin e nëntëdhjetës. Dikush tha, se do të përdroreshin studentët e shkollës ushtarake, për të "shtypur" lëvizjen studentore. Unë i njihja pothuajse të gjithë, ndaj shkova të flisja me ta, pavarësisht nga paralajmërimet e shokëve. Në fillim, hyra në shkollën "*Skënderbej*", nga territori i spitaleve, nëpërmjet vrimës në banjot publike. Ato ishin vendosur në mes të dy godinave shkollore dhe kishte një histori interesante, që lidhej me hapjen e atij rrugëkalimi. Dikush, pati shembur tullat në banjon nr. 7, kurse komanda mori masa për betonimin e saj. Të nesërmen, u shemb banjoja nr.5, me ndërhyrjen flakë për flakë të komandës; ishin gjithsej, tetë banjo. Te banjoja e fundit, ata vunë një roje, deri në ngrirjen e betonit; ushtari përfitoi tri ditë leje, por ngaqë ishte nga Kukësi, u kthye pa arritur dot të shkonte në vendlindje. Kohë më pas, dikush solli një matrapik miniere dhe vrima u hap sërish. Komanda, e lodhur nga sfidat, bëri një sy qorr e një vesh shurdh, për të mos dështuar më keq. Edhe atë dhjetor, rrugëdalja

funksiononte dhe vrima në beton të ofronte të njëjtën pamje.

Aty nuk para njihja njeri. Ishin ndërruar dy breza ndërkohë, andaj, nëpërmjet portave të kribtura të kinemasë, kalova në Shkollën e Bashkuar Ushtarake. Të parët që takova nuk i njihja. Ata kishin filluar të merrnin studentë edhe nga shkollat bujqësore të fshatrave; skënderbegasit, sikur kishin humbur mes tyre. Ndonëse më humbi pak siguria, nisa t'iu flas edhe atyre. Ata më dëgjuan në heshtje; u afruan edhe të tjerë, derisa dikush më quajti “të shitur” dhe dekadent seksual; kështu, me sa duket, iu kishin thënë komisarët për ne. Të mos ishte për disa ish-skënderbegas, që u afruan pak më vonë, besoj se do të kisha përfunduar keq. I motivuar nga mbështetja e ofruar, vazhdova me idetë e mia liberal-demokratike, derisa m'u ofrua njëri dhe më tha të largohesha shpejt; ishte njoftuar komanda dhe nga çasti në çast, aty do të vinin “besnikët e verbër”. E pashë në sy; ishte i ashtuquajturi “i forti i shkollës” “Skënderbej”, dy breza përpara meje.

Në brezin tonë, kishim një kuksian të “vogël”, i cili, pothuaj flinte në palestër dhe për dy vjet arriti të krijonte një fizik të admirueshëm. Nga fundi i vitit dytë, i kërkoi duel më të fortit të vitit të tretë dhe e mposhti për dy minuta. Mirëpo, ai i vitit të katërt i shmangej duelit; iu deshën shumë të shara e provokime, që të tërhiqte vëmendjen e tij. Për njëzet e ca minuta ndenji me faqe për asfalt, i futur në një darë, nga krahët e shkodranit të vitit të katërt. Nuk do të ishte dorëzuar, po të mos i binte të fikët. Tani ndodhesha përballë shkodranit dhe zemra më thoshte se duhej t'i besoja. Kapërceva murin si ketër, para se të dëgjoja thirrjet e para hysterike. Kisha kaluar në trotuarin përballë kur, katër-pesë fytyra të shfytyruara nga tërbimi më kërcënonin mbi mur, pa guxuar ta kapercenin; ndoshta kishin frikë nga bota përtej murit. M'u kujtuan qentë e vilave, apo ata të shtëpive në mal, si dhe qentë e barinjve në stane, edhe ata s'e kalonin kurrë sinorin.

...Kisha arritur në shtëpi, ku, për kënaqësinë time, vura re se kishin ardhur kushërinjtë nga larg. Im atë dukej i heshtur,

kurse të tjerët plot me humor. Shpejt mora vesh se babai kishte zhvarrosur eshtrat e të atit dhe po i niste për në vendlindje; ndoshta ky do të ishte i fundit nga ne, që do ta mbyllte ciklin në origjinë. Tashmë, kisha nisur t'i shijojë perlat e Fratit të Madh:

*“... Kurr Shqypnî, s’kam me t’harrue,
edhe n’vorr, me t’permëndë kam”*

TOKË E SHPIRTËNVE

Kumbona gjimoi edhe 'i herë, si kurr ma parë.

- Eni o bîjtë e Zadrimes, eni e nderoni t'vorruemt e rij!
- Na ndêrove o Permêndôre.
- Dêka e t'jetuemt tuej, kjen per n'ltêr.
- T'fâlna ndêrs, per njikyt pllâmbë tokë t'bekueme!
- Ju jeni ndêra e ksaj toke. Liria per t'cillen ju luftuet, nderimi qi ju bani Ati yn n' Boulevard t'Dishmorvet t'Kombit...
- Janë tue ardhë edhe t'tjerë, bashk me Nanë e Bîjë.
- Toka jonë âsht edhe jueja.
- Ata duen veç pak ajer, pasi êshtna s'kanë mâ.
- Bjër moj kumbonë, bjër per zi!
- Bjër moj kumbonë, bjër edhe per liri!
- Eni vllazên! Ja ktu, o Lahutë e ti, o Kanûn, Visare t'Kombit, Prrâlla Shqiptare e ti, o Ditar, Ândrra e Jetës edhe ti, o Vandâku i Ferrave; eni t'Krijuemt e Rruzullimit e ti, o Abat, eni, o Muza t' Shqiptarîsë, ti Enciklopedi e ti, o Gramatikë e Shqipes, Histori e Shqipnîs e ti, o Ândrra e Pretashit; eni, eni!
- Po vijnë te tanë, ...edhe Hija e Maleve me Kullen e me at Karpasin (barrë e vrâme n'pârzem t's'âmës)... po vjen edhe Poema e Mjerimit me dō Visare t'tjera t'Kombit... eni, eni Dallndyshe, eni, o Dhjata Jême e ti, o Rnō Per Me Tregue... ja ktu, o Rrëfime Zadrimore, edhe ti, o Histori e Skânderbegut, bashk me Skânderbegun Simbas Gojdhânave.
- Pîni, o vllazen, pîni Elikirin e Perjetsîsë!

- *Po vijnë edhe Çinarët e Bregut t'Drinit.*
- *Le të rrjedhë lûmë dashnija, nektari e poezija!*
- *I pruni Lumi, edhe Çeten e Profetënove, edhe Pasqyren e t'Rrifyemit me Mesharin.*
- *U derdh Lumi e u perpoqen motet!*

VI

Kaluan edhe tri vite, por asgjë e rëndësishme për t'u shënuar; unë po bëhesha gati për diplomën, ndonëse asgjë s'e ngrohte të ardhmen time. Ndërsa kthehesha për në fshat, me të vetmin autobus që shkonte drejt tij, pashë disa fshatarë që po shkullnin egjër në grurë dhe qesha me ta; për të shkullur dy bimë të egra, ata shkellnin me qindra bimë të shëndetshme; mirëpo, sa arrita në shtëpi, im atë më dha të njëjtën detyrë. Nuk besoj, se ai shpresonte shumë nga produktiviteti i kësaj pune. Ndoshta, ai donte, vetëm të më zinte ditën me punë, për të mos rënë pre e "shfaqjeve të huaja".

Nuk e kundërshtova; dola nga shtëpia së bashku me letrat e lojës, për ta ndalë frymën te lokali i vetëm i fshatit, pasi kisha ardhur rrotull nëpër parcela për një gjysmë ore të tërë. Loja nuk më eci; në fund pranua qerasjen e fituesit dhe, ndërsa po bëhesha gati të largohesha, më ofruan edhe një birrë tjetër. Nga tavolina përballë, më përshëndetën tri veta; dy ishin bashkëfshatarë të mi, kurse të tretin nuk po e njihja. Nuk hezitova të bashkohesha me ta, por biseda e tyre më habiti dhe më zhgënjeu, njëkohësisht. Personi i panjohur, na qenkësh një i ndjekur nga policia, dhëndër i njërit nga të pranishmit, të cilit, na i qenka bërë një padrejtësi e madhe dhe vetëm një ndërhyrje e fuqishme mund ta shpëtonte. Nuk po kuptoja se ç'kërkoja unë në atë bisedë, por më ndihmoi ndërmjetësi. Sipas tij, vetëm ndërhyrja e një prej shokëve të mi, atij që ishte bërë flamuri i demokracisë, mund ta ndihmonte personin në fjalë që të vendoste drejtësinë. Nuk dija çfarë të thoja; desha t'i qeras me nga një birrë e të iki, por u kujtova në kohë, se nuk kisha më lekë.

U premtova diçka të vakët, thashë se do të përpiqesha, derisa ai, i kërkuari nga ligji, më premtoi se do të më falte makinën dhe ky ishte rasti, kur unë mund të shpëtoja fytyrën, duke deklaruar se nuk bëja asgjë për përfitime personale.

U ngrita e dola jashtë. Në rrugë nuk pashë njeri, ndaj u futa te salla e bilardos. Dikur aty gjallonte një karambol i thjeshtë, me tre gurë fildishi, kurse tani, tregu i hapur, kishte sjellë një bilardo moderne. Para shumë vitesh, në këtë sallë kishte pasë ardhur sekretari i parë i Partisë së Punës në rreth. Si i kishte mundur të gjithë kuadrot e kooperativës, kishte nisur të tallej me ta, të cilët, të prekur në sedër, i kishin kërkur leje, për të sjellë aty, kampionin e fshatit në karambol. Ky mjeshtri, në fillim ishte treguar i rezervuar, po kur i ardhuri kishte nisur të tallej edhe me të, ishte tendosur deri aty, sa e kishte mbyllur ndeshjen, pa e lëshuar stekën nga dora. Sekretari i partisë, i nxirë nga inati, e kishte pyetur nëse punonte gjëkund, apo flinte në bilardo. Ngjarja ishte mbyllur pa pasoja, kurse fshatarët e mi u ndien të përkëdhelur në sedër, për sfidën që i kishin bërë pushtetit, nëpërmjet bashkëfshatarit të tyre. Ky kampion karamboli, shumë shpejt do të arratisëj përtej kufijve, duke përfunduar deri në Kanada, por blinishtasit nuk e hoqën kurrë nga goja emrin dhe historinë e tij me sekretarin e partisë. Kur, para disa muajsh, ky do të kthehej për herë të parë në Shqipëri, pas një mungese prej 20 vitesh, nuk ngeli njeri pa e vizituar. Një darkë, doli shëtitje në qendër të fshatit dhe, shumë shpejt, përfundoi në sallën e bilardos; loja u ndërpre dhe i kërkuan të shpaloste diçka nga arsenali i tij; dikush doli të bënte sfidantin dhe të gjithë mbajtën frymën. Askush nuk bënte tifo për sfidantin, por ai nuk u dorëzua. Edhe pse fitoi, askush nuk e uroi, kishte rrëzuar një mit dhe askush nuk ia falte.

Dola sërish jashtë. Nuk dija ku të shkoja, por më shpëtoi vëllai i pronarit të lokalit. Ai propozonte të shkonim e të luanim me letra në Gjadër, atje luhej para e madhe dhe investimi ishte i tij. Pranova, pa u menduar dy herë. Tri herë u ndiem

të fituar dhe po tri herë iu afruam humbjes totale të lekëve, para se të linin lojën, me gjysmën e investimit të humbur. Ishte akoma natë, kur i ramë për shkurt nga vendroja e aeroportit. Zakonisht, aty të linin të kaloje, pasi kishte vite që nuk ulej asnjë avion në pistë, por atë natë, ushtari nuk hapte rrugë. I thashë të thërriste komandantin. Papritur, pashë se ai ishte një i njohuri im, i diplomuar për teknik avionësh. U befasuam të dy dhe të dyve na erdhi keq për gjendjen e tjetrit. Pjesën tjetër të rrugës e bëmë pa folur. Kur ia afruam Blinishtit kishte nisur të zbardhte. Kapërceva murin e u futa në oborr; nuk mund të ngrija njeri nga gjumi, në atë orë; rashë të flija si i vdekur.

Në dijeninë time, kishin kaluar vetëm pak minuta, kur nisa të dëgjoj atë thirrjen e bezdisshme: “Çou, çou”. Me sa më kujtohej, shkollën “Skënderbej” e kisha mbaruar me kohë, por situata dukej e njëjtë, mungonte vetëm boria. Fjeta edhe disa minuta të tjera, sipas meje, para se të dëgjoja nënën të më lutej të ngrihesha, pasi im atë duhet të ishte zemëruar tashmë. Pashë orën, kishte kaluar dhjeta. U ngrita me të shpejtë dhe dola të freskohesha; mezi po qëndroja në këmbë, por bëra çbëra, mora rrugën e fushës. Im atë, po qëndronte para grurit të sapokorrur dhe të derdhur mbi një plastmasë; ishte ndoshta edhe sasia e vogël e prodhimit që e kishte irrituar, por fjalët e tij qenë vërtet të ashpra dhe unë vendosa që kupa të derdhej. Ika, pa kthyer kokën pas.

Po ecja fushës, kuturu, nën diellin që po bëhej gjithnjë e më i fortë, i bezdisur nga mizat dhe i shoqëruar nga pluhuri, që ngrihej pas meje si kometë. Te fiqtë u ndala dhe mbusha barkun; bëra një xhiro nëpër Gjadër, ku shumë veta më ftuan në shtëpitë e tyre, por unë nuk pranova, pasi pas pak do të errej. Po errej vërtet dhe unë po ngrija ftohti, nën hijen e fiqve. M’u kujtua historia e fëmijërisë me mullarët, por këtu kishte vetëm disa tuba të vogla bari. Mora bregut të Drinit dhe dola në Kakarriq. Atje pashë një bilardo të hapur dhe thashë të kaloja disa minuta aty. Kaloi një gjysmë ore, derisa pronari iu sugjeroi lojtarëve të

më fushin në lojë. Fatmirësisht, ata ishin shumë të rrëmbyer nga loja, për të qenë të njerëzishëm, kurse unë, në rastin e parë që m'u dha, dola me të shpejtë që aty, para se të duhej të pranoja se nuk kisha asnjë qindarkë në xhep.

Si shtrova bar të thatë, duke ruajtur paksa për t'u mbuluar, mendova se mund të flija, por kinemaja e mendjes sime vendosi të jepte shfaqje. Para meje kaloi, si në film, e tërë jeta ime, duke më goditur në kokë si çekan, pyetja e vetme: "*Ku kisha gabuar?*" Zinxhiri i jetës sime kishte ngecur në hallkën e tij më të dobët, por unë, prapëseprapë, nuk isha gati të dorëzoja asnjë skrupull. Ndoshta isha viktimë e moralizimit të tepruar, apo mos ndoshta, thjesht nuk duhet të dorëzohesha. Të mos dorëzohesha. Si atëbotë, kur po hapnim atë kanal in e zi nëpër shi; unë nuk isha as dhjetë vjeç dhe po kërcëllitja dhëmbët nga të ftohtit, duke u dridhur "si thupra në ujë", kurse babai, donte ta mbaronte atë punë me patjetër. Durova si "*i ziu i shokëve*" dhe, nuk e di çdo të kisha bërë, sikur të mos ndërhynte nëna; për dy ditë zura krevatin dhe ethet mezi më kaluan, kurse babai tallej me metabolizmin tim të dobët, sipas tij.

Dielli nuk kishte dalë akoma mbi kreshtë, ndërsa unë po lahesha në Dri; lava edhe rrobat, të cilat i vura të thaheshin mbi ferra, duke i vështruar, sikur të doja që t'ua hiqja ujin me sy. Rrobat ishin tharë, para se të dëgjoheshin zhurmat e para të makinave. Dola në xhade, po makinat nuk ndalonin; ose ishin plot e përplot, ose nuk më njihnin. Po i afrohesha bilardos dhe unë nuk doja të hyja sërish atje. Më shpëtoi një makinë që ndaloi te këmbët e mia; ishte një i njohuri im, më mirë themi, kushëriri i një të njohurës sime. Ajo ishte një mësuese fshati dhe vinte nga qyteti me autobus. Ishte grua simpatike dhe mua kishin nisur të më pëlqenin bisedat me të. Ndonëse e dija se ishte e martuar, i lejova vetes të ndieja për të. Teksa po bëhesha gati t'i ngrija marrëdhëniet në një nivel të ri, befas, një ditë, duke më parë në sy, ajo më thotë se burri i saj, për gjashtë muaj do të ishte në Turqi. Ndonëse do ta kisha dashur një situatë të tillë, ato fjalë

më ranë si një dush i ftohtë; e pashë në dritë të syrit, derisa u venit porteti im në beben e saj. Nuk e takova më, kurse tani po udhëtoja me kushëririn e saj, ose të paktën, kështu ma kishte prezantuar ajo. Sa arritëm në Lezhë, e ftova gjithë frikë për një kafe. Fatmirësisht, ai nuk kishte kohë dhe unë e falenderova, teksa ecja trotuarit i lehtësuar. Kalova një ditë normale, në shoqërinë e disa prej miqve të mi. Pimë kafe e konjak të lirë, derisa filluam të filozofojmë mbi teorinë e letërsisë pa letër; njëri më huajti një kartëmonedhë njëmijëshë dhe fillova të ndihem më komod, ndonëse, sërish, nuk më lanë të paguaja. Nuk iu tregova fare për problemet e mia, kështu që, në darkë, mora rrugën për te hotel “Kashta”. Fatmirësisht, në atë orë, gjen makina vetëm për Gjadër dhe të gjithë ata që duan të shkojnë në Blinisht ndalojnë te rruga e fiqve. Atë natë, pashë në ëndërr fshatin tim; pashë një lagje plot me pallate të ndriçuara; pashë një rrugë me trotuare, lulishte e pemë, ku unë dhe fantazia ime bëmë xhiro gjithë ditë-natën, me sytë nga një ballkon, ku prisnim të hapej një dritare.

Të nesërmen dola të shoh se ç’bëhej nga qendra e fshatit. Aty më pa një nga vëllezërit dhe pak më vonë erdhi nëna; nuk i durova dot lotët e saj, andaj i premtova se në darkë do të isha në shtëpi. Darka më zuri sërish në një lojë me letra dhe rreth orës tetë, së bashku me shokët, mora rrugën e shtëpisë. Më kujtohet shpesh, hera e parë dhe e vetme që provova thuprat e tim eti, edhe atë natë kisha shkuar vonë në shtëpi; nëna ankohej për punët e shtëpisë, kurse unë vonohesha gjithnjë. Atëbotë, mësimin e bënim pasditeve dhe kur dilyn nga shkolla shikoja burrat e fshatit të mbledhur grupe-grupe, teksa debatonin për probleme nga më të ndryshmet, ndërsa unë, kureshtar i lindur, ulesha diku pranë tyre dhe dëgjoja, derisa grupi shpërbëhej. Nëna u pendua për ankesat e saj, ndërsa unë shtrëngoja dhëmbët për çdo goditje; sapo kisha mbushur dymbëdhjetë vjeç dhe nuk ia lejova vetes të derdhja lot. Ndërkohë, babai, si theu edhe thuprën e fundit, u ul i lodhur në divan, duke më paralajmëruar që të mos kthehesha më vonë nga shkolla... Dhe ja ku po kthehesha sërish

vonë. Qesha. Thonë se nuk është mirë të qeshësh në ërrësirë, por atë natë, nuk ndodhi asgjë për t'u shënuar.

Si mora diplomën dhe shumë shpejt i humba shpresat e punësimit, vendosa të merresha me bujqësi intensive. Zgjedha dy dynym tokë, për të cilën rashë dakort me nënën time; pjesën tjetër të asaj parcele, babai do ta mbillte me misër. Nëna i kishte thënë për planet e mia, por, atë ditë, babai më kishte lënë, më pak se një gjysmë dynymi, për t'u marrë me eksperimentet e mia; kështu ishte shprehur. Kur kalova nga toka, vura re me trishtim se kjo ishte e vërtetë dhe kuptova se nuk më dilte llogaria matematikore. Në fakt, unë kisha planifikuar të bëja paratë e udhëtimit për Itali, kurse tani, çdo gjë kishte marrë fund. Ndoshta babai kishte të drejtë, nuk kishte pse të më linte shumë tokë, duke parë se sa shpejt po dorëzohesha.

Duhet të kem qenë, jo më shumë se katër vjeç, kur nëna më mori me vete te puna e saj. Atë ditë do të mblidhnin qepë dhe, duke parë gratë të punonin, nisa dhe unë të shkul qepujka nga toka; për një gjysmë ore mblodha një mullar me qepë, ndoshta më ndihmoi paksa edhe toka e butë. U mblodhën të gjitha gratë dhe të mahnitura, po admironin punën time. Dikush tha se, me këtë ritëm, për dhjetë orë punë, unë mund ta realizoja normën. Më kaploi një vetëkënaqësi, saqë nisa të ëndërroja me sy hapur; pashë veten time të mbuluar nga grumbulli i qepëve, teksa nëna më kërkonte mes tyre, me karamele "Zana" në duar. Dielli e kishte kaluar mesditën, ndërsa unë po zhgërryhesha, si derrkuci në baltë, me fare pak qepujka të mbledhura. Nën talljet e shoqeve të nënës sime kuptova se sekreti i suksesit qëndronte te vazhdimësia. Vazhdimësia, koherenca apo këmbëngulja ishin ato që po më mungonin tani dhe ndoshta më kishin munguar gjithnjë.

Pa hequr dorë nga punëkërkimi, por si gjithnjë i ngecur në merimangën e pushtetit, në një moment, iu dorëzova jetës së fshatit; nuk i bëra më naze punës, derisa një ditë, ndieva për herë të parë në jetë, kënaqësinë që të jepte puna fizike. Ishim shtrirë

mbi kashtën e misrit, të ngarkuar në një zetor, teksa dikush ia nisi këngës:

*“...shkon zyzeza, n’arë me korrë,
merr dy drapna, per nen dorë,
njanin mbledh e tjetrin korrë...”*

Në të gjithë fushën, nuk kishte asnjë syzezë për be, por ndjesia që provova, teksa dëgjoja sërish këtë këngë të nënës sime, gërshetuar kjo me rehatinë e kashtës nën shpinën e lodhur, megjithëse nuk ishte fantastike, ishte çliruese dhe, për një çast, bënë të mos dëshiroja të isha diku tjetër. Ndodhi vetëm një çast, por mjaftueshëm për të kuptuar enigmën e të qenit fermer i lumtur. Disa ditë më vonë ndihmova në hedhjen e një solete betoni. Sërish u lodha e sërish u ndieva mirë; askush nga ne nuk mori shpërblim, ndonëse u frymë me raki, derisa filluam të këndonim bejte, të trilluara aty për aty. Pothuaj u ambientova me jetën e fshatit, por prapë dimri nuk të ofronte asgjë tjetër, veç lojës me letra dhe shisheve me alkool.

Ajo që do të ndodhte më pas e prishi monotoninë dhe e shkatërroi plogështinë time. Im atë, pas disa tentativave të dështuara në biznese bujqësie apo sipërmarrje tregtie, papritur, na telefonoi nga Italia. Ai, ndryshe nga unë, e kishte të vështirë të pranonte dështimin. Ikja e tij qe sa e papritur, aq edhe tronditëse. Na kishte lënë një magazine, me disa mollë të kalbura dhe disa mjete të amortizuara, të cilën, e gjetëm të shpërthyer pas disa ditësh; vetëm motori i çmontuar i një “Fiat”-i 130 të tim eti, ishte një mungesë që mund të vlente diçka. Gjatë atyre ditëve i shpeshtova udhëtimet për Tiranë dhe takimet me deputetë, andaj rrallë ndodhesha në shtëpi; takova edhe liderin e dhjetorit, por e pashë të hutuar. Atëbotë, s’kisha si t’i dija problemet e tij, megjithëse më ngeli në mendje pyetja e oficerit të sigurisë për emrin tim. Kur i thashë se nuk isha shumë i njohur dhe emri im, nuk do t’i thoshte asgjë, ai më zhbiroi me sy, duke më thënë se

emri fliste shumë. Ia thashë emrin tim, emër tipik katolik, për të dëgjuar më pas komentin e tij se, me këtë emër, nuk kisha gjë në vijë. Kurse takimi me shokun e dhjetorit, më la një përshtypje të kundërt.

Kur u ktheva në shtëpi, më thanë se i kishte vizituar një hetues. Ai, ose do të vinte përsëri, ose do të më priste në prokurori. Të nesërmen dola në Lezhë dhe dhashë shpjegime në hetuesi, për magazinën dhe për humbjen e motorit të “Fiat”-it. Në gazeta lexova se ishte kapur “mafia e Zadrimës”. Aty ishin edhe emrat e dy bashkëfshatarëve të mi. Po atë darkë, më ftoi për kafe një shok fëmijërie, pikërisht ai i historisë me trikon e “humbur” te kanali. Për një orë të tërë i erdhi rrotull kuvendit dhe nuk po hynte dot në temë; vetëm kur po ktheheshim për në shtëpitë tona, mori guxim të më thoshte të vërtetën. Ai na qenkësh pjesë e grupit, që ndër të tjera, kishte marrë edhe motorin e “Fiat”-it tonë.

- Pse nuk m’thé qysh dje?

- Nuk e pata t’letë, - ai po shikonte majat e këpucëve të veta. - Ka ndodhë gjâ sot?

- Po... isha në prokurori.

- Báne denoncim?

- E pse t’mos e bájsha? Idiot i dreqit, t’m’kishe thânë qysh dje.

- ...

- Por ata e kishin dosjen plot me akuza të tjera.

- Asnjena nuk shkon në gjykatë... natyrisht që njena po; avokati na këshillon të shkojë motori i “Fiat”-it.

- Jo ore... - ia kisha ngulur sytë dhe po e studioja si kavië. Ky dredharak i vogël ia kishte dalë të shpëtonte gjithnjë; nuk bënte kurrë hapa të pamatur, e kishte kapur mjaft mirë thelbin e kësaj shoqërie të kalbur. Nuk më vinte keq fare për atë palo motor, por ndieja dhimbje për faktin që, në sytë e mi, po shkërrmoqej figura e shumë shokëve të fëmijërisë. Nuk kisha ndonjë dëshirë që ata të dënoheshin, por që edhe t’i ndihmoja të shpëtonin, më

dukej pak si e paturpshme si kërkesë.

- Dakort, mund t'i thoni avokatit të procedojë.

- Si do t'ja bájsh?

- Ate e di un.

- Shiko, se mos na bán ndonji shaka t'hidhun, - tashmë i kishte rënë maska e fajtorit të penduar.

- T'u ngjallen morrat e... - ika pa i thënë as natën e mirë, ndonëse ai kishte ngelur si hu në mes të rrugës. - Ik e fli rehat; nse ju e bátë një gabim, un s'do t'báj t'dytin.

Gjyqi ishte një parodi e rëndomtë; hera e parë që hyja në atë sallë dhe besoja se do të ishte e fundit. Gjyqtari më sulmoi që në fillim, por nuk më kapi dot në logjikën e alibisë sime. Më në fund turfulloi, duke më akuzuar se i paskam lënë, kot më kot, të pandehurit në burg. Iu përgjigja se, “mafia e Zadrimës”, nuk mund ta fitonte atë cilësim, vetëm duke vjedhur një motor gjysmë të prishur. Ndryshe nga parashikimi, gjyqi mbaroi që në atë seancë; ata u dënuan me periudhën e paraburgimit, plus një javë. Si dolëm nga salla, një ish-i dënuar, gjysmëanalfabet, duke dashur të më jepte leksione juridike, më akuzoi se atë javë plus e morën prej meje. Nuk i ktheva përgjigje, por ndalova me avokatin; ky i fundit më komplimentoi që iu kisha shpëtuar kurtheve të gjyqtarit, i cili nëpërmjet meje, kishte dashur të rriste paksa hisen e tij, duke i shtuar grupit një bashkëpunëtor dhe burgut një mysafir të përkohshëm.

Kisha kërkuar të punoja në polici jo se kisha ndonjë qejf të madh, por, vetëm e vetëm, ngaqë koha nuk të ofronte shumë mundësi dhe se policia e qarkullimit rrugor ishte bërë një oaz shkretëtire për inxhinierët mekanikë. Një nga kushtet e kontratës që kisha nënshkruar kur lashë shkollën “Skënderbej” për të hyrë në Universitetin Politeknik, kishte qenë edhe detyrimi për të punuar gjithnjë në radhët e ushtrisë; por, ata e kishin shkelur vetë kontratën, duke më ndërprerë bursën që në vitin e tretë. Tashmë isha i lirë, por s'dija se ç'të bëja me lirinë time. “Kur do t'fillojsh punë?”, - më pyesnin gjithnjë bashkëfshatarët e mi, duke

më parë me dyshim nëse e kisha mbaruar vërtet shkollën e lartë. Nuk e kuptonin “të varfërit” se koha e emërimeve të sigurta, kishte përfunduar një herë e përgjithmonë. Ishte bërë pak si proverbiale, përgjigjja ime se, “...Do të filloja punë t’hânën, por jo kyt t’hâne”.

Një mbrëmje, dola pak si vonë për në lokalin e fshatit. Atje ishin tre shokët e mi “mafiozë”; dukeshin në qejf, kurse unë mora një teke konjak dhe u mbështeta mbi banak.

- Hajdë, ulu me ne.

- Jo se... nuk dò rri shumë.

- Si u bá puna e punës?

- Nga e hâna thém... - vura buzën në gaz.

- Pse, ku do fillojë punë ky? - Ishte një nga të sapoliruarit, që s’më kishte falënderuar akoma për ndihmën, kurse të më kërkonin të falur nuk e prisja më prej tyre.

- Do t’báhet polic.

- Jo ore... dashke t’báhesh spiun a?

- Due vetem, një punë.

- Po kur puna t’detyron me tradhtue shokët?

- Besoj se kam dhânë prova per kyt gjâ.

- Mos po dòn me thane se t’kena gjâ borxh?

- Jo, ket e thé ti.

- Por e mendove.

- E nse e mendova, shkà?

- Po unë t’báj mutin, mu n’shkollen tânde, - megjithëse gati katër metra larg, rakia e gotës së tij më skuqi paksa majën e fytyrës, - ...spiun i mutit.

Nuk i ktheva përgjigje; u përpoqa të fshij fytyrën, por thjesht shpërndava nxehtësi gjithandej. Nuk lëviza nga vendi, madje, desha të porosis edhe një tjetër. Kjo e acaroi akoma më tepër. Deshi të më gjuante me gotë, por nuk e lanë. E ulën me dhunë në karrige, por, sapo e humbën vigjilencën, u ngrit si ari i plagosur dhe do të më kishte qëlluar, sikur të mos ulesha në momentin e fundit. Në gishta kishte vënë një dorezë me kunj

metalikë, që e bënte dorën si një armë të ftohtë. E kapën sërish e sërish u iku nga duart; tashmë kishim dalë nga lokali dhe ai hipi mbi një zetor tip “Ford”, që e kishte marrë me kredi; ngjiti tri herë shkallët me këtë mjet, duke tentuar si i çmendur të më shkelte me gomat e tij. Dy të tjerët m’u lutën që të ikja; nuk ishte djalë i keq, thoshin, por e shfytyronte pija. Diku para një viti, së bashku me njërin nga dy të tjerët, pikërisht me atë “heroin” e trikos, e kishim mbajtur për gati njëzet minuta me fytyrë përdhe e duart pas shpine, për ta penguar që të kapte telat e korrentit me duar; në sytë e tij, pata dalluar vdekjen që gjëmonte. Kur m’u lutën sërish, u nisa me hap të lehtë drejt shtëpisë. Në fillim e dëgjoja qartë zhurmën e zetorit, që po vinte drejt meje, por, pak më vonë, ajo u venit. Po arrija te porta e jashtme, kur e dëgjova sërish kollitjen e motorit të “Ford”- it; e hapa portën dy kapakësh dhe u futa në jerevi, teksa dëgjoja i tensionuar fërfëllimën që krijohej nga fërkimi i hekurit për hekur, që tundej si lavjerrës pas derës së drunjtë. Mekanizmi që bënte mbylljen e derës ishte një krah metalik, gati një gjysmë metri i gjatë, që përfundonte me një çengel, i cili, kur mbyllej porta, futej në një kllapë metalike, në kapakun tjetër të portës.

Zgjedha sëpatën më të mprehtë dhe ngriva me të në dorë, prapa portës së jerevisë. E dëgjova kur arriti, hodha shikimin drejt hyrjes, nga një e çarë e dërrasës së derës. Kishte ndaluar para portës së hapur dhe shante e mallkonte, duke marrë frymë për hatullash, por, pa guxuar të hidhte një hap më tej; me sa duket, kishte dëgjuar krokëllimën e korbave. Dy të tjerët erdhën, thujse në të njëjtën kohë me tim atë, që doli nga brenda; ai kishte rreth një javë që ishte kthyer nga Italia. E dëgjoja bisedën e tyre, aty pas derës së jerevisë, i ngrirë, si statujë romake, me sopatën si zgjatim të gishtava të mi. Për habinë time më të madhe, ai u qetësua dhe pak më vonë ata të tre ikën. Nuk iu përgjigja as thirrjeve të tim eti; kisha rënë në të dy gjunjët dhe po qaja si fëmijë; për pak do të kisha kryer një krim; lotët më rridhnin rrëke, unë nuk isha aspak më i mirë se ata.

Atë natë vendosa të nisem. Ua thashë prindërve dhe, kësaj radhe, askush s'kishte motiv për të më kundërshtuar. Rashë të flija nën motivet e këngës:

*“A e din, moj nana jême,
se un neser shkoj?”*

Vargjet që pasojnë, nuk kanë asnjë lidhje me një djalë:

*“...lutju lutju, nana bijes,
t'rrije edhe simjet.”*

Por edhe unë po shkoja për të mos u kthyer më, përveçse “si bija në gjini”.

TOKË E SHPIRTËNVE

POSTA E SHQYPNËS

Kumbona, o nuk bjë ma, o bjë veç per veshët e mî. Tingllima e saj, âsht sa e âmel, aq edhe shkandulluese n't'njajten t'imtë; aspo, kshtu m'duket mue. Sa ma larg qî t'shkoj, aq ma shumë m'gjimon n'mâje t'krêsë e m'gurgullon n'lukth²⁰ t'pârzmit têm, zâni i ksaj kumbone.

VII

Edhe ky udhëtim po niste me tren. Ndoshta do të ishte hera e fundit që po hipja në të. Aty nga gjysma e rrugës, gjeta një vend ku të ulesha. Për habinë time të madhe, aty pashë ish-shoqen time të klasës; atë që dikur i kisha shkruar një letër. Kisha dëgjuar se ishte martuar, por kisha vite pa e parë. Në Vorë ne zbritëm, kurse ajo vazhdoi për Tiranë; akoma dëgjohej fishkëllima e shinave të trenit, kur e kuptova se nuk ndieja më asgjë për të. Mos isha bërë tip sipërfaqësor dhe i pacipë? Mos më ftohën kofshët e saj të mbuluara nga celuliti? Apo mos ndoshta po më lëshonte vendlindja, po këputeshin fijet, që më mbanin lidhur me të?! Nuk e di.

Grupi ynë nuk ishte i vetmi në atë udhëtim të dëshpëruar drejt Greqisë. Mizëria e njerëzve që kisha parë në portin e Shëngjinit, kur ishin hapur fjalë se do niseshin anije për Itali, nuk ishte asgjë para ikanakëve që pashë te piramida, pak mbi pikën kufitare të Kapshticës. Sa ra nata, u nisëm në drejtime të ndryshme. E sigurt që njëri grup do të kapej, pa bërë as dy orë rrugë; të paktën kështu na tha drejtuesi ynë, i cili po e bënte këtë rrugë për herë të shtatëmbëdhjetë. Në kufijtë e orës kritike u ndalëm. Një fener u shqua së largu dhe nuhatja e të parit të grupit parashikonte ushtarë të huaj. Nuk bënim asnjë lëvizje, edhe frymë nuk merrnim me hundë, por me gojë. Një mushkonjë u ul në faqen time, shtriu sondën, u fry me gjak e u bë kacik, ndërsa unë nuk guxoja ta vrisja. Për një çast, m'u duk se unë dhe mushkonja kishim të njëjtin fat: po të rrinim në shtëpi, ishim të pashpresë, po të lëviznim drejt ushqimit, rreziku ishte më i lartë, ngërthyer me një shpresë të vakët ngadhënjimi. Si u duk se

rreziku kaloi dhe filluan lëvizjet e para, unë ndihesha akoma në solidaritet me mushkonjën, andaj s'po e vrisja dot, por edhe ajo, me sa duket, e humbi fare vigjilencën dhe kur e godita, dora m'u mbush me gjak, si të isha çarë me thikë.

Natën e dytë kaluam përmes për një ferme me bamje. Ndërsa po i thyenim ato kallama dhe i po këpusnim ato spango, befas e ndieva veten në anën e gabuar të historisë; e kuptova mjaft mirë, se çfarë donin të thoshin grekët me fjalën “barbarë”. E përpjeta u bë më e fortë dhe unë nuk po e ruaja dot ritmin e ecjes; dy herë u ndalën për të më pritur, teksa unë merrja frymë për hatullash. E ndieja se po u bëhesha barrë, por ama nuk vrapoja dot si ata malësorë të shkathët, edhe pse, po tendosesha në limitet e mia. Ngadonjëherë, ndalonin për të pushuar, por sa arrija unë, ata niseshin përsëri. Sa arritën në majë, u dha alarmi për rrezik dhe ia dhanë një vrap të çmendur, kurse mua, m'u desh një përpjekje titanike, vetëm për të arritur majën. Me të shijuar tatëpjetën, gjunjët e mi u shtendosën dhe në gropën e parë që rashë e kuptova që ndrydha këmbën. Lëshova një “oh” të lehtë, që nuk besoj se e dëgjoji kush dhe u shtriva, me kurriz mbi tokë, duke shijuar kënaqësinë e paqes, pas më shumë se tri orëve stërmundim.

Iu dorëzova totalisht fatit tim dhe ashtu i shtrirë siç isha, nisa të numëroj yjet. Kur u ngrita, nisa të ecja ngadalë dhe duke zgjedhur rrugën, pa e vrarë mendjen për ushtri e polici, si dhe pa ndonjë pikësynim të qartë; vetëm ecja drejt lindjes. Po zbardhte dhe unë ecja në mes të arave. I kisha harruar të gjitha porosinë e shokëve, por, kur iu afrova disa shtëpive, kuptova se me qentë nuk bëhej shaka; ata duhej t'i kisha frikë, gjithsesi.

Sa lashë fshatin nisi sërish malorja, por këtë radhë e mora me qetësi. Sa ndesha në një përrua, u lava i tëri në të dhe u shtriva të shijoja rrezet e diellit. Duhet të ishte mesditë kur u zgjova nga disa zhurma. Unë isha mu në mes të lëndinës, kurse, pas pemëve, disa bashkëpatriotë të mi po diskutonin rreth meje; njëri thoshte se jam polic i veshur si civil, ndërsa një tjetër ia kthente se ia

bënte mu fakti që isha bari. Nuk desha t'i lodh më shumë, ndaj iu fola shqip, duke ju thënë se edhe unë, ikanak si ata isha. Nuk më besuan menjëherë, dyshonin gjithnjë për ndonjë hile, por, si u nisa ngadalë drejt majës, shpejt më arritën më të shkathtit prej tyre. Përsëri më shihnin pak me dyshim; nuk kishin parë ndonjëherë emigrant shqiptar dhe kaq të shëndoshë. Akoma më tepër iu shtua dyshimi kur iu thashë emrin tim katolik; si fshatarë myslimanë që ishin, nuk ishin të familjarizuar me një emër të tillë. Sa kapërcyem qafën, ndalua në një guvë për të pritur natën. Aty, tentova të rregulloj marrëdhëniet me ta, ndaj iu ndava të gjithëve nga sallami që kisha në çantë. Fillua të luanim me letra dhe disa prej tyre më mbytën me pyetje; ata po njihnin një Shqipëri tjetër, një shqiptar interesant, i cili, për ta, kishte një emër pothuajse grek.

Sa ra nata u nisëm me të shpejtë, por, fatmirësisht, këtë herë do të ecnim nëpër fushë, kështu që, ia rrita të mos ndahem nga grupi, ndonëse, në të zbardhur, nuk i ndieja fare këmbët. Nga dreka, iu ndava sërish nga sallami im; fatkeqësisht për grupin tim të parë të bashkudhëtarëve, çanta ime kishte pasur më shumë ushqime. Pasditja u bë shumë e gjatë, saqë, kur mbaruan barcaletat e mia, ata filluan të talleshin me theksin, dialektin dhe me barkun tim të rrumbullakët, i cili stononte dukshëm me trupat e tyre si cironka dhe barkun "dërrasë". Durova; nata nuk ishte larg dhe entuziazmi i tyre tallës do të binte si nga frika prej policisë, ashtu edhe nga nevoja për t'u orientuar drejt në errësirë. Kisha patur të drejtë, por vetëm përkohësisht. Në çantë më kishte mbetur fare pak ushqim, ndaj nuk e ndava me ta, por, sapo u nisëm, dikush u ofrua të më mbante çantën dhe si refuzova, një i dytë ma shkuli me forcë nga krahu. Vrapuan si të çmendur, derisa u larguan mjaftueshëm prej meje. Unë vazhdova me të njëjtin ritëm, derisa arrita te çanta e braktisur; më kishin lënë, vetëm pak sheqer.

Nata që e tmerrshme; përveç errësirës si pus, filloi të binte edhe një shi i imët, kurse balta u bë si sapun, aq sa, po të mos

mbahesha te filizat e njomë, kushedi se ku do të kisha përfunduar. Sapo dora më arrinte te maja e degës, kapja një tjetër, pa e lëshuar të parën; frika nga rrëshqitja, m'i ftohu të gjithë frikërat e tjera. Sa zbrita në xhade, vendosa të mos e lëshoja më. Autoveturat kalonin rallë e tek, por sigurisht që nuk ndalonin. Pranë një stani dëgjova të lehurat e qenëve dhe nuk guxova të vazhdoja më tutje. Një turrë prej fieri të prerë, me ca fije të palagura nga mesi i saj, më ngjau si dyshek prej leshi të kashagisur; ndonëse të lehurat e qenve, nuk më lanë të shikoj ëndrra.

Të nesërmen, përgatita pak ujë me sheqer dhe fitova energji, për të ecur sërish. Një vilë e rrethuar me rrjetë teli dhe një përrua me brigje të thepisura, më detyruan të vij rrotull për nja dy orë të mira; nga vila dëgjohehin të qeshura dhe biseda me zë të lartë, teksa koha zuri të hapej. Sa zbrita në breg të lumit, ngrita fushimin dhe, si përfundova së lari, ndera rrobat që të thahen dhe u shtriva të fle, mbi ca gurë të lëmuar e të ngrohtë. Më zgjuan ca zëra. Kësaj radhe flitej greqisht, ndaj u nisa për rrugë pa bërë zë. Nuk e lashë më xhaden; më mirë të më kapnin, sesa të kaloja ato që kalova. Makinat kalonin njëra pas tjetrës, por së kishte njeri mendjen tek unë; në darkë iu afrova Nausës. I rashë mes për mes qytetit dhe teksa po binte mbrëmja kalova pranë një bari, ku po pinin kafe disa familjarë bashkë me fëmijët e tyre. Në atë muzg me qiell të vranët, xhinset e mia të ndotura dukeshin si moderne dhe mua po më joshte jashtëzakonisht aroma e freskët e kafesë, por në xhep nuk kisha asnjë dhrahmi për be. Vazhdova rrugën, duke i premtuar vetes se një ditë do të pija kafe aty. Në të dalë të qytetit, takova ca shqiptarë. Ndihesha i lodhur dhe nuk doja të udhëtoja më natën, ndaj kërkova strehë. Më thanë të shkoja te një baxho pak më poshtë; aty banonin dy vëllezër dhe mbase më pranonin atë natë, pasi ishte e shtunë dhe pronari nuk gjendej aty. Gjeta vëllanë e vogël, i cili më pranoi pak mëdyshas. Në fakt, kishte patur të drejtë, pasi kur erdhi i madhi iu vërsul me një breshëri të sharash, saqë mua më erdhi keq dhe vendosa të dal.

- Ku shkon ti? - Një fytyrë i vinte e një i ikte. - Ti je mik te nâ dhe nuk ke si ikën; po m'fal pak, sa ta nxjerr inatin me kyt idiotin.

- Po s'e lé ket muhabet, do iki pernjimënd.

- Më fal po kanë ardhë kohë t'vshkira... shkà s'kena bá nâ shqiptarët; pastaj, kjo nuk është as shpija jonë. Po sikur t'merzitet pronari e t'mos na láje me fjetë mâ ktù?

- ...Ke hak, - i thashë dhe ula kokën. - Nuk duhet t'ju kisha bezdisë, por nuk isha i pregaditun edhe per një natë tjetër jashtë.

- ...Nga t'këna?

- Prej Lezhe... po ju?

- Kênkena t'njaj ane, prej Shkodre na ke. - Për herë të parë, pas një jave të mundimshme, po haja darkë mbi tavolinë; muhabeti na erdhi i ëmbël, saqë e vazhduam edhe të shtrirë në krevat. Ai i kishte lënë te firmat piramidale gjithë kursimet e katër viteve të mundishme në Greqi, andaj kishte marrë inat edhe me Zotin vetë. Kur unë guxova t'i thoja se nuk duhet ta humbte besimin, ai m'u vërsul:

- Nse ka Zot, pse Ai nuk u kujdes per mue? Pse nuk ma çoj një shëj, pse m'lá me gabue?

- Një shëj ta ka dhânë.

- Çfarë shëji?

- ...T'ka thânë: "mos ju lakmo fitimit t'sheptë".

Heshti e nuk u ndie më. Kur u ngrita në mëngjes, nuk e pashë në dhomë; ishte ngritur që pa gdhirë, për të rifituar paratë e humbura. Falënderova të voglin për mikpritjen dhe u nisa për rrugë, gjithnjë mbi xhade.

Kur rruga u bë me katër korsi, u shtua dhe numri i makinave. Pranë një kryqëzimi shoh një traktor pa kabinë dhe drejtuesin e tij, i cili kishte shtrirë dorën e majtë, me gishtin tregues të tendosur. Mua m'u duk se ma kishte drejtuar në ballë, pikërisht në momentin që dëgjova një sirenë policie. Dola nga rruga, zbrita nga traseja dhe ia futa vrapit, ngjitur me një parcelë nektarinash. Si bëra nja treqind metra, ndalova e pashë përreth;

askush nuk po merrej me mua. Nisa të qesh me vete, sapo e kuptova situatën; traktoristi kishte sinjalizuar me krah kthimin e tij në të majtë, ngaqë mjete i tij nuk kishte sinjale.

Pashë një pemë me fruta të pjekura dhe u ula të mbush barkun. Pak më vonë, u ngrita dhe vazhdova rrugën, mes për mes plantacionit; nga tabelat rrugore, e kisha kuptuar se isha në drejtimin e duhur. Ndalova sërish të ha nektarina; sërish e sërish, derisa m'u mpinë dhëmbët. Aty nga ora pesë pasdite sosa pikërisht aty ku po punonte djali i dajës tim. Ai fërkoj sytë i habitur, për të parë se mos ishte në ëndërr apo jo dhe nuk vonoi të më turrej plot me të shara; vetëm tani po e kuptoja shqetësimin e tij, kur kisha humbur lidhjet me grupin.

Ditën e parë që punova, rastisa me tre të panjohur; për drekë na dhanë nga dy peshq të skuqur, një pjatë me gjellë dhe një sallatë të madhe të përbashkët. Unë mbusha një lugë gjellë, mora pak sallatë dhe po përtypesha në heshtje; pastaj hëngra pak peshk dhe ngula sërish pirunin në sallatë. Kur desha të marr sallatë për të tretën herë, piruni im preku fundin; u ngrita mbi gjunj dhe pashë enën bosh.

- M'duket se e paske për herë t'parë? - një nga shokët, po buzëqeshte duke u mbllaçitur.

- Pse?

- Po ti hà njëherë kyt t'përbashkten, se gjëllen e peshkun s'ti merr kush.

- Si, si?... - pashë përreth, askush s'e kishte prekur gjëllen; të gjithë po përtyppnin copëzat e fundit të sallatës.

- E pë shkà ngjau me pronen e përbashket n'Shqipni?! - Ky koment më bëri të qesh edhe mua; ndonëse u dala shpejt, pasi desh më ngeci një halë peshku në fyt. Në darkë, kur mora tri mijë dhrahmitë, të parat para të fituara me djersë, ndieva një kënaqësi të paparë. Te benzinata, pranë Janica-s, bleva një franxhollë të gjatë dhe dy kuti të vogla, njërën me gjalpë e tjetrën me çokollatë "merenda". Sa e kisha ngjyer njërën fetë edhe me gjalpë "vitam" edhe me nukrema, kur ia behu një polic me pistoletë në dorë

dhe të gjithë ia dhanë vrapit. Unë po përgatitesha për kafshatën e parë, ndaj nuk lëviza fare. Ishte sezoni i punëve në bujqësi, ndaj policët, zor se kapnin njeri për ta kthyer matanë kufirit.

- Mango ise esi? (*Garip je ti* - në greqisht) - Polici ishte i dehur.

- Mango me merenda, - iu përgjigja, duke shtrydhur të gjitha njohuritë e mia mbi greqishten. Polici qeshi, qëlloi nja dytri herë përpjetë dhe u largua i kënaqur.

Ditën e pesëmbëdhjetë bleva një palë rroba të reja dhe një biletë autobusi; në darkë, isha në Athinë. Biletën e tragetit për në Kretë e preva lehtësisht, por në anije nuk hipa dot; kjo edhe për fajin tim, pasi prita të hipja bashkë me patriotët të tjerë; po të kisha pak më tepër besim te vetja, do t'ia kisha dalë. Tek agjencia, më kthyen vetëm gjysmën e çmimit të biletës; në Pire nuk njihja njeri, kurse kushëriri im, numrin e të cilit kisha në xhep, jetonte në Kretë. Po vija kot vërdallë në port, kur njoha dikënd. Ai kërkonte të m'i merrte të njëzet mijë dhrahmitë e fundit, por duke më premtuar se do të më çonte në destinacion. Pas një mëdyshjeje të vogël pranova. Ai na futi në një kamion me pleh bagëtish, mua bashkë me katër të tjerë, duke na dhënë vetëm nga një pagure me ujë. Pas dy orësh, uji kishte mbaruar dhe mushamaja e kamionit po na i nxirrte djersët me çurka; dy nga ne, zbritëm në kërkim të ujit. Sapo zbrita në dyshemenë e tragetit, pashë ujin të rrëshqiste në një drejtim; u nisa të zbuloj burimin, mirëpo, uji ndryshoi drejtim; ai ishte thjesht ujë deti, që ndryshonte drejtim sipas lëkundjeve të anijes. U trishtuam. Hipëm sërish në kamion, por ndërkohë na kishin pikasur.

Në Kretë, pashë vetëm një rajon policie, një gjykatë dhe disa vende paraburgimi. Në atë burg ku na çuan, shqiptarët, grekët dhe rumunët kishin nga një ekip futbollit. Ndeshjen e parë e fitonin gjithnjë rumunët, për t'ua lënë pastaj finalen grekëve barkderra; shqiptarët tërboheshin nga inati, por ditën tjetër humbnin sërish me rumunët. Atje mësova se rumanishtja dhe shqipja kishin plot fjalë të përbashkëta, ndoshta të gjitha ishin

turke.

Pas dhjetë ditësh, sërish në Kapshticë; as që e mendoja kthimin në shtëpi, ndaj u nisa prap. Kësaj radhe pata fat, rashë në grup të mirë, por edhe përvojë kisha fituar, shto këtu edhe afro dhjetë kile dhjamë që i kisha lënë rrugës. Në kufi u ndeshëm me “mafien me maska” që pastronte xhepat e shtegtarëve; unë nuk kisha as astar, andaj po më qeshej. I maskuari më kërkoi të ngrihesha në këmbë. Unë po qeshja, sepse dikush që po nxirrte paratë për t’ia dhënë “mafies”, po i nxirrte nga aty ku nuk kishte “qen kufiri” që t’i gjente; kishte harxhuar nja dy orë të mira, për t’i qepur rrëzë tegelit të xhinseve, kurse tani, po na lodhte edhe ne duke e pritur. Qeshi edhe fytyra poshtë maskës, nëse ishte fytyrë.

Kësaj radhe u nisa për në Katerini; kaluam rrëzë Olimpiti dhe nuk e kuptuam. Në një fshat aty afër, në Katojan, jeta ishte më e lirë dhe pasditeve kishim luksin të shijonim dhe nga një birrë, apo raki me xaxiq e qofte. Një tropojan, një ditë, u ul të pinte me mua. Ishte hera e parë që hynte në atë lokal; “Dua të më kapë policia, - më tha, - të kursej paratë e biletës, pasi më duhet të kthehem në shtëpi.” Si i harxhoi gjysmën e lekëve të biletës, e kuptoi se ishte e kotë; policia nuk ishte në sezonin e “fshesës”. “Duhet të pish me ndonjë tjetër, - i thashë, - pasi unë kam qimen e derrit e nuk më kap njeri.” Në një rast tjetër, një polic erdhi të na nxirte nga shtëpia ku rrinim; ishte ankuar komshiu, pasi shiu kishte shpërthyer aromën e disa tophave të verdhë, mbjellë andej-këtej kopshtit. Mbajtëm orenditë tona dhe i hodhëm jashtë shtëpisë, kurse rrugën e parafundit nuk u ktheva; ndenja në ullishte për nja dy orë, para se të kuptoja se nuk kishte asnjë rrezik. E pashë sërish atë policin të nesërmen në darkë; më pyeti pse kisha ikur të djeshmen, heshta. Për të thoshin se kishte qenë tmerri i shqiptarëve; i ndiqte emigrantët fushave, si qen gjuetie, derisa i lodhte si kuajt e egër; kjo, derisa kishte thyer këmbën në një ndjekje të tillë. Edhe me këmbë të thyer e kishte çuar emigrantin e “paligjshëm” në rajon, kurse të nesërmen shefat e

kishin liruar. Që atë ditë, nuk kapte më asnjë shqiptar, ndaj dhe unë u ndieva në faj me të.

Për në Kretë, u nisa me avion. Bleva një gazetë angleze dhe një shishe të vogël me “whisky”, por sërish stjuardesa më foli greqisht. Nuk pranova të pija gjë tjetër, vetëm e vetëm se nuk dija t'i shqiptoja saktë emrat e pijeve në greqisht. Në Agia Pelagia arrita me taksi. Kushëriri u habit kur më pa; një natë më parë i kisha telefonuar nga Katerini, kurse tani isha përpara supermarket “*Vasilis*”. Me pronarin e këtij supermarketi, pata një histori interesante. Gjatë ditëve që isha pa punë, vija shpesh këtu; shikoja gazetatat italiane dhe angleze, të dielave edhe atë holandeze; te kjo e fundit shikoja vetëm pikët e Ajaksit në futboll; merrja gazetën shqiptare “*Koha Jonë*” dhe një italiane, ose një anglo-amerikane, paguaja dhe ikja. Një ditë, duhet të ishte fundi i sezonit turistik dhe kishte pak njerëz rrotull, mora një bukë, një palë mbathje e një prerëse thonjsh dhe u drejtova tek arkëtarja, që më thotë:

- Vetëm një palë mbathje?

- Epo... një palë të ndenjura kam. - Qeshëm të dy, kurse pronari, duke treguar me gisht prerësen e thonjve, më kthehet:

- Edhe këtë do ta paguash?

- Pse, këto i ke falas?

- Eja me mua! - më tha dhe më kapi nga krahu dhe u ulëm në bar-kafenë përballë.

- Mos bëra diçka që s'duhet? - Po ndihesha, pak në siklet.

- Oh, të më falësh, thjesht kam dëshirë t'ju qeras... A e di ti se unë kam dy muaj që të ruaj? Dyshoja se ishe hajdut, por kur ju pashë duke paguar edhe prerësen... Vërtet i dini gjithë ato gjuhë të huaja?

- Po... - vura buzën në gaz, pasi në anglisht isha i sigurt vetëm për leximin; italishten e kuptoja, si çdo bregdetar i Shqipërisë; sa për gjuhën e tulipanëve, as që e dija “ku binte me shtëpi”.

- Dhe vjen e punon këtu si punëtor me mëditje?

- Më mungon diçka edhe mua!
- Çfarë?
- Shteti.

Qeshi hidhur dhe u ndamë; duke u përshëndetur më kujtoi që, po të kisha nevojë për ndonjë gjë, të mos e kurseja.

Më në fund, jeta nisi të më buzëqeshte sërish. Si nuk më kishte thënë njeri se kjo jetë ishte një lojë e madhe?! Thjesht duhet të ishe fitues.

TOK E SHPIRTËNVE

Kumbona kish rá me kohë e vakth, edhe shpirtnat kjenë mblëdhë si kokrrat n'dardhë. Kish nisë me zbardhë, po fjala s'kish t'sosun⁻²¹.

- E shkà se nuk shkruhet mâ.
- Ti Lahutë e ke kollaj, ty t'dijnë permëndsh.
- E pse m'dijnë?
- Dòn me thanë se stili yt...?
- Jo jo, nuk âsht veç punë stili.
- E pse at'here?

- Se gjuha jonë, âsht gjuhë perendish. A nuk ndertuen standard gjuhe, edhe grekët e vjeter edhe latinët; ku janë sod kto gjuhë, perveçse n'muzena?! Gjuhen tonë e flûtshin si ushtari romak, ashtu edhe bariu n'rrethina t'Atinës.

- Po, por sod shqipja flitet n'universitete, shkruhet n'fletore, n'zyre...

- Standardi? Ai u duhet shqiptarvet n'rrogen e qytetnîmit.
- Po gjuha jonë, si do t'gjalloje?
- Si gjithmonë e jetës... n'gojë t'barijve e t'perdâsve t'tâmlit n'per rrethina.

- S'po na kndon kush mâ n'per shkolla.
- Nâ jena shkolla e kathedra e gegnishtes.
- Mbase ke t'drejtë, o Mriz Zanash, porse... standardi me nê, mund t'bâhet ma i dlirë.

- Po Ândrra e Jetës... per të, per të, luftojmë ne!

- Po kjo s'është luftë, kjo është zbÿthje...
 - Jo, o Gramatikë e Shqipës...
 - Mos m'thirr njashtu, gramatika jême asht zhÿtë n'terr.
- M'bzâj ma mirë, Rrethimi i Qytetit
- E shka e ndânë terrin e sjell driten?
 - T'presim Diellin, a?
 - Edhe Prândoeren.
 - Po, por...
 - Jo po, ndoshta ...
 - Aspo...?

Ky tubim nuk kish t'sosun; s'kish bá vaki ma parë, qì me zbritë e ata ende te çinari. U mblodhen hijet e u frynë bulshijve; u nçue 'i rê e kremtë pjuhnì, qì u suell tri herë rrokull drunit jetik²² e masandej, u mbshtuell si balonë, per me bâjtë shpirtnat drejt stroflles s'arushës. Tue terthorzue²³ dromin e automobilve, Poema e Mjerimit qiti kryet prej tymnajës. Një katerrotsh i zi po shkyente rênë e pjuhnit, me turr t'madh e pa ja dá. Mbrênda automobilit, Skriba²⁴ i Famshem i Epirit, me grue t'ti.

- Isë, a e pe?
- Çfarë të shoh?
- Aty lart, nën retë e pluhurit.
- Nën pluhur ka pluhur dhe poshtë tij, kaluam ne.
- Të lutem, mos më thuaj që nuk e pe.
- Nëse e pe, e ke parë me sytë e mendjes...
- Po ti, me çfarë sysh e pe?
- Unë e pashë me sytë e dashurisë, që më ra në kokë për ty.
- Isë thuaj të vërtetën, të paktën një herë.
- E vërteta është se shpenzua më kot, një pasdite të tërë, duke duruar tangërllëkun e një frati të marrë, që po na shpotiste me prepotencë perëndie.
- Isë... o Isë...

T'mbrërmen te Sukat e Buta t' Breshkës, Kreshhta e Nâltë u lshoi hijen e ata ju skapulluen⁻²⁵ rêsë s'pjuhnit. Xunë të pluskojnë m'njè rrké t'krîtë⁻²⁶, qì terthorizonte prej s'nâlti; kurrkush s'bzâte⁻²⁷, te tanë kqyrshin kah Lahuta e Malcis.

- *Shkà t'thá mendja, o Lul i Vocerr?*
- *Deshta me e pá.*
- *...Po Ai... a t'pá Ty?*
- *Jo, thâm...*
- *Thue? ...Ai s'lypet me t'pá, as Ty e as kurnjà Nesh.*
- *Po Ai ...*
- *Posaçe⁻²⁸ Ai.*
- *Hem...*
- *A i ke pá Shtyllat e Herkulit?*
- *Po... n'ândrrat e mîja.*
- *Porse ato, kurr s'e shofin njana-tjetren.*
- *...E tash?*
- *Tash... nisena per n'Rrmajë⁻²⁹ t'Shkodrës s'lashtë.*

VIII

U ktheva pas dy vitesh. Vëllezërit ishin rritur, më i vogli po bëhej gati për mbrëmjen e maturës. U ndieva keq, ishin rritur papritur dhe pa më pasur mua pranë. Vetëm dy javë ndenja në shtëpinë e tim eti. Një tjetër djalë dajë imi ia kishte dalë të bëhej ushtarak dhe kishte një dhomë te Pallati i Oficerave; ishim rritur bashkë, e ndamë edhe këtë dhomë bashkë. Një natë e kemi zbardhur, duke debatuar mbi një temë filozofike; ai thoshte se, shija e limonit ishte në mes të së ëmblës dhe së kripurës, kurse unë këmbëngulja se këto tri shije formonin një trekëndësh barabrinjës. Aty nga ora pesë e mengjesit, me konsensus, vendosëm se ato formonin një trekëndësh dybrinjëshëm.

Vite më vonë, dola të pi një kafe me motrën time të vogël; ajo ishte martuar tashmë dhe të dy shkonim rrallë e më rrallë në Blinisht. Biseda sillet rreth shtëpisë së vjetër, asaj ku kemi lindur; ajo do që të shembet, kurse unë jo. Vëllaçkoja i vogël, i cili jeton në Itali, ka kursyer ca lireta dhe ata duan të ndërtojnë një shtëpi të re. Motrën time, duket se e trishton e shkuara, kurse mua edhe më keq, ajo më ka kapur për këmbë dhe nuk shkëputem dot prej saj. Fjala nxjerr fjalën dhe mua më kujtohet ajo pjesëz fjalie që pata kapur rrëshqitazi nga biseda e nënës sime në qoshk. *“Ata që kanë jetue para nesh, n’kyt shpî...”*, pat thënë ajo, ndërsa sot, motra ime e vogël më shpjegon se po fliste për gjyshin dhe gjyshen, për ata, që kishin rritur tim atë. Ne kemi patur edhe një motër të madhe, e cila, nuk jetoi dot më shumë se tre muaj; asnjë foto nuk kemi prej saj. Kur erdha unë në këtë jetë, ajo kishte ikur; nëse jeton akoma, ajo jeton, vetëm në kujtimet e nënës sonë. Edhe atë ditë, në qoshk, ikjen e saj po qante; kishte fajësuar shtriga e

magjistrice, por edhe: “...Ata që kishin jetue para nesh, n'at shpi”. Kur e pyeta motrën se ç'donte të thoshte me këtë gjë, mësova një të vërtetë shokuese.

Gjyshja na paskësh pasë lindur një fëmijë, por vetëm gjashtë muaj pas martesë; gjyshi ishte tërbuar, por nusen nuk e ktheu. Atë fëmijë, gjininë e të cilit nuk e përmendte askush, e kishin lënë pa gjë. Të qarat e tij kishin cimbisur deri “veshët” e Zotit vetë, por, mesa duket, jo aq sa për të sfumuar të ashtuquajturën “shoqëri e nderit”, që ia kishte ngrirë zemrën gjyshit dhe ia kishte mbyllur gojën gjyshes. Vdekja e tij kishte mbjellë trishtim, trishtim që e zbuti vetëm birësimit i tim eti, pasi Zoti nuk u çoi më fëmijë biologjikë. Ja pse ishte çmendur ajo e shkreta, ja pse kishte ikur, edhe ai bashkë me të; kishin shkuar të jepnin llogari së bashku. Ja pse jeta ime kishte qenë si një sfidë ndaj vdekjes; ja pse unë nuk ndihesha edhe aq, si i kësaj bote. Sa shumë duhet të jenë lutur për mua, derisa Zoti iu çoi një dhuratë të brishtë, si puna ime. Duhet të kenë qenë fare, po fare minimalistë në kërkesa. Ja pse më shihnin gjithnjë me frikë në sy, sidomos pleqtë dhe sidomos, pas vdekjes së fëmijës së parë të prindërve të mi.

Vetëm unë nuk e paskam ditur këtë histori; ndoshta ngaqë iu largohesha gjithnjë këtyre bisedave, apo mos ndoshta ngaqë kanë dashur të më mbrojnë, duke e ditur ndjeshmërinë time. A më kishin mbrojtur vallë? Ndieva një lëmsh lotësh në fyt, as zëri nuk po më dilte. U ngrita të paguaja kafet, por nuk e prita dot kusurin; lotët më kishin tradhtuar. Qaja për motrën time uloke; qaja për motrën që s'e njoha kurrë; qaja për atë fëmijë të shkretë, që vdiq në djep nga uria; qaja për gjyshërit që e rritën tim atë dhe që u larguan nga kjo botë së bashku; qaja për gjyshin e gjyshen tjetër, të vrarë nga “miku”; qaja për veten time; qaja për gjitha viktimat e moralit të sëmurë. Që nga ai moment, në zemrën time, e kishte të vështirë të hidhte rrënjë urrejtja:

“...Avytu njëri!

*Nga palci i urrejtjes due me dâlë,
si bima prej fare n' prândverë”*

PJESA E DYTË

Un s'i vras gjarpnajtë, un flas me të!
Skeptiku.

Alban N u ndal kah fundi i shetitores s'kambsorvet; kish pá 'i leter t'zverdhëme, t'vëndueme në një xham dritorje, qi shpresonte t'ish kumtim qiraje. Ish tue kërkue një garsonierë, aspo ndonjë hÿmje t'vogel. U afrue kadalë; një grue qi s'ja percaktonte dot moshen, po lánate dò tesha ngovatë. Prej mbrapa, me duer e flokë permbi tesha, ajo dukej mjaft e kolme; me një palë tûta me lastik e një triko t'gjânë, qi ja zbulonte pak lugun e fundshpinës. E pershndeti dy herë, per me e bá qi t'çonte kryet; flokët e lshuem i ki'n rá mbi ballë, prej kah e pâne dy sy t'njomsuem, por tânë nerv.

- Shkà dreqin dòn? - kurrnja nuk t'ftonte me ndëjë aty, por ai nuk luejti vëndit.

- Jam tue dvetë, per t'lajmuemt ndritore. - Ajo fshiu doren per tûta e ju dha një t'shtyme mbrapa flokve t'drejtë e t'artë per kah boja.

- A e ke me gjithë mënd, a?

- Zojë, aspo mendon se kam vakth me u tallë?

- Ku dreqin e shef Zojen?! - Vrazhdësinë nuk ja trette barku, asaj nimfe t'dorzueme para vakthit. Gjaku e shtynte n'blasfemi, ndonse sÿtë e saj, t'shifshin tânë shpresë.

- Kisha dashtë, me e pá oden?

- A i ke sÿtë n'ballë... n'mos kjofsh tue u tallë? - Ajo, me sa duket, kish pá veshen e tì, t'ritë dhe hijen q'i kish rá, m'at buzmrâmje.

- Hajde e shife, veç... - e ndali fjalën e çoi pak trikon, per me xjerrë 'i gjalmë, n'tcillin kish lidhë çilsin e derës.

Oda, dukej qysh perjashta se ish pa orendi, me suva t'ráme,

lagshtëinë e dritore t'kalbuna, por i pelqyen ato shkallë t'gúrta, që t'prijsin drejt një dere druni, t'lodhun prej shînave e moteve. Brava kerciti áthshem, thue se kish kohë pa rá n'at ngasje. Kur hyni mbrëndë, e vetmja gjâ që ja ngrohu sýnin ish hapsina; njatý mund t'vendonte libertoren e vogel, q'i kish mbetë e shperdâme n'per valixhe; kish vënd edhe per soben, 'i vrimë aspirimi ish mshëlë perdhûnshem me dò shuqe letrash.

- A po ikë tash, se mjaft punë kam? - Tjetra e kish kuptue keq hutimin e tí.

- Do ta marr... veç due me bá do meremete; per një mot, nuk t'nâp qira.

- Shkà dreqin dòn me bá me qiranë e një motit? ...Gjashtë muej e kurrnjâ ma teper... edhe n'kjòftë se m'kândet, ajo që dò t'bájsh.

- ...U bá, - e dinte se ish tue u ngûtë, por t'trishtuemt e asaj mbasditje nuk po e lénte me bá pazar; me t'vetmem rreze drite, që ndoshta kish pak mundsí, me e mbâjtë lidhë me njëkýt qytet.

E goditi at odë per marak; vuni derë e dritore t'reja, e sherbetisi n'bojë t'mjaltës; rraplloi nder valixhe dhe e mbushi libertoren, cyt e m'cyt me libra. Diten q'i futi mbrëndë orenditë, e ndihmuen pronarja me t'birin.

- E ke bá si n'London t'Ingilizit, - grueja kish mbetë e mrekuellueme.

- A i kam hallall gjashtë muejtë e qirasë?

- Besa po...

- ... A ban me t'dvetë dishka? Pse veç njëkjo odë e ka deren perjashta? - Grueja hodhi sytë mbrapa; një plak i krrusun ish tue goditë një kosh me thupra shelnash.

- Kadalë brë lum dashamiri, pse veç qiraxhi je! - Albani e kuptoi se s'mújke me e cytë ma tej at kuvend.

Nuk e pá ma at grue per tânë javen, kurse plakun e shifte perditë t'Zotit me at koshin e tí, t'goditun pergjýsë. Albani rrínte tânë masditen tue kndue nder libra, kurse n'mbrâmjet vonë i

pelqyeke me dalë n'shetí. Kur mbrrinte n'qoshe t'pallatit, bash n'jatý ku rruga kthente 90 gradë, shifte n'bisht t'sýnit, tânë shpresë e dishirë, se mos tue ardhë rruges tjeter do t'ndeshte atë... atë qì ja kish ânda me ndëshë. Por, medet, per tre muej me radhë nuk e pati at fat; pá veç pllakat e lagûna t'çarshisë, ku shiu i kish lá krejt shëjet. Edhe e frigonte, edhe e donte takimin me të; porse malli ish ma i fortë se drôja.

Fort në vona, i vinte kândja me hjedhë dò rreshta n'leter; shkruente e shkruente, per me i tretë masandej te tana n'zjarm t'sobës. I dukej se s'kish muejtë me e qitë n'leter tânë at trazim, q'i vlonte n'zëmer. Her herë ju dukte se ish tue bá një krim; ato ndíesina i'n⁻³⁰ t'tijat e kurrkush tjeter s'kish tager me i zblue. Me ksísoj ândrrash e mbrrinte nâdja; mshtjellë n'batanije e me krye n'jastek, kah soba e fikun e bánte me e mledhë kâmben n'gji.

Kish dò ditë, qì s'ju bánte me dalë; i bzânte plakut per me i prú dru t'preme, t'cillat grueja i rendonte t'shinjueme, m'nji defter shkolluer t'djalit t'saj. Plakut nuk i ndígiohej kurr zâni, saqì, pati fillue me mëndue se mos ndoshta ish i pagojë.

- Ma bán hallall, per mundimin!

- ... plaku, veç tundi pak kryet, si me dashtë me i thánë sesa pak rândsi kish gjâja.

- A bán me t'dvetë... shkà t'lidhë ty me njëkyt grue?

- Ajo âsht... grueja jême, - ma n'fund ja ndígioi zânin; ish një zâ i hollë, por edhe i ashper n't'njajten kohë.

- Por a nuk... ? - S'pati zâ, me e çue dvetjen deri n'fund.

- Dòn me thánë se âsht shumë ma e re se un?

- Jo, por... - prap, i ngeci fjala n'fyty. Plaku vuni buzën n'gaz e tue perftue prej hutimit t'ti, duel pa e pershndëtë; kish folë sa per një mot.

E kish harrue krejt plakun; kah ish tue kerkue punë, n'per zyre t'komunes, por ju kujtue beftas, tue pí kafe me dò miq.

- Pse, mor vlla, a s'ë din storen e tij, a?

- Jo, per besë!

Gruen e shpîsë, e ki'n pàsë dhunue pesë mashkuj t'çakerdisun e... bashk me tà, kish qillue edhe plaku; e kish marrë gruen te shpîja e tij, ja kish mshí lott me shami e kish dashtë me i dhânë me hânger... Por grueja, sa e kish marrë vëdin, e pati paditë dhe plaku i báni tre mote t'mira n'burg, kish dalë sish, veç me t'zhvilluemet e '97-es. Djali kish lé fiks nândë muej pas dhunimit t'saj, por askush s'mûjtke me thânë nse ish i biri i plakut aspo³¹. Shpîja ish e plakut, por kur duel prej burgu, ajo grue s'deshti me e lánë mbrëndë. Nderhyne do pleq e plakut i lshuen një odë, t'cilles i pâten çilë një derë, qi t'qitke drejt e n'oborr.

Albanin e xunë t'dridhunat; ai po rrînte, bash te oda e plakut.

- Po tash... a janë ndreqë, n'mes vëdit?

- U bá se bep djali, ai e futi plakun mbrëndë.

- A thue se flejnë bashkë... m'nji krevat?

- Se mos u kam hý mbrëndë, ti duhet ta dîjsh ma mirë.

- Un... s'di kurrsend; porse... seç i kam ndie dò t'rropatme.

- Ato t'sodit s'janë kurrjâ, me e pasë pá si e rrihte plakun n'shplaksë t'teshave; i ásht ndie vaji, deri n'mahallë t'siperme.

- Po pse e duron plaku? Pse s'e paditë, apo t'i hape gjygi? K'e fundit, ajo shpî ásht e tina.

- E kush mâ, plaku? Ai s'ásht i zoti me mbytë një mizë... me at zêmer t'butë qi m'ka.

- Po djali?

- Prej tì ásht tue i pá plaku dò ditë t'bardha.

Mbrîni n'shpî, tue fólë me vëdi; *"ku paske thye kâmben e hî"*, i tha vedja. Ish vonë e s'pa kurrkënd n'oborr; híni mbrendë pa u ndie e nuk e ndezi as soben; deshti me fjetë, po gjumi s'e merrte. U ngrit si orrli, njaty kah mesnata, ndezi driten e soben, hapi një matare me raki kumbllë e i rrumbllloi një dy gota. Rakia, n'vend qi t'ia shuente, ia shtoi edhe ma zi kacabujt. Mori dò letra e ia nisi me zhgarravitë n'to.

E dija se isha vonë. Kur u nisa mora tangencialen, meqë ishte ora dymbëdhjetë e natës dhe nuk duhet të kishte shumë trafik. U vonova, pse doja të mbaroja punë patjetër sonte; doja t'iu bëja një surprizë, gruas sime të bukur dhe prindërve të mi të dashur.

Dalja e autostradës ishte e bllokuar, po kryheshin punime; ose duhet të kthehesha, duke u vonuar akoma më shumë, ose të provoja fatin në sensin e kundërt; fitoi padurimi për të takuar të dashurit e mi.

Nuk e di kë pashë më përpara, dritat e makinës përballë, apo degët e pemëve në pyllin ku po fluturoja. I mbështetur për trung, me makinën sipër kokës, nuk po ndieja asgjë, ndonëse e dija se nuk kisha shumë kohë. Pashë përreth; nuk kisha shumë mundësi zgjedhjeje dhe koha po mbaronte; u hodha, pa u menduar gjatë, në të parën...

Ksaj here, nuk e shkyu letren; e vuni dikù n'shkrëth⁻³² e u kthye prap te gota e rakisë. Nuk mendonte se kjë shtye prej stores s'plakut, veçse per një gjâ ish i bindun: kjo nuk ish jeta e ti; ndíhej ma mirë kur shkruente per të tjerët. E mori edhe 'i herë ndorë, at copën e letres; as e shkyu, as pati durim me e ripá; i lá te tana, per një herë tjetër. Tek ma e vona, gjeti qetí edhe e xuni gjumi.

E nesermja kjë e vrullshme e t'kujtuemt⁻³³ e një nate ma parë ju davarit, n'tollovinë e ndeshtrashave⁻³⁴ qì pàti. Nji grup italyansh ki'n nevojë per guidë dhe ai, s'kish pse ja pritonte. Si u njëten n'kala, báne dò syreta e zbritne n'rrugë t'Kallmetit. Kaluen per nen kishen, ku kjë mbâjtë Kuvendi i Arbnit. Deshti me i njëjtë edhe te ujët e Sh'Misë⁻³⁵, por ata i kish marrë ûja dhe u ndalen, veç te "Mrizi i Zanave".

- Çështë ky emër; "Mrizi i Zanave"?

- Æsht titullimi i dò poezive lirike, qì pati qitë Poeti ynë Kombtar.

- Si quhet ai?

- Gjergj Fishta.

- Giorgio Ficsta?

- Jo Ficsta, por Fishta; shruej: fish-ta, me "fish" si n'inglizçe.

- Aha, e kuptova Fiss... - italianka e bukur e kish t'vshtirë me ja shqiptue êmnin.

- Lirika shkruante ai?

- Ai i shkruete t'tana, por permbi gjithshkâfen ai i kndoke shpirtit t'Kombit. Para Tì nâ s'ë dijshim se kena Komb; Ai na dhá sy me e pá; Ai na báni me u ndíe n'krení; Ai âsht shpirti edhe zêmra e Kombit Shqiptar; Ai âsht ma i madh edhe se Dante Aligeri.

- Oh jo, Dante Aligeri është i paarritshëm.

- Ai ja ka kalue.

- Përse mendon kështu?

- Dantja juej leçitet sot, pse gjuha e tij asht bá italyançja modern, kurse gjuhen e Gjergj Fishtës e pàten denue me dëkë

e Ai prap kndohet. Librat ia dogjen, kocat ia treten nen Urë t'Bunës, po êmnin s'mund ja vranë, as kangen. Kangët e Tì, hallku i dîtke permëndsh; njerëz qi s'dijnë as shkrim, as kndim, ruejnë n'memorje t'tyne, dy mijë edhe ka 'i herë tri mijë vargje t'Tì.

- Inat të madh paskan pasur me këtë poetin Tuaj.

- Ma shumë se me Tè, e kanë pàsë me gjuhen e Tì.

- Pse, çfarë ka gjuha?

- Gëgnishtja âsht gjuha e perendive, me at giuhë ka kndue vetë Homeri, Frigjianët e Azisë s'Vogel flitshin n'ket giuhë...

- Homeri! Po ai shkruante greqisht?

- Njiqindepesdhëtë mote mbas dëkës s'ti, âsht shkruer "*Iliada*" ma e moçme... Homeri veç kndonte, librat dolen në ma vone; edhe kta n'greqishte t'vjeter, qi âsht ku e ku me greqishten e soçme, porse me gëgnishten gjajnë⁻³⁶ si dy pika uji.

- Interesant! A mund të ma shkruash saktësisht emrin e tij? Këtu... - ajo nxuer një bllok t'vogel e Albani ja shkroi at êmen, me shkronja kapitale. Teksa qeshte me vëdi, prej t'shqiptuemit t'çalë t'italjanve, prÛjke⁻³⁷ n'kujtesë faktin qi, êmni i vjeter i fshatit t'Fishtës, kish pasë kënë Fikshtë; bash atbotë kur, ndoshta, kish kënë sagllam⁻³⁸, bahçja e fiqe e Senjuerve⁻³⁹ t'Blinishtit.

Mbas dreket u ndâlen te truelli, ku ka pasë kënë shpîa e t'lëmit t'Poetit. Aty lshon hije veç një kryq i vënduem mbi një pedestal, ndokund⁻⁴⁰ dy metra mbi dhé. Italjanët dojshin me bá syreta⁻⁴¹ e Albani, mbeti tue shkrepë aparatën pa ja dá⁻⁴².

- Po shtëpinë muze, ku e ka?

- Tash po ja bájme... veç jo ktù, por pak ma poshtë, te shpîa ku ka pàsë pleqnue.

- Sështë ndërtuar ende? Por, a bëhet fjalë për Poetin Kombëtar?

- Hëm... - s'i t'ua thonte ktyne italjanve, se "qysh se ky vend, âsht mâtë me dredhen e djallit..."

- Po këtë memorial e kanë ndërtuar të paktën... - ai italjani mjekerkuq, sikur ja kish lexue t'menduemet⁻⁴³, pa i folë ende.

- Jo... edhe kte e ka ndertue një prift italgjan.

- Vërtet, po si quhej?

- Don Antonio Sciara; ish prej rajonit t'Abrucias, bash prej Marsi m'duket.

- Aha, marsikan. Ata janë malësorë kokëshkretë... krejt si ju.

- Ndoshta... ndoshta per ket arsye kerkoi me u vorrue bash njëktu.

- Pse, këtu është varrosur?

- Po n'Blinisht, kè Kisha e Tànë Shenjtënve.

- A mund të shkojmë atje?

- Posi... - u nisen sërish; makina hecte kadalë n'per rrugen e Nëmces⁴⁴, ndertue qysh n'luften e parë t'perbotshme. Kalojnë ngiat⁴⁵ një tablele që lajmon, një tjetër bar-restorant: "Hylli i Drites".

- Edhe ky është titulli i ndonjë vëllimi lirik të poetit? - Italgjanka po shkruente ëmnin e lokalit n'bllokun e saj.

- Jo, ky është ëmni i një fletorje⁴⁶, t'drejtue me prej Tì.

- Edhe gazetar paska qenë?

- Publiçist.

- Edhe publiçist, edhe liriku më i madh?

- Nuk thâçë kurr se është këne liriku ma i madh, por veç poeti i shpirtit t'Kombit.

- Pse, s'ka qenë më i madhi?

- Ndoshta po, ndoshta jo. Kjo puna e poezisë, siç po e dini vetë, edhe ma mirë se un, asht si puna e fëmnave; jo te tanë biem dakort se kush është ma e mira.

- Por, në rastin tuaj, me një poet kaq të madh, të tjerët...

- Ju nuk keni lexue Martin Camajn, zojushë... shkruaje ëmnin e tij n'bllok; shtë edhe Ndre Mjedën, Migjenin, Vinçenc Prendushin... edhe Jak Zekën, meqë po kalojmë m'tokë t'ti.

- Të gjithë, nga kjo zonë janë?

- Prej ktùhit e deri m'Shkoder.

- Mahnitëse!

- Ktu, s'tkam permëndë prozatuert.

- Lëri të lutem, mos na e mbaro bllokun e Marias, - mjekra vuni buzen n'gaz.

- Mirë, si t'doni, por Ernest Koliqin, duhet me e shkruar patjeter ...

Nderkohë ja mbrërne te kisha; porten jau çili një djalë i ri: "Prifti ka shkue n'Lesh", - jau priti, pa u dvetë ende. Vorrit t'don Antonios i bájshin hije permëndoret e dy priftënve t'pushkatuem prej regjimit totalitar, Át Daniel Dajanit e Át Giovanni Faustit. Pater Dajani e kish shpînë e t'lémit t'vet, veç dyqind metra ma poshtë.

- Qënkeni vend priftash.

- ...dhe njerëzish të shquar, - shkollarka Marije, e pa me vend që ta plotsonte profesorin e saj.

- Prej ktùhit, ma afer se shpija e pater Danielit, asht truelli ku ka pasë lé Pjetër Zarishi; i vetmi poet i njoftun, i gjysës s'parë t'sheklit t'nândmbdhëtë. Ai bán lidhjen e kultures shqyptare, prej Bardhit, Bogdanit e Budit; mjë⁻⁴⁷ kè françeskajt e jezuvitët e shquem, s'bashkut me rilindsit e tjerë.

- Ku është shtëpia e tij?

- Ah... s'ka mbëtë kurrnjë shëj per bê.

- Jeni me të vertetë një popull interesant, - profesori xûni t'fshijë xhamin e syzeve, - ...prandaj dhe keni kaq shumë martirë. Kjo e fundit, veçsa i kaloi n'per mend.

- Kombet nuk maten me njerzit e shquem që kanë qitë, por me mndÿren se si i trajtojnë ata, n'tgjallë e n'tdëkun t'tyne.

- Po pse Alban, pse? ...pse veproni kështu?

- ...Askush ma mirë se nâ, nuk e zotnon magjinë e t'krijuemit, n'tbashkjetuem me kândjen⁻⁴⁸ e t'shkatrruemit. Ktù ka ma shumë Kainë se Zota.

- Hëm... edhe vitin e mbrashtë të 1997-ës këtu e kaloi don Antonio?

- A e dini si ju tha blinishtasve, që i kerkuen t'largohej, pse nuk ja sugurojshin dot jeten?

- Pa hë?

- Nse s'ju nâp bezdi, kisha dashtë me ndëjtë.

- Interesante! - Profesori kish mbarue dlijen⁻⁴⁹ e xhamave, pa i vuni syzet prap.

Nuk mbeti gjâ tjetër për me u thânë; kshtuqì, si báne edhe shkrepjet e fundit t'aparatis fotografik, u nisën për n'Lesh; kshtu i thônë deri nditt tona qytetit t'Lezhës, banorët e rrethinave. T'mbrrîmen⁻⁵⁰ kè shpîja, Albani ndihej i lodhun, por edhe konkënd⁻⁵¹; jo veç për paret e fitueme, por edhe për ditën e kalueme si s'ka ma mirë.

E kish ba një sy t'mirë me gjumë, kur ndigjoi klithmat e para; një zâ grueje po e thyente qetinë e natës, si ulrima e ulkojes n'borë. Doli ndritore, kur që: plaku po dilte prej shpîje m'kmishë, porse një xhakëtë e vjetër i fluroi permáje kreje. Hapi derën e i bzâni, por ai kish rá n'te dy gujtë e s'gjegjej. Hodhi dishka krahëve e doli. Plaku kish mbetë si i ngrimë e nuk bzâte; ju desht me e bâjtë n'krah, si fmì t'vogel. N't'ndejme kish do tule fëmnore. E uli n'qylym pranë sobës e i shtoi dò dru zjarmit. Plaku, si gjithnjë, as nëpte as merrte, vetem shifte drutë tue u djegë n'sobë. Albanit i treti gjumi e rrinte edhe ai tue kundruë plakun. Befas mori letren e ja nisi me shkruë:

Gruan e kishte marrë gjumi mbi divan. U bënë disa net që ai po vonohej, kur të vinte do t'ia thoshte; mirë që po kujdesej për prindërit e tij, por i duhej të duronte edhe këto vonesa të pakuptimta.

Vjehri i hodhi një batanije, por asaj iu çelen sytë; vendosi të shkonte të flinte, meqë tjetri mori përsipër dezurnin. Veshi atlasin që i pëlqente atij, largoi mbulesën përgjysmë dhe u shtri menjëherë.

Pasi kishte bërë edhe një sy tjetër gjumë, ndjeu një drithërimë të ëmbël nën gushë, pastaj rrëzë gjoksit dhe së fundi në ije; mos kishte ardhur ai. Shtriu dorën ta prekte; gishtat i ndeshën në një lëkurë të ashpër dhe të ftohtë; iu

duk si tërkuzë bari.

Kur mori të ngrihej, iu zu fryma; mundi vetëm të largonte mbulesën dhe të lëshonte një klithmë të mbytur... Kur hapi sytë, pa vjehrrin me një shkop bejsbolli në dorë, kurse vjehrra, po i fërkonte ballin me sytë gjithë lot. Në cep të dhomës, pa një si litar të zi, të mbledhur kulaç, me një nyje të deformuar, si kokë e rrahur, porse sytë...

E vuni letren ngiet s'pares e prap pá kah plaku; asgjâsend nuk t'lente me kuptue nse ish gjallë aspo, veç një t'kuqi t'letë, qi i kish mblue mollzat pak nen sy; nuk di a prej marres, a prej zjarmit t'sobës, a prej lotve t'shkrîmë. I hodhi një batanije krahve, por ai prap nuk luejti as gishtin; e mûjti lodhja e s'und duroj mâ, pâ u shtrí.

N'mjes, plakun e gjeti bash njaty ku e kish lane, veçse soba ish kënë fikë qyshkur. Hapi deren kadalë e u freskue pak n'ujtë e çezmes s'oborrit. Kur ktheu, dveti plakun nse ja kânde 'i kafe. S'parit ai nuk luejti, po kur e dveti s'dyti, i hodhi një t'shikuem t'perhumbun; u ngrit e doli, pa qitë fjalë prej gojet.

Edhe Albanit s'i rrihej mâ aty, muer rrugen "Gjergj Fishta" e u drejtue per nçarshi. Tue kalue ngiet do kafeneve dikush i bzâni. Ish një hollak, qi punonte n'komune; ja pranoi ftesën e u ul pranë ti, me shpinë kah shemshiri, per nen çinar.

- Mirë qi t'ndështa; tash dò ditë jam tue t'lypë me mënd.

- Hajer kjôftë!

- Jo mor, kurrjâ e rândsishme, veç deshta me diskutue dishkà me ty... Po duem me vndûe⁻⁵² dò êmna rrugësh, 167 mor burrë; ku t'bekuemin me i gjëtë kaq shumë êmna.

- Edhe 1670 êmna gjenden.

- Po duhen êmna n'zâ⁻⁵³, figura t'shqume...

- Njani ma i mirë se tjetri; po jà, Lezha âsht vendi i t'Beslidhunit...

- E këna teprue me dy Gjergjat, Fishtë e Kastriot.

- Po por, s'kena 'i rrugë me êmnin e Balshajve, Topiajve, Muzakajve; asnjë rrugë per bê, s'ka êmnin e Lek Dukagjinit, as t'Lek Zaharisë. Ke edhe Pjeter Spanin, Gjergj Dushmanin e Jonimajt, pse jo edhe Preng Bib Dodën e Ded Gjo Lulin, nuk mjaftojnë vetem Vllâznit Coku...

- Po tjetër? - Inxhinieri i komunes kish nxjerrë një bllok e po shkruente n'të.

- Ke dhe Vrana Kontin e Gjorg Golemin, Pal Engjëllin e

Gjon Gazullin, Guljem e Vllado Blinishtin; Façesk Krispin e Zef Skiroin, Martin Camajn e Ernest Koliqin; Aleksander Moisiun e Bekim Femiun, pse jo edhe Pjetër Abnorin edhe Princ Vidin ...

- Tjeter, tjeter ...

- Paj mund t' thuesh, edhe rruga e Hotit apo e Shkrelit, e Kelmëndit apo e Kastratit, e Kuzhnënit, Spaçit apo Oroshit; mundesh me thënë rruga e Kongresit t' Manastirit, apo e Lidhjes s' Prizrenit; rruga e Konferencës s' Bujanit, apo rruga e Kuvendit t' Ferizajt...

- Ehe... rrugen Kuvendi i Ârbnit e kena.

- Po na s' kena 'i rrugë, qi t' thirret Leka i Madh apo Burri i Epirit; siç krejt mirë mund t' kena, rrugën e Çezarit, t' Ali Pashës, t' Mahmut Pashë Bushatliut, apo t' Bill Klintonit. Pse mos me pàsë, edhe rrugët Ibrahim Rugova e Fehmi Agani, Arber Xhaferri e Adem Jashari, Ismail Qemali e Isë Boletini ...deri te rruga e Gjergj Elez Alisë.

- Krejt mirë, u bane bajagi.

- Po un kam prap; ke Vinçenc Prendushin e Ndre Mjedjen, Prend Doçin e Shtjefen Gjeçovin; pse jo edhe Anton Harapin e Pjeter Meshkallen, Donat Kurtin e Benardin Palajn, Justin Rroten e Marin Sirdanin, Jak Zeken e ...

- Kadalë, kadalë, sa t' i shkruej... Sikur mjaft me priften?

- Mirë po kam prap; kisha dashtë një rrugë me êmnin e Edvin Zhakut, një me êmen t' Fallmerayer-it e një t' Lambertz-it, t' Georg Von Han-it e t' Baron Nopçe-s, t' Robert D'Anzhelys e t' Norbert Jokl-it, t' Faveirial-it e...

- Anì... porse, gadi kurrkush s' i njeft ktà.

- Per me i njoftë, duhet me jau vndûe êmnat n' rrugë.

- Besoj se mbastojnë... sa me nisë.

- Prit, s' kam dhënë ende Pjeter Zarishin e Daniel Dajanin, Filip Shiroken e Frederik Reshpjen, pa harrue Vllâznit Frashni ... Paj, kena Mbretin Bardhyl, Gentin, Agronin e Teuten; pse jo, edhe Glaukian e dy Batot. Krejt mirë mund t' thôna rruga e Pirustve apo rruga e Taulantve, e Paonve apo e Dalmatve, e

Adriaajve apo e Labeatve, e Liburnve...

- Mjaft se m'lodhe.

- Jo s'ka mjaft; pak ma parë m'thë, ku me i gjetë 170 êmna; tash duro.

- Anì, anì... po mbaroi blloku.

- Blloku jot i nxén, edhe Noren e Kelmendit edhe Shote Galicen; báni vend edhe Marko Boçarit e Bubulinës...

- I shkrova t'tana...

- Prit se ke edhe mâ.

- T'lútna⁻⁵⁴ mjaft... dalin e teprojnë.

- Jo, nuk ndalem tash; ke Ibrahim Kodren e Ferid Muratin...

- tjetri ish çue tashmâ prej tavolinës.

- T'falemndërs.

- ... Tjeter herë, mos të t'ndígoj tue thànë, se s'di ku me i gjetë dyqind êmna; eeeeeeej... na s'kena per t'pàsë kurrë aq rrugë, sa njerz e vepra kena per t'nderue.

- Ika...

- Ku dòn me shkue, po un kam harrue Pjetër Bogdanin, Budin e Buzukun... se Frang Bardhi e ka 'i rrugë - tjetri po ja bánte me dorë, prej matanë rrugës; - po kena De Raden e Gavril Darën, Jul Varibobën e Leonik Tomeun, Arkitekt Sinanin, Onufrin e deri Karl Gegen, se Gjovalin Gjadri e ka një rrugë ...Ku shkojmë nà pa Ndoc Gjetjen, Anton Pashkun, Nolin, Lasgushin e Azem Shkrelin? ...Se Ali Ulqinaku e ka një rrugë.

Zâni i kish ikë, e tash veç i mendonte atò êmna; u çue prej tavoline, qì t'mos e merrnin kamarierat per t'çmëndun.

Ki'n kalue tri ditë, kur inxhinieri i komunës e mori n'telefon.

- Alo.

- Po t'ndígoj.

- M'fal, nse t'bezdisa; po s'kë shkà bán, ty t'kena per ktò punë.

- Mos kìj dert, m'thuej.

- Bulevardit t'ri, ja kena njëte emnin Papa Gjon Pali II, pse

kalon ngiet katedrales, porse bulevardi që bie terthuer me kyt, kalon ngiat xhamisë edhe...

- Ju duhet një ëmen mysliman?

- Ma t'shquemin e ma t'gjithpranuemin...

- Mos e zgjat; Faik Konica - ndigiohen zâna, matanë telefonit.

- I madh je, u kry!

- Jo, i madh ishte Faiku...

T'propozuemt e Albanit ki'n sherbye, veç sa me ju hâpë oreksin; te tanë ki'n nisë me shtue kà 'i ëmen prifti a hoxhe, dikush ndoj ëmen fukcionari t'dikurshem e deri te personazhet e Lahuts s'Malcis, si Bec Patani, Preng Markola e Marash Uci, Oso Kuka e Ali Pashë Guxia, Gjini Pjeter Kurbini e Llesh Nik Daka. Kol Toma i Velës e kish me kohë rrugen e të, ashtu si Shtrausi i Bavarisë, kur, per shkak t'vizitës s'ti, kjë hapë 'i rrugë e re, per me t'çue n'hotel t'Gjôjes, ase rezidenca e dikurshme e Kontit Çiano; pa kalue n'per qytet t'Lezhës. Nipat e ministrit t'dikurshem të Fashos, po ashtu si t'bijtë e Shtrausit, nuk janë pá mâ ksajt.

Fatin ma t'keq e pati rruga me ëmnin e Zef Skirojt; pa u mbushë t'gjashtë muejt nga vendimi i kshillit, ajo rrugë nuk ekzistueke mâ; u kishte lshue vënd dy pallateve, njani ma i nâltë se tjetri.

Albani i hodhi sýtë per kah dritorja; plaku po merrej me koshat e të, kurse grueja po lânte teshat; dukej sikur asgjâ s'e trazonte qetinë e jetës. Mori një leter e nisi me shkarravitë n'të, e báni shuk e mori një tjetër; ksaj rradhe i heci fati e shkroi pa u ndâlë 'i gjysem faqje.

Nuk mund të ecja më shpejt, por mund t'i bija për shkurt. Kur arrita në shtëpi gruaja po flinte në divan; vendosa t'i bëja edhe një surprizë tjetër. Isha mbledhur palmuç, në anën time të krevatit, kur ajo erdhi dhe aroma e saj e ëmbël më zgjoi gjakun.

I putha gushën, gjinjtë, ijën dhe nuk kisha të ngopur; e përqafova të gjithën dhe po prisja që të zgjohej.

Prekja e saj më ndezi edhe më tepër, por... nuk di pse u tremb; desha t'i thosha se "jam unë", por në vend të zërit më doli një fëshfërimë.

Sa u ndez drita, pashë tim atë me shkop bejsbolli në dorë; desha t'i them të fikte dritën, por ai më qëlloi në kokë, pastaj në trup e prap në kokë. Rrëshqita nga krevati dhe u mblodha kruspull në cep të dhomës; sytë kërkuan time më, por ajo shqetësohej vetëm për gruan time. Kur ajo i hapi sytë do desha t'iu thosha: "si ju shkon mendja, se mund t'i bëj keq asaj", por shkopi i tim eti m'i shpërthiqi trutë në mur dhe unë s'pata më kohë apo nuk desha të hidhem gjëkund...

I báni bashkë te tri copat e letres; mbase do t'i hyjshin n'punë ndoj ditë. I futi diku mes librash, mori njanin syresh e u ul n'minder; soba kish nisë me u shkëmë, por edhe prândvera kish nisë me ardhë.

E thirren edhe nja dy herë t'tjera që t'bate guiden turistike; nisi me punue kohë mbas kohe, me 'i organizatë t'mosvarme⁵⁵; por prap nuk ndihej mirë. Kish marrë pjesë n'tri konkurse punsimi, kurrnja s'e kish fitue, por veç njani e kish telefonue per me i njoftue deshtimin. A penjimënd i'n këne kaq t'mirë konkurentat e tjerë, apo mos ndoshta ato konkurse, nuk i'n tjetër, veçse një teater absurd? E kish t'vshtirë me hjekë dorë prej dishirit, per me punue n'administratë publike; ndoshta ngaqi kish nevojë, per me e pá arushen mbrëna n'stofull; apo mos ndoshta e kish kapë diliri i heroizmës.

Nisi me shestue⁵⁶ ndâmjen e biletës "gërvisht e fitò"; ju desht me e falendêrue kumbaren e ksaj pune edhe pse i dukej sikur po i sherbente djallit. Kur i kerkuene me fabrikue fitues fallco, ïku kah sÿtë kâmbët e s'u pá mâ n'zyre t'tÿne.

Mirpo fatit, kurrë s'i dihet, ja mbrîni me e gjetë at punen n'shtet; por jo prej meritave, as prej cillësive, por vetem e vetem pse i kish rá ndermënd per të një miku t'vjeter. Aty gjeti dashamirsi e filloi me ju duk vëdi i dobishem, ndonse pritshmënîtë i kish pásë per ma teper.

Mori një shpî tjetër, 'i apartament t'bollshem; ndonse grueja e odës ju lut t'rrinte, djali kish fillue t'nâltën e i duheshin pare. Nuk mund t'rrinte ma n'at vend, sherri i tyne i kish hí nen lkurë; i pagoi një muej ma teper, i lá gjysen e orendive e ïku kah sÿtë kâmbët.

Shokët e rij i vîjshin shpesh per vizitë; dò ishin t'martuem e dò jo, por t'tanë ja kishin lakmi jeten që bante; veç ai s'ish i knâqun me vëdin. Shoqja simpatike, që p'ati fatin ta vizitonte, nisi

t'i báje inventarin e shpísë, tue i ardhë rrotull saj, thue se s'e kish per herë t'parë. Gjysa e mureve i'n xânë me libra, gjysa tjetër ish lye n'bojë t'kremít.

- Ti jetoke si mbret, n'mes tanë t'ktýne librave.

- Populli ma i keq n'botë janë librat.

- E pse?

- Janë krejt t'pabindun e t'paçansuem⁻⁵⁷

- Por jeton boten tânde veç.

- Jo per t'u pásë lakmi.

- Pse, ...t'mungon mbretnêsha?

- Ndoshta... - ajo ju afrue aqsà majat e gjíjve t'saj mposhten rezistencen e kmishës e ja shpuen lkuren e krahit, tue i dhanë një t'dridhun t'letë, q'i ngrohu gjakun e i ftofi mëndën...

- Thâçë: ndoshta... per mbretnêshen e jo per fêmnën.

- E ku âsht ndryshimi ktù?

- Ndoshta... te t'njohunit e mbretnîsë tême.

- E pashë tanë mbretnîné tânde.

- Ti vetem sa i kalove pernjítas⁻⁵⁸.

- E shkà mund t'bájsha tjetër?

- Nuk e di... ndoshta, t'u ndâlshe diku, t'kâpshe një copë jetë ...

- Ate bána...

- Nuk e kam fjalen per mishin têm, ai t'dishron pa m'dyshje, por tash qì m'permende mbretnêshen...

- Mos bána gabim?

- Nuk e di... - buzët e saj, tânë mish t'frymë, po ja bájshin me sy, prandej duer e gjak s'ju binden mâ.

Fjeti nja dy orë t'mira, para se me çilë njanin sy, mbi t'cillin kí'n ra do fije t'giata floku. Deshti me u çue, por per çudë u ndje konkënd; qashtu i shtrîmë n'çarçafë t'mndafshta, hapi krahun m'e perfshi at pyllnajë flokësh, qì po lshojshin një aromë t'âmbel; porse, lakuriqnija e trupit fêmnuer, bashkë me freskinë e gjíjve t'saj ja kndëllen zêmren, mjesà i vërshoi gjaku edhe nder vêdi⁻⁵⁹.

E puthi letë mbi sy, por tjetra flinte. U çue e po hecte n'per odë; shkoi n'kuzhinë e mori 'i birrë; ndezi driten e u ul n'cep t'shtratit; hodhi menden e sytë per nen flokët e shpupurisun të s'dashtunes

...

- Ah, Zot... cillen lojë po m'bán? - Shishja i rá prej dore e birra ju derdh permbi çarçafë.

Instinktivisht fiku dritën; e verteta po e shkallmonte. Per do t'imta kish perjetue ândrren e báme realitet, por drita e ndezun e ktheu n'zhgjànderr; n'at krevat nuk ish shtrí femna qì ai do t'donte. Po i merrej fryma, prandej hyni n'banjë, ndezi driten, hapi dritoren e ju gërmush surratit t'vet para pasqyres, qì gâdi e theu me një t'grushtuem t'befte. Me doren q'í dhimbte ende, shtrëngoi fort rubinetin e çesmes, derisa ju permirsue marrja e frymës. Çoi edhe 'i herë sýtë, per më pá shembellyren e vet:

"Tjetra t'dhá gjithshkâfen, kurse ti e perbûzë", - i thá vëdit, apo kujtoi se i thá. Ju duk se po tradhtonte dishkà ma t'fortë mbrênda vëdit, kur fiku dritën e u shtrí n'krevat...

N'nadje ajo ish çue para tì, ndoshta ândrrat e ki'n lodhë prej s'teprit at natë.

- U çove loçka jême? - Vajza qì kish bá dush, futi kryet te dera e odes s'gjumit, mbshtjellë m'nji peshqir t'bardhêmtë. - Dòn me ta bá një kafe? Ku janë aletet⁻⁶⁰?

- Njîtë me aspiruesin, n'tshmaket⁻⁶¹.

- Njì lugë sheqer?

- Jo grumbull, por rrafsh.

- Po filxhanat, ku... ? - u dëgjuen do t'rrapllueme, - ...léne se i gjeta.

- Merr ndoj gjâ per vëdi.

- Sa e píva një pije kndëllse⁻⁶², - ajo po sillej si n'shpî t'vet e ky nuk ish shêi i mirë; i duhej me i skjarue dò gjâna, sa s'ish vonë.

- Zêmer, ma bjë edhe 'i gotë ujë.

- Itash zemer, - ajo u ul ngiet tì e po e kqyrte tue i numrue t'gjerbmet.

- E kaluem mirë mbrâmë, aspo? - Albani i uli sytë mbi filxhan, mjesà gjerbi edhe hurmin e fundit.

- Si thue ti?

- Si s'ka ma mire, veçse heren tjeter duhet t'marrim edhe vënë.

- Thue, t'ketë herë tjeter?

- Pse jo? - Ajo e pá per nen qerpikë e një i kuq i letë ja nxehu mollzat.

- Ti m'dòn? - E kuptoi se nuk duhet ta irrnonte⁻⁶³ ma teper.

- Ti dyshon?

- Nà s'kena folë per njëkýt punë.

- Nuk flet mjaft mbrâmja e shkueme?

- Kjo natë m'thotë se t'kam pelqye... edhe ti m'pelqen.

- ...Vetem kaq?

- Vetem kaq, mundem me t'thânë, tash per tash.

- Katil... - Një jastek i hjedhun vrikthi, i çiku májen e hundes e derdhi goten e ujit, - Un s'jam kurvë.

- Loçka jême, m'kuptò drejt, un...

- E di teorinë tânde, t'terhjekjes... pertej fizikes, - vajza po vishej. - E tepert per mue, t'rri e t'ndígioj at lekcion,.. bash njëtash.

- Prit! - Ajo po dilte prej odës, ndaloi, u kthye e i hodhi një t'vishtruem t'pazberthyeshem.

- Shifna t'hânen zêmer, - fjalën e fundit e shoqnoi me një t'buzqeshun, që atij ju duk robotike.

Mos po bante mëkat para Zotit e fatit t'vet? Vajza ish e squet⁻⁶⁴, e kândshme, nuk mund t'prishte gjithshkâfen me at cinizmin e vet t'akullt; gjânat e mira, nuk ndeshen perditë. Me ktò t'mendueme n'krye, u çue e hapi dritoren; mbrëni pranë komohit e... pá se gota kish marrë veç një t'krisun t'letë.

Shoqen e takoi t'hânen, t'mârten e ...t'shtûnden e kish prap mysafire; ksaj radhe kish marrë edhe ndrresat me vëdi. Albani i pá, por nuk tha gjâ; dukej i dorzuem. Ku shkoi, vallë, dashnija e tij e madhe?! Dashnija që ju kish vjedhun perëndive e që s'kish t'krahasuem me kurrsend tjeter n'ket dhé. Tash i dukej vëdi

si krymb toket. Medet! Shkà ish ky fati i ti?! O krymb toket, o shqipe kraahthyme!

Ajo nisi t'vinte qysh t'prëmtën n'darkë, derisa një t'hâne nuk ìku mà kurrkund. I pelqejshin t'ardhmet e saj, edhe fort madje, por tash qì s'do t'kish mà pritje? E dinte se kjo ish prova e madhe. Sa kohë do t'kalonte, gjersa t'i vÿjte dishiri per me e xjerrë n'shqelma perjashta? I premtoi vëdit se do t'bájte t'pamujtmen, qì kjo ditë t'ish sa ma e largët.

Filluen me dalë s'bashkut n'per qytet, s'parit n'per muzg e masàndej, nàdje e mbràmje, kryq e terthuer nahijes. Dikush i kqyrte per séri, një tjetër ulte sÿtë turpnueshem, pakkush i shifte n'simpatì. Nuk merzitej per vëdi, merzitej per qytetin; sa pak njerëz jetojshin n'tè.

Kur ajo bleu perdet, e kuptoi se s'do t'mund ta shkulte mà prej shpÿjet; sÿtë e saj shkelqejshin tânë lùmni⁶⁵, atbotë qì, ajo copë mndashi ja xuni rrugen drites. T'nesermen ia mbrÿrìne bojaxhijtë; boja e murit, nuk shkonte me perdet.

- Shpirt, si thue?

- Shkà?

- Per kuzhinen, prà... - Ai s'è kish pasë mëndën aty.

- Shkà don me i bá kuzhinës?

- Njatë qì t'thàçë.

- Mirë... bán shkà t'duesh.

- Oh sa i mirë qì m'jé! - Puthja e saj e aroma e flokve m'ballë, ja shtuen àndjen per tè, veçse... pak ma pak se heren e shkueme.

Gjithshkafja shkonte mirë n'tdukun, veçse Albani gdhihej me sÿtë "sa grushti". Filloi t'i largohej shpÿsë; vonohej pa ndonji shkak dhe as qì e thartonte kryet per me gjetë t'justifikuem. Kì'n veç tre muej qì po jetojshin s'bashkut e u i'n mbarue kuvendat. Magjia e s'panjoftunes kaloi; ajo tjetra s'kish kënë kurr, tash ngelej veç duresa.

N'Lezhë, policia, shpija e t'lémit⁶⁶, jallia e topkambës⁶⁷ e akuza publike janë n't'njajten rrugë, n'rrugen "Luigj Gurakuqi" ose, siç i thotë populli, n'rrugen e mundimeve t'mëdha. Permby rrugen "Gjergj Fishta" është gjykatorja; pak ma nëlt, shtrihet spitali; e permby kto t'dÿja është kalaja, t'cilles i bán hije, veç tyrbja e "buon kasapit", e vendueme mbi mal t'Shelbuemit, ndoshta AkroLisi i lashtë. Kompleksi spitaluer i Tiranës, thirret "Nanë Terezja"; kurse n'Lisin modern, me kyt êmen thirret veç rruga e spitalit. Kjo malore e fortë, qì do t'u bante mirë barkthive qì lvizin me makina, n't'njajten kohë jau merr shpirtin njatyne qì s'kanë pàre me blé automobila.

Ish tue u njëte ksaj termalje per me pá 'i shoq t'vetin, i ish shpif 'i smunde e keqe e po thòjshin se s'ë kish t'giatë. N'sýtë e tij, nuk pá tmerrin por qetinë; nuk po i hiqej prej mëndes, as kur kish zbritë gjysen e teposhtes. Befas... pá një grue; ish ulë brì një arkivoli e po kjànte; ish grueja q'i pati lshue at oden me qira.

- Shkà ka bá vaki? - Ajo çoi paksa kryet e sa pá Albanin, i shpethyen lott prap.

- O kukù, per mue!

- Mos është yt shoq?

- Njaj njëri është... qì e ke njoftë per t'ëm shoq.

- Shkà je tue m'thânë?! - Albani po habitej me vajin e saj; thue se s'ish ajo qì e kish lánë me fjetë perjashta, apo qì e kish rràhë n'thuper t'mrinës. - Po si ngjau?

- Ou, si ngjau?! ...U shkrí si bora n'mal.

- Hajde, mblidhe vëdin! - Albani i kapi krahun, por ai i ngeli ndorë si dru i thatë. - A e ka marrë vesht djali?

- Djali?! ...E shkà hyn ai n'ket punë?
- Epo... àsht i biri.
- I biri i kùjt? - S'ytë e grues i futen t'dridhunat. - I çova lajm, i çova... tue ardhë do t'jetë.
- Hajde çojú! - E mori gruen pothuej zharg⁶⁸ dhe e uli n'parvaz t'poshtem t'rrugës. - Mbàje vëdin, nuk t'ka hije me bá kshtù!
- Eh, mor bir... ta dish ti shkà mora vesht un sod.
- E shkà?
- Ma mirë t'kisha dëkë e shkue, ah... e mjera un per ty, e mjeeeeera!
- Shkà ke marr vesht loke, shkà ta ka trazue shpirtin kaq fort?
- Ah e mjera un e mjera, si me e mbàjtë ket dhùnë n'shpirt? E kam rráfë, e kam shá, sa herë kam dashtë, e kam pshtý n'surrat... kurse ky, ky shpirt i bjerrun...
- T'bie pak ujë? - Grues i ish thá fyti e po i merrej fryma. Albani vrapoi me blé 'i bidon t'vogel me ujë. - Pì pak!
- Ah, ku ka ujë qì ma shuen zjarmîn mue?! - Grueja veç sa e lagu pak buzen. - Po baba i tim biri, kush na kënka?
- Pse, a s'ish ai, a?
- E si kish me mùjtë me kënë?
- A ish edhe ai... at natë?
- At natë? ...Tash po m'kujtohen ato dy sy qì m'shifshin prùjshem⁶⁹...
- E ke falë?
- E ka me falë, mor i luejtun? ...Ka durue tânë ato t'fyeme pa bzàjtë... edhe pa pàsë kurrnjì grímë faj.
- Por cubat s'i tregoi veçse; báni burgun, po êmnat e tyne s'i nxori.
- Shpirtin e kish pàsë t'parrizit, po trupin t'ferrit.
- ...Hem!
- Mirë burgun qì e báni, por tânë jeten burg ja bána edhe un, qì mos m'zbardhtë drita, ishalla, mos m'zbardhtë!

- Mos nem, se asht e prënde e t'xen nëma.
- Ku me e gjetë?! - Albani desh t'i japë edhe 'i fyt ujë, po grueja ja shtyni shishen.
- Pì pak se...
- Shkà me pì, hë mue m'vraftë Shnà Prëndja!
- ...Kah je kaq e bindun, qì ai s't'ka faj?
- Kush ai?
- Ai... - Albani báni me dorë kah arkivoli.
- Nuk ásht ai... ásht ajo.
- Si?! - Albanit i rá bidoni prej dore.
- Ish kënë burrnëshë e betueme...
- Mos m'thuj! ...Po qysh, kurrkush s'dinte gjâ?
- Prândeje nuk fliste kurrë per njerzit e saj...
- ...A i çove lajm atyne?
- Kujt me i çue lajm? Kurrkând nuk njof nen ket qiell prej gjakut t'saj.
- Hajde se po t'ndih un. Ku don me e çue... te shpìja?
- Ke shpìja jo... ma la amanet. Veç due me e vorrue... po léna pak se s'mdel shpirti prej marazit! Si s'ja thâçë 'i fjalë t'mirë tânë jeten e s'mjeres; hë mue m'vraftë Rêja, m'vraftë!
- Po qysh t'duronte vallë? - I rrshiti fjala pa dashtë Albanit.
- Ajo m'donte...
- Hem... - ai uli kryet.
- Mos guxo t'mëndojshe per lojna kuplerajash⁻⁷⁰, - Albani u ndíe si i kapun mat. - Ajo m'donte ndryshe.
- E si?
- ...Tue i dalë fryma e fundit, m'tha: "t'falemndërs".
- E pse?
- Njikshutë i thâçë edhe vetë.
- E ai... ajo deshta me thânë?
- T'falemndërs, m'tha... t'falemndërs per gjithshkâfen.
- Jo more, jo!...
- Pse m'fâlesh ndêres, hë shpirt i djerrun, i thâçë... apo dòn me m'perpí flaktë e ferrit, bash njëdash?

- E ajo?

- T'falemndërs, m'tha, per vëmëndjen që m'ke kushtue.

- Por ti, veç dhënë e t'shame i ke dhanë!

- Kshtu i thaçë edhe un, por ajo...

- Ajo... e shkà tha ajo? - Albani ish bá tânë sý e vëshë.

- E di m'tha, por dhuna jote... m'u drejtoke mue, mue e vetem mue; askush s'm'ka vndue oroe kaq shumë n'ket jetë... Ah si nuk m'duel shpirti kur i ndieva 'itò fjalë?! - Grueja shpertheu n'vaj prap, rrrshiti e rá me tule, drejt e n'asfalt.

- Mbajë vëdin... çojù!, - Edhe Albanin e kish lánë takati e s'mund e luejti vendit.

E kish shkandullue kjo histori, e kish tronditë mu n'lukth t'shpirtit. Shkà kish bá ajo grue burrnëshë, ajo grue që tash shtrihej e dêkun, nen ato drrasa t'laguna?! Shkà s'kish bá ajo grue, per një grimë jetë?! Kurse ai... shka kish bá ai per me e rifitue dashninë e jetës s'vet?! Kurrgjà! Tash po shifte kjàrtë; e kish pritë lumninë t'i vinte si dhântí⁷¹, sè kish vrá dot kreninë, pa e ki'n mbyttë rêsa⁷² e sedra e smûndë.

Moren arkivolin, njani para e tjetri mrapa; Albanit i dukej sikur po mbànte, t'kerkuemt⁷³ e vet per falje. Po kujt ia drejtonte, Zotit apo Asajna? Nisi me ra shi, po ata s'u ndalen; s'u ndalen as kur shiu u bá rrrshê. T'mbrërimen te vorret, s'u shifte kurrgjà. Donte edhe dò minuta me rá nata, porse vransina e konopët e shiut e ki'n vrá dritën; dukej sikur Zoti vetë po e kjànte dêken e saj. Kur dështen me e zdrÿpë⁷⁴ n'gropë, ja mbrërimi djali; rá nguij tue pùthë drrasat, ku mendonte se do t'ish kryet e "ti".

- Hapnë... hapnë se due me e pá per herë t'fundit!

- Prit!... - Drrasat i'n ajë⁷⁵ prej shiut e Albani mezi i hapi.

- O i miri jêm, i miri... si shkove kshtu?! - Grueja po e shifte djalin tânë drôjë.

- Ah nanë! - Djali ish çue e kish rá si cung n'cupin e saj.

- Nana mos kjòftë ma mirë! - E hoqi perdhûnshem kryet e djalit prej cupit t'vet.

- Pse nanë, pse m'shtÿnë?

- Un... un s'ë meritoj me kënë nana jote; ...shkà i kam bá un ksàj!

- Kùjt? ...Nanë, mos m'lén vetem nanë! - ju hodh prap n'gji e ajo nuk luejti, por giujt e tradhtuen, s'ë mbàjten dot peshen; ránë te dy me giuj n'baltë.

Terri ish aq i thellë, saqi Albani mezi e gjeti konopin; e uli at grumull kocash n'gropë, pa e ndeshë kund e pa ju mbàjtë fryma; ase ajo ish tretë e mbarue, ase atij i dha forcë Zoja e Paperlyeme⁷⁶. Mbas dò çasash u çue djali e ja mori lopaten. Kur grumbulli i dhéut mrrîni mjë n'giu, shiu kish prá e Albani mendoi se s'kish shkà t'bánte mâ aty.

E báni m'kâmbë tânë rrugën per n'qytet. Sa iu afrue vëndit ku thonë se kjë vorrue Skânderbegu, e xuni 'i shi i rrâjshem⁷⁷, qì ja shplau tânë baltën e trupit. Llambat e rrugës, një u ndezke e tri jo; asgjâmangut⁷⁸, e gjeti vëndin ku donte me shkue. Mbrîni per nen balkue t'sâjna e, si pá veç një dritë t'voktë⁷⁹, mendoi me trokitë; deren ja çili një plakë e bardhëme me 'i shami t'bardhë n'krye:

- Ké dòn, mor bir?

- Mbesen tânde.

- Ké... mbesen? ...Ajo po bán shtatë muej qì nuk à ktù.

- E ku àsht?

- Australe, m'duket se i thônë atì dhéu t'huej.

Ato fjalë e vranë! Kish ardhë shumë vonë e s'kish shkà me bá mâ. Donmethânë, tânë ato t'dridhme t'shpirtit sa herë kalonte n'at rrugicë, s'paskan kënë tjetër, veç dredhîna t'djallit, pse ai e paskesh hûpë dhuraten e Zotit, qysh se s'kish mùjtë me mbýtë kreninë e vet. Pse s'kish fjetë nen ket balkue?! Pse kish bá kot sikur po jetonte, teksa mëndja e shpirti s'k'ni kënë me t'è?! Tash po i paguente t'tana; do t'ëndej si dem i terbuem n'per natë, po at gjânë e hûpun s'kish m'ë gjetë mâ. Edhe per t'gjetë Urën e Laraskave⁸⁰ duhej me sosë mjë n'Kinë.

Me zor t'madh i zdrypi njatò shkallë e duel n'rrugë; nuk

dinte kah me mbâjtë, veç kâmbët e çuen n'udhkryq. Sa duel n'qoshe t'pallatit, u lshue si i shituem⁸¹ n'trotuar. Bâni si kish bá gjithnji; lshoi synin n'cep t'pallatit, per me pá rrugicen kah kish ârdhë. Natyrshem ajo s'ish, kish shtatë muej n'Australi. Pá prap, e prap kurrjgjà. T'ftohtit i kish hí n'palcë, por jo mjë aty ku i kish mbjhtë t'trishtuem⁸².

U pshtet me tânë shpinen per mûr t'pallatit, si tue dashtë me mbledhë forcat e fûndit; pá edhe 'i herë n'bisht synit per kah rrugica, prap kurrjgjàsend. Priti sa t'ndizej drita, qì herë flakonte e herë fikej; donte me e ruejtë n'kujtesë at asfalt t'lagun, thue se s'do t'kish tjetër rasë per me e pá. U lshue krejt me shpinë per mûr; tash nuk e kthente ma kryet me pá, madje sytë i kish t'mbyllun krejt, shifte veç me sýtë e mëndes.

Ksaj here ajo duel; hecte kadalë drejt udhkryqit, tue i hjedhë mbas krahe leshnat e verdha t'krësë qì, herë mbas here, i bijshin n'sy. I ndígonte hapat e sâjna kah aviteshin, ndígiote edhe zêmren, qì kish hí n'rezonancë me ato hapa. Brràm, brràm... edhe një, edhe një, qè... mbrríni. Tash ajo duhej t'kish mbrrí, po pse s'po e shifte? Pse s'ndalonte? Hapat e sâj na trokitnin si shiu n'xham, n'njajtin ritem me gjakun q'i gurgllonte nder deje.

...

T'nesermen lypsat gjeten një kufomë t'ngrime, lshue n'kalldram e pshtetë per mûr; bash te udhkryqi, ku nis rruga e mundimeve t'mëdha.

EPILOG

E shenjtë është jeta e tjetrit, jo jotja!
Sofisti.

Isha në spital, me këmbën dhe zemrën të thyer; njëra do të më shërohej natyrisht, kurse për tjetrën, nuk isha i sigurt.

- O Zot, pse m'duhet me i durue tânë ktò dhimbta?! Kujt i hyn n'punë kjò jeta jême, se mue jo?! Merrma jeten o Zot, pse ma kursen?! Çfarë planesh ke per mue dhe pse duhet t'i ndjek un planet e tuja? Pse ma ndriçove mendjen o Zot, kur nuk kam se me ke ta ndâj driten? Pastaj, edhe ktò dhimbta t'padurueshme, pasojë e parimeve t'mija! Pse duhet t'kem parime, kur gjithshkâfja do t'kthehet n'hî?! ...Më lén o Zot, më lén të shkoj te miqtë e mì; fare pak prej tÿne, gjallojnë sod n'kÿt shekull.

Gruaja ime kishte ngrirë, ndërsa unë belbëzoja këto fjalë, me sytë e mbuluar nga gishtat e duarve, që, herë pas here, fshinin ndonjë lot të nxehtë që më përvidhej faqeve të panjomura, tash njëzet vjet. Kur hyri infermierja unë heshta, por duart nuk i hiqja nga sytë e përлотur.

- Ke t'dhimbta?

- M'dhêmb shpirti.

- Prej kâmbës apo... ?

- Pse, sa dhimbje shpirti ka?

Infermierja u hutua nga përgjigjet e mia, hodhi sytë nga gruaja ime, por ajo ishte më keq; mori të fliste, por nuk nxori dot zë, veç një gërvimë të thellë fyti. Si e kroji fytin e u bë gati të fliste, tashmë kishte ngelur pa argument.

- Ta báj një qetues? - Infermierja u përpoq të shpëtonte situatën.

- Mirë, - thashë dhe u ktheva në brinjë; duart i mbaja akoma në sy, kurse shpimin e gjilpërës, as që e ndieva fare.

- Ferkoje pak me dorë... t' shperdahet ilaçi. - Si tha këto fjalë, infermierja u nis për një urgjencë tjetër; dikush e kishte thirrur që nga korridori.

Shtriva dorën për aty ku mendoja se më kishin bërë injeksionin. Në vend të të ndenjurrave të mia të buta, dora më preku një kockë të fortë që tundej andej këtej; ishte dora e gruas sime, e cila kishte nxituar të zbatonte porosinë e infermieres. U ktheva sërish në qetësinë time, e cila, shumë shpejt, më çoi te dëshira për të ikur nga kjo botë. Ndieja një dëshirë vullkanike që të takohesha me të adhurueshmit e mi nga shekujt e shkuar, ndonëse e ndieja se nuk do ma jepnin këtë kënaqësi, kaq shpejt. Dëshiroja Nirvanën, por me sa duket, duhet të duroja edhe për ca kohë dhimbjen njerëzore. M'u kujtua San Antonio, që i pati thanë mikut të tij në fanitje: *"Lashë gomarin te kisha e po nisem për atdhe"*. Edhe mua, më ishin rënduar së tepërmi dhimbjet prej gomari të trupit tim, por nuk kisha akoma një kishë ku t'i lija. Sapo u hap dera dhe hyri infermierja, mendja më shkoi tek im bir.

- Jë ma mirë tash?

- Nse e ke fjalën për dhimbtën e kâmbës... ma mirë jam.

Infermierja e mirë, që s'ia mësova dot as emrin, tentoi të më zhbironte me sy, por thellësia e vështrimit tim e bëri të ulte kokën. Tashmë i kisha hequr duart nga fytyra, e cila, përveç mjekrës së rritur, gjatë këtyre ditëve të fundit, të lejonte të shikoje dhe pak lëkurë rreth syve, përposhtë lotëve të përtharë. Ndoshta ky kishte qenë vetëm një moment dobësie. Ndoshta, këtë e kuptoi edhe infermierja pa emër, e cila më uroi "natën e mirë", duke më dhuruar një buzëqeshje dashamirëse, që mua m'u duk edhe solidare. Nuk guxova kurrë ta pyesja gruan se ç'kishte menduar në ato çaste; po ashtu, edhe ajo nuk më pyeti asnjëherë.

Gjithnjë kam pritur të më ndodhte diçka në jetë, diçka që të më nxirrte me dhunë nga përditshmëria; prisja një zë që të më thoshte: *"mjaft mâ, hajde"*. Por ai zë jehonte vetëm në honet e errëta të trurit tim; askush nuk erdhi, asnjë "kerubin" nuk zbriti

nga qielli. Për çdo gjë të arritur në këtë jetë, fatura e djersës më erdhi gjithnjë e majme. Tanimë, nuk pres asgjë; arrij vetëm të kuptoj tim bir, kur të gjithë ankohen për sjelljen e tij.

Si dola nga spitali, nuk po e ndieja më peshën e sedrës së sëmurë. Ndonëse ndieja akoma dhimbje në këmbë, u ngjita deri në lagjen e kodrës. Ndalova poshtë një dritareje dhe zura të thërras emrin e njeriut që banonte aty. Pashë një perde të lëvizte, por dritarja nuk u hap. Zura të thërras më fort, gjersa një siluete rrëshqiti poshtë perdeve; në vesh, më gjëmonte Martin Camaj:

*“...Avytu njëri!
Nga palci i urrejtjes due e dâlë,
Si bima prej fare n’prândverë.”*

Ngjita shallët e trokita në derë. Asnjë përgjigje. Trokita më fort dhe nisa të thërras njëkohësisht me të trokiturit. Shumë njerëz kishin dalë nëpër dritare e po prisnin të shikonin se çfarë do të ndodhte. Vetëm ai, njeriu për të cilin më qante zemra, nuk po dilte. Më kishte lënduar në shpirt, një Zot e di se sa, por tashmë, brenda meje, ndieja vetëm mall, mall për njeriun. Zëri im, sa vinte e bëhej më i fortë, bashkë me nyjen e gishtit që po më dhimbte si dreqi nga të trokiturit e pareshtur. Gjunjët nuk po më mbanin më e rashë mbi të dy, pikërisht në momentin që u hap dera.

- I luejtun je?
- Qysh je?
- Si para pesë motesh.
- M’fal!
- Fâlun kjòsh!
- Due me t’perqafue.
- Hiqmù sÿsh!

Dera u mbyll me rrapëllimë, por hapat e njeriut në korridor nuk u dëgjuan. U ngrita ngadalë, nën vështrimin kureshtar të

komshinjve, të zhgënjyer nga shkurtësia e aktit që mundën të shijonin. Ndërsa zbrisja kodrës, ndihesha edhe më i lehtë; tashmë pesha, kishte kaluar te njeriu tjetër.

Më është bërë zakon që, muajve të verës, të ngjitem në kalanë e Lezhës, të hedh sytë mbi fushën e Zadrimës, ndonëse nuk shoh gjë tjetër, veç djerrina, baltë, apo re pluhuri... Nuk i dorëzohem trishtimit, por kthehem te... vetja ime dhe aty takoj të magjishmen; ndihem vërtet fatkeq që nuk ua shpjegoj dot, më mirë se kaq. Ndoshta, kjo ndjenjë më vjen ngaqë shoh edhe shtëpinë muze të Poetit Kombëtar, të ndërtuar tashmë... Nuk e di nëse e shoh vërtet, apo veç e magjinoj; herë në Fishtë e herë në Troshan, te kolegji i françeskanëve; herë te djerri i memorialit, ku lindi dhe herë te kulla e vjetër, ku kishte jetuar me nipat.

Ndërsa zbres nga kalaja, përsëris me vete foljet njërrrokëshe të shqipes si: “ha”, “pi”, “rri”... apo “vé”, “lé”, “xé”... deri te: “flej”, “fsheh”, “mbaj”... duke menduar se ka patjetër një arsye, pse gjuha shqipe u zhvillua kaq vonë, për të mbërritur deri në shekullin XXI në variantin e saj antik, pothuajse plotësisht, e paoksiduar nga koha. Ajo shqipja me dy koka, e flamurit tonë, “*Anzat e Parnasit*”, të shkruara po nga autori i “*Lahutës së Malsis*”, më sjellin në mendje, “*Madhështinë e Marrëzisë*”, “*Dredhen e Djallit*” të Poetit Kombëtar, deri edhe mallin e europianëve për stërgjyshërit e tyre.

Po kështu, më ngacmojnë lukthin e kujtesës edhe ato qerret e famshme me libra që u mbytën në Zadrimë, teksa po kalonin Drinin. Ato po vinin nga Ardenica; i kishte kërkuar një Papë i shekullit XI, apo më mirë të themi, po i kërkonte koha, teksa fati i mbyti në Dri. Të jetë vallë, humusi i krijuar nga këta libra, ai që i nxit rrënjët e drithërave, të ushqejnë mendje të ndritura?! Ç’kishte dashur të thoshte vallë, ai plak i urtë zadrivor, teksa i biri po e njoftonte për cubat, që u kishin grabitur viçin motak, ndërsa ky ia kthente:

- Po laknat a i moren?

- Jo, babë.

- Epo, dreqnit paskan m'ë hânger at viç! - Ndoshta plaku ishte "vëlla" në dije me atë ipeshkvin, i cili e pinte lëngun e lakrave me tas, kurse mishin s'ë prekte fare.

- As kûjin e laknave, babë ... - i biri bënte me dorë nga një kërrabë e vogël druri në formën e shkronjës "r" të vogël, e varur në një gozhdë të trashë e të ndryshkur. Me atë vegël të thjeshtë druri mbidhnin fidanët e lakrave, domateve, specave, preshëve

...

- Ajo krrabë âsht e jona bir, ... ate s'na e merr kush, nuk âsht nevoja me e ruejtë.

Zadrimorët, në mitologjinë e tyre, "edipin" e kanë atvrasës, por jo më shumë. Ai nuk arrin deri atje, sa të martohet me të ëmën; edhe arsyeja e atvrasjes nuk është lakmia për pushtet, por ndjenja e detyrës. Gjarpri mitologjik i ilirëve, si ruajtës e mbrojtës i shtëpisë, është zëvendësuar me rrëshajën, gjarprin ruajtës të çinarëve, të cilët, në fakt, ruajnë sinoret e Blinishtit mesjetar. Jo rastësisht, në këto fusha, mes Lezhës e Shkodrës, është gjetur edhe kënga popullore më e vjetër, në të cilën përmendet emri "shqiptar", në vend të emrit "arbër", apo "ilir":

*"po këcen lepri, bisht m'bisht,
po këceno shkienisht/ltinisht/turqisht etc.
thotë vasha, nuk e due,
jam shqyptare e s'âsht per mue..."*

...

*...po këcen lepri, bisht m'bisht,
po këceno shqyptarisht,
thotë vasha, un e due,
jam shqyptare e âsht per mue"*

Në kufirin mes kësaj jete dhe tjetrës, mes legendës dhe reales, sfumohet fuqia e arsyes dhe njeriu e ka të vështirë të kuptojë logjikën e gjërave. Tokë e shpirtrave, tokë e nëmur apo tokë e të urtëve; veç për diçka nuk kam dyshime, asgjë nuk është

siç duket.

*“Ene Hana do ta dije,
ene Dielli do t’ket pá,
rreth e qark ksaj rrokullije,
si Shqipnîja vend nuk ka”*

Ndoshta, jeta e njeriut nuk është tjetër, veç detit të trishtë të përditshmërive; ndoshta, por ama një shpresë për diçka tjetër, ca gjurmë kujtese, që duan të na çojnë diku, qoftë edhe nëpër ëndërr, janë jo vetëm varka shpëtimi, por edhe dritë shëlbimi e muzë lumturimi, pse jo edhe një sfidë që i bën njeriu së përkohshmes dhe fatalitetit.

FJALORTH SHPJEGUES

1. **shkandullimi** - tronditja, shkundja, trullosja, çekuilibrimi, skandalizimi etj.
2. **rrânë** - shkuan, rendën, ngar-endën etj.
3. **t'rámmi** - të rënit, ata që ranë
4. **n't'shtrueme** - në krevat, në shtrat
5. **zidan** - zor, vështirësi
6. **gjîndja** - njerëzia, njerëzit
7. **tager** - të drejtë
8. **idhnimi** - inati, zemërimi
9. **perdá** - shpërndarë
10. **t'meruem** - të tmerruar
11. **zgur** - zgavër
12. **ki'n** - kishin
13. **ko'** - kam
14. **me e pshtue** - ta shpëtojë
15. **i kënëllun** - i majmur, i ushqyer, i rritur, i fuqizuar etj.
16. **mshële** - mbylle
17. **kjeçë** - isha, qeshë
18. **t'imtë** - çast, sekond
19. **pâkë** - pakësuar
20. **lukth** - gropa e gjoksit
21. **t'sosun** - të mbaruar
22. **jetik** - i lashtë, i moçëm
23. **tue terthorzue** - duke prerë, duke u kryqëzuar me
24. **Skriba** - shkruesi, shkrimtari
25. **ju skapulluen** - iu shkëputën
26. **t'krîtë** - të ftohtë akull
27. **s'bzâte** - nuk bëzante, nuk fliste
28. **posaçe** - sidomos, veçan, veçanërisht
29. **Rrmajë** - Varrezë Katolike në Shkodër
30. **i'n** - ishin
31. **aspo** - apo jo
32. **shkrèth** - raft librash, bibliotekë
33. **t'kujuemt** - kujtimi
34. **ndeshtrashat** - ndodhitë, përjetimet, përvojat etj.

35. **Sh'Misë** - Shën Eufemisë
(ka një kishë me këtë emër në
Kallmet, mbi rrjedhëm e një uji
të famshëm e sipas besimtarëve,
është edhe mrekuilibërës)
36. **giajnë** - ngjajnë
37. **prûjke** - sillte
38. **sagllam** - me të vërtetë, fiks
39. **Senjuerve** - zotërinjëve,
pronarëve
40. **ndokund** - afërsisht, rreth
41. **syreta** - fotografi
42. **pa ja dá** - papushim
43. **t'menduemet** - mendimet
44. **Nëmces** - Perandorisë Aus-
tro-Hungareze
45. **ngiat, ngiet** - pranë
46. **fletorje** - gazete
47. **mjë** - deri
48. **kândjen** - kënaqësinë
49. **dlîrjen** - pastrimin
50. **t'mrrîmen** - sapo arritën
51. **konkënd** - i kënaqur
52. **me vndue** - të vendosim
53. **n'zâ** - të përmendur
54. **t'lûtna** - të lutem, të lutemi
(shumësi është te lutësi)
55. **t'mosvarme** - të pavarur
56. **me shestue** - të rregullojë, të
drejtojë, të organizojë etj.
57. **t'paçansuem** - të pa cak, të
pa limit, të papërcaktuar etj.
58. **pernjîtas** - përbri
59. **nder vëdi** - tek organet
gjenitale
60. **aletet** - veglat, aksesorët
61. **n't'shmaket** - në të majtë
62. **pije kndëllse** - pije energjike
63. **irronte** - inatoste,
zemëronte
64. **e squet** - e zgjuar
65. **lûmni** - lumturi
66. **shpîja e t'lemit** - 1. mater-
niteti 2. shtëpia ku ka lindur 3.
shtëpia nga lindja (Est)
67. **jallia e topkambës** - stadiu-
mi i futbollit
68. **zharg** - zvarrë
69. **prûjshem** - me përunjtesë,
në ndjenjë faji
70. **lojna kuplerajash** - punë
kurvash (aludohet për lezbizëm)
71. **dhântî** - dhuratë
72. **rësa** - smira, zilia, këtu:
egoizmi
73. **t'kerkuemt** - kërkimi,
kërkesa
74. **zdrypë** - zbritur
75. **âjë** - fryrë, mbufatur
76. **Zoja e Paperlyeme** - Shën
Mëria
77. **shi i rrâjshem** - rrebesh
78. **asgjâmangut** - megjithatë,
prapëseprapë
79. **t'voktë** - të zbehtë
80. **Urën e Laraskave** - sipas
mitologjisë kineze, urën që të
lidh me botën e përtejme
81. **i shituem** - i goditur nga
pika, i rënë top në vend
82. **t'trishtuemt** - trishtimi

